100 VJET PAVARESI

Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (74). QERSHOR 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

DEBAT

Beteja e Torviollit u zhvillua në Fushën e Kalasë

Nga: **DESTAN RAMA** - FAQE 7

HISTORI

Kontributi i Dibrës në Lidhjen e Prizrenit

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 15

KRITIKË LETRARE

Naim Berisha - poeti i jetës, atdheut, familjes

Nga: **BARDHYL XHAMA** - FAQE 8-9

HOMAZH

Humbëm një gazetar dhe artist

Nga: **KAMBER FARUKU**- FAQE 23

Turizmi, sukses apo dështim?



- Qindra turistë, vendas e të huaj, vizitojnë qarkun e Dibrës gjatë periudhës së verës, por guidat e tyre turistike shpesh janë zhgënjyese përsa i përket infrastrukturës dhe shërbimit.
- Turistët më të zakonshëm janë nga Çekia, Franca, Zvicra, Gjermania. Ata mahniten nga natyra, nga bukuritë natyrore, por janë shumë të zhgënjyer nga infrastruktura rrugore.
- Dibrës së Madhe i mungon një muze, ku turistët dhe vizitorët nëpërmjet fotografive dhe objekteve të ndryshme do të njiheshin me të kaluarën e bujshme të Dibrës.
- Dibra nuk ka një dyqan artizanal, ku turistët dhe vizitorët do të mund të blinin punime artizanale dhe suvenire, gjë që do ta ringjallte zejtarinë dhe do të sillte të mira financiare.

Në foto: Një grup gjuetarësh peshku me dinamit, të dielën e Festës së Drinit në Muhurr, të cilët jo vetëm "ndihmojnë" për zhdukjen e peshkut në Drin, por edhe rrezikojnë jetën e fëmijëve të vegjël

SPECIALE NË FAQET 2-3

AKSIDENT NË GALERI

Bulqizë, vdes minatori Dilaver Koçi

Minatori, baba i tre fëmijëve, po zhbllokonte me levë një "duçkë", kur e zuri masivi i gurëve

Bulqiza, qyteza e minatorëve të kromit, është tronditur nga një tjetër ngjarje e rëndë në një nga galeritë e shumta të shfrytëzimit të mineralit të kromit, ku si pasojë ka humbur jetën një minator, ndërkohë që policia ka arrestuar administratorin e firmës, inxhinierin dhe teknikun. Burime nga miniera konfirmojnë se dje, në orët e mesditës, në një nga galeritë private me nr. 41, në zonën e pusit nr. 1, një minator ka humbur jetën teksa po punonte për zhbllokimin e një furneli. Po sipas burimeve mësohet se minatori Dilaver Koçi, 52 vjeç, banor i fshatit Vajkal në qytetin e Bulqizës, në përpjekje për zhbllokimin me levë të një "duçke" është aksidentuar me pasojë vdekjen, pasi masivi i gurëve të shembur e ka zënë nën vete. Sipas policisë lokale, mësohet se pas aksidentit, në galeri, shokët e punës dhe reparti i inspektim-shpëtimit, mundën të nxjerrin nga masivi i gurëve trupin e pajetë të 52-vjeçarit. Për aksidentin e ditës së djeshme, ku viktima e radhës ishte babai i tre fëmijëve, mësohet se policia po punon për zbardhjen e ngjarjes. / ***H.Likdisha***

HOMAZH / KUSHTUAR NJEZET VJEÇARES, DONIKA

Poemë e shkruar duke lotuar

Njerëz të mirë, folni gjithmonë fjalën e amël. Kur shkelni për tokë në udha, shtigje, livadhe e lëndina, shikoni më parë se ku vini kamën. Kur debatoni apo gjykoni për një problem të shtruar për zgjidhje, rradhë uji, ndrrim toke,zabel dushkajash, ndarje pasurie të shtëpis apo dhuratat për festa apo martesa, tregojuni zemër hambar e shpirtë ëmbël, ndajeni gjërat me drejtësinë e zotit e nën dritën e diellit. Gjakmarrja ritë paganë, primitiv i cili shfaqet jo rrallë në mes shqiptareve, dibranëve, luznakeve, maqellarasve okshtunasve etj, është tregues force e paadobishme, është mungese llogjike kulture e edukate nuk është gjë tjetër veçse padrejtësi e verbërt, është rrënim shpirtëror e zhdukje jetësh e së fundi është gjynah të zoti. Mos e mendoni e kryeni. Largojeni pa kufi këtë veprim ogurzi nga shpirti e mendja!

Nga: **SELMAN MZIU - FAQE 22,23**


cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (74). 1 - 30 Qershor 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Hysen Likdisha, Ahmet Çaushi, Shefki Aliti, Bedri Tahiri, Ermira Babamusta se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Rexhep Torte
Bardhyl Xhama
Ilia BOBAJ
Kamber FARUKU
Moisi MURRA
Selman MZIU
Ilmi DERVISHI
Ibrahim EGRIU
Xhelal ROÇI
Fejzulla GJABRI
Destan RAMA
Zamira GJELESHI
Zabit LLESHI
Shukri HAJDARI
Nexhi BAUSHI
Mevlud BUCI
Faik XHANI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Turizmi në Dibër të Madhe

Nga: **REXHEP TORTE**



Zona e Dibrës së Madhe ka një pozitë tejet të volitshme gjeografike dhe bukuri magjepëse natyrore. Dibra e Madhe ka pozitën e një luleje, ku sikurse lulja me petale, Dibra është e rrethuar me male, pyje, kullota, përrenj, lumenj, liqenin dhe mbi të gjitha me Banjat termominerale – Capa.

Ajo që e bën të dalluar këtë zonë janë edhe njerëzit bujarë e mikpritës. Megjithatë për zhvillimin e turizmit në Dibër të Madhe nuk është investuar sa duhet, me përjashtim të Banjave të Dibrës – CAPA, që tashmë janë privatizuar nga biznesmeni dibran Mexhit Capa.

Dibra e Madhe në lulëzimin e zhvillimit të vet të bujshëm në të kaluarën ka patur të zhvilluar edhe arkitekturën karakteristike dibrane, por sistemi monist lejoi që pjesa më e madhe e saj të rrënohet, ndërsa edhe pushteti aktual nuk është duke i kushtuar vëmendjen e merituar ruajtjes dhe shpëtimit të objekteve që kanë mbetur.

Asfaltimi i rrugëve që të çojnë gjer në fshatrat shqiptare përbri kufirit me Shqipërinë, kanë krijuar kushtet dhe shtuar shpresat se këto fshatra të braktisura do të gjallërohen, fillimisht duke punuar tokat shumë pjellore dhe duke zhvilluar bujqësinë, blegtorinë dhe rregullimin e ndërtimin e shtëpive, që mund të jetë bazë për zhvillimin e turizmit në fshat.

Kanjoni piktoresk i lumit Radikë që nga burimi i tij rrëzë Mavrovës e gjer në Dibër të Madhe, mbetet joshës për shumë turistë që kanë pasion ngjitjen nëpër male ose peshkimin. Megjithatë segmenti rrugor Dibër - Mavrovë duhet rikonstruktuar dhe në anët e rrugës duhet vënë rrjeta çeliku për të penguar rrëshqitjen e gurëve që shkaktojnë viktima dhe rrezikojnë jetën e udhëtarëve.

Bashkimi i lumit Radikë dhe i Drinit të Zi në Fushën e Udovës kanë krijuar liqenin e bukur të Dibrës që përveç energjisë elektrike u jep mundësinë dibranëve që të bëjnë plazh gjatë muajve të verës. Në të ardhmen në bregun e liqenit parashihen të ndërtohen edhe hotelet përkatëse. Në këto ditë vere me temperature tropikale plazhi i liqenit të Dibrës është përplot me vizitorë. Ky plazh u mundëson dibranëve që të pushojnë dhe freskohen me pak shpenzime.

Dibranët në plazh përjetojnë çaste të bukura pushimi duke u freskuar në ujë, duke gjuajtur peshq dhe duke pushuar nëpër kafe-baret e ngritura përreth liqenit nga biznesmenët private. Plazhi i Dibrës është i favorshëm sidomos për ata që nuk kanë mundësi financiare t'i përballojnë shpenzimet për të vajtur në ndonjërin nga bregdetet.

Për një pjesë të dibranëve plazhi i liqenit shërben edhe si përgatitje për të fituar ngjyrën e nevojshme të lëkurës për vajtur më pastaj në plazhet e bregdetit shqiptar apo gjetiu.

Edhe sivjet në Dibër të Madhe pritet të arrijnë për pushime mijëra mërgimtarë dibranë, gjë që është edhe një mundësi e mirë që dibranët e mërgimtarët të kalojnë sëbashku çaste të pandara.

Pushteti vendor dhe shoqatat joqeveritare disa herë kanë organizuar aksione për pastrimin e bregut të liqenit nga hedhurinat dhe ambalazhet e ndryshme. Rruga e asfaltuar për në liqen shërben për të arritur më lehtë e më shpejt në plazh, por edhe si vend për shëtitje për rekreacion dhe si trim stazë.

Ajo që i shqetëson dibranët është ndotja e vazhdueshme ujit të këtij liqeni nga ujërat e zeza që vijnë nëpërmjet lumit Drini i Zi nga Ohri dhe Struga. Njësia për mbrojtje shëndetësore në Dibër rregullisht bën marrjen e mostrave të ujit në vende të caktuara dhe i dërgon për analizë në Entin për mbrojtje shëndetësore në Ohër. Rezultatet e këtyre analizave kimike dhe mikrobiologjike të ujit të liqenit kanë qenë në të klasit të dytë dhe të tretë, që uji mund të përdoret për plazh, por jo edhe si ujë i pijshëm. Nuk do të ishte keq që këto mostra të ujit të dërgohen për analiza edhe në ndonjë shtet tjetër.

Dibrës së Madhe i mungon një muze, ku turistët dhe vizitorët nëpërmjet fotografive dhe objekteve të ndryshme do të njiheshhin me të kaluarën e bujshme të Dibrës. Nevojitet edhe hapja e një dyqani artizanal, ku turistët dhe vizitorët do të mund të blenin punime artizanale dhe suvenire nga Dibra, gjë që do ta ringjallte zejtarinë dhe do të sjellte të mira financiare për dibranët në këtë papunësi të madhe.

Investimet e vetme e më të mëdha në aspekt të zhvillimit të turizmit në Dibër të Madhe janë bërë në Banjat e Dibrës së Madhe - Capa, që kanë mundësuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve dhe të rritjes së numrit të vizitorëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe nga vendet e huaja.

Dibrës së Madhe i mungon një muze, ku turistët dhe vizitorët nëpërmjet fotografive dhe objekteve të ndryshme do të njiheshhin me të kaluarën e bujshme të Dibrës. Nevojitet edhe hapja e një dyqani artizanal, ku turistët dhe vizitorët do të mund të blenin punime artizanale dhe suvenire nga Dibra, gjë që do ta ringjallte zejtarinë dhe do të sjellte të mira financiare për dibranët në këtë papunësi të madhe.

KOMENT

Turizmi, sukses apo dështim?

Joseph është një motorist nga Austria. Bashkë me shokun e tij të fëmijërisë dhe bashkëshortet e tyre tij po bëjnë një udhëtim turistik nëpër vendet ballkanike. Preferojnë të flenë jashtë në natyrë dhe në një nga netët e qershorit nata i zuri në Kalanë e Dodës. Ata u mrekulluan me natyrën dhe aromën e bjeshkës dhe vendosën të ngrenë çadrat anës rrugës, por një banor i fshatit i detyroi të ngriheshin. Të nesërmen, ai do të korrte barin aty. U desh ndihma e një fëmije, 13-14 vjeçar, i cili me anglishten e tij të dobët, i ndihmoi të ngrinin çadrat në një vend tjetër, afër baxhove.

Por Josephi dhe miku i tij mbetën të çuditur nga shikimet e banorëve që thërrisnin, qeshnin me zë të lartë dhe argëtoheshin me turistët e çuditshëm austriakë, që kishin vendosur të kalonin natën në tokat e tyre të humbura rrëze maleve të Korabit. U zhgënjyen edhe kur blenë 200 gr. djathë me 10 Euro. Asnjë nga ushqimet që kishin lexuar në manualet e kërkimit në internet nuk gjetën. Madje as qumësht dhe kos.


Në planet strategjikë të zhvillimit, gjithë komunat e qarkut të Dibrës, njërën nga mundësitë e zhvillimit paraqesin turizmin. Por, çdo të thotë fjala turizëm? Sipas fjalorit të gjuhës shqipe, turist do të thotë "një njeri që bën udhëtime në vende të ndryshme për të pushuar, për t'u argëtuar, për të parë bukuritë e natyrës, gjërat e rralla, veprat e artit etj.; ai që shëtit në vende të bukura e të panjohura për kënaqësinë e tij".

Turizmi është sot një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë. Shumë shtete, edhe në Ballkan, rritjen ekonomike e kanë falë turistëve. Por, që turizmi të kthehet në një degë të rëndësishme të ekonomisë së vogël familjare dhe asaj të madhe kombëtare, duhet të zhvillohet sipas një strategjie të studiuar e të përkrahur nga gjithkush, që nga fshatari i zakonshëm në fshatin më të lartë buzë malit, deri në nivelet më të lartë të qeverisjes.

Intervistë me z. Vladimir Marku, drejtuesin e agjencise turistike "Dibra Tours Travel"

Turistët mrekullohen nga natyra

Turistët më të zakonshëm janë nga Çekia, Franca, Zvicra, Gjermania. Ata mahniten nga natyra, nga bukuritë natyrore, por janë shumë të zhgënjyer nga infrastruktura rrugore.



Pamje nga liqejtë e Lurës. Foto: Facebook/dibra.tourstravel





Pamje e brendshme e Muzeut të Kastriotëve në Sinë. Foto: Facebook/dibra.tourstravel

Cila është guida që ju bëni më shpesh?

Guidat e zakonshme janë në Lurë dhe në Malin e Korabit. Por, kemi bërë dhe bëjmë guida edhe jashtë këtyre dy zonave shumë të bukura turistike, si në liqenet e Vajkalit, luginës së Setës, bjeshkëve të Gramës, Ilnicës e Zagradit, duke u ofruar turistëve vendas e të huaj mundësinë për të shijuar bukuritë natyrore që ofron rajoni i Dibrës.

Sa zgjasin turet turistike të agjencisë suaj dhe a mund të na përshkruani disa nga vendet historike, arkeologjike, kulturore, etnografike që përfshihen në guiden tënde?

Turet turistike më të zakonshme janë ato tre ditore, që zakonisht zhvillohen në fundjave. Një tur i tillë drejt Lurës zakonisht fillon me qytetin e Peshkopisë. Të nesërmen nisemi me makinë drejt Sinës, ku pasi vizitojmë muzeun e Skënderbeut, drekojmë te lokali i Peshkut në Arras. Me pas vizitojmë luginën e Setës drejt kishës së Don Markut, ku shohim shpellën e Sopanikës dhe bukuritë natyrore të lumit të Setës. Pastaj kthehemi dhe flemë në Arras dhe të nesërmen herët nisemi për Lurë. Vizita në Lurë zgjat sipas kohës në dispozicion që kemi. Në qoftë se qëndrojmë një natë atje, shikojmë të gjitha liqenet e Lurës.

Grupet turistike që organizojnë kthimin për në Tiranë, kanë mundësi të vizitojnë edhe Ujin e ftohtë të Mërkurthit. Ndërsa për grupet që kthehen sërish në Peshkopi, organizojmë një drekë në natyrë te Liqeni i Zi dhe në darkë bëjmë kamping pranë Liqënit të Luleve. Pastaj, sipas kërkesës dhe mundësisë të secilit grup, organizojmë vizitën në Gjallica, ose lojëra të ndryshme e veprimtari sportive në Fushën e Pelave. Veprimtaritë sportive me kuaj janë shumë të preferueshme për turistët, kështu që ne mundohemi tua plotësojmë këtë dëshirë.

Zakonisht, kush janë njerëzit që e vizitojnë zonën meë shpesh? Nga vijnë ato dhe çfarë përshtypjesh lënë?

Turistët më të zakonshëm janë nga Çekia, Franca, Zvicra, Gjermania. Ata mahniten shumë nga natyra, nga bukuritë natyrore. Por, ato janë shumë të zhgënjyer nga infrastruktura rrugore.

Rrugët që të cojnë drejt këtyre detsinacioneve turistike lënë shumë për të dëshiruar.

Çfarë ushqimesh konsumojnë turistët kur vizitojnë zonën?

Ushqimet zakonisht janë tradicionale. Buka është e gatuar në kushtet e shtëpisë si dhe gjithë produktet që ofrohen janë bio.

Një drekë është pranë lokalit të peshkut në Arras, ku ofrohet peshk i freskët, troftë, si dhe sallata të stinës.

Pastaj, sipas vaktit, ofrohet pule me koranajk, turshi natyrale, djath dhie, fruta të stinës (mana, qershi), raki fshati, verë fshati, etj. të prodhuar dhe shumë produkte të tjera të cilat shumë nga vizitorët i provojnë për herë të parë. Mëngjesi është shumë i bollshëm: buke çerepi me saç, qumësht, çaj mali, tlyen, reçelra të ndryshme, mjalt i sapo vjelur. Dreka, po ashtu është tradicionale: mish qengji ose keci te skuqur, në hell ose në zgare, sipas dëshirave të personave.

Sa të sigurtë janë turistët?

Një nga detajet që ne nuk anashkalojmë është siguria e turistëve. Megjithëse zona ofron një mikpritje tradicionale, ne nuk neglizhojmë sigurinë e tyre, qoftë nga vjedhjet, qoftë nga aksidentet që mund të ndodhim gjatë shëtitjeve në këmbë. Pranë grupeve të shoqërimit janë gjithmonë të gatshëm një mjek, një ciceron si dhe një punonjës sigurie. ***(Bisedoi: B.Karoshi)***

Dibra ofron shumë resurse turistike, me një shtrirje të gjerë pothuajse në gjithë qarkun: parkun kombëtar të Lurës me liqenet e mrekullueshme e të rrallë, masivin malor të Korabit, hapësirën e bjeshkëve nga Grama në Ilnicë, liqenet e Balgjajt, pyjet e Pratit, rrjedhën e Drinit e plot e plot resurse të tjera turistike të fshehura në çdo luginë e kodër. Por Dibra ofron edhe kulla karakteristike, kala të vjetra, muze e monumente natyre, të veçanta e të pakrahasueshme me asgjë tjetër në vend.

Por, për t'u prekur nga turistët këto bukuri natyrore e kulturore, së pari duhet bërë një regjistrim, inventarizim dhe promocion i tyre, duke i bërë të ditur për çdo vendas e të huaj.

Së dyti, duhet parë në mënyrë emergjente rregullimi i infrastrukturës rrugore, të paktën deri në qendrat e fshatrave. Duke përjashtuar rrugën që të çon në Kalanë e Dodës, rruga për në Lurë apo në Prat lë shumë për të dëshiruar. Ndërsa Ura e Muhurrit, e ndërtuar që në kohën e italianëve, ka rreth 20 vite që është amortizuar komplet dhe mbahet në jetë me arnime me dërrasa.

Së treti, duhet bërë një punë ndërgjegjësuese e promovuese mes banorëve, të cilët të zhytur në hallet e problemet e tyre të ditës, nuk u kushtojnë aspak rendësi prezantimit të tyre para të huajve. Disa detaje të pastërtisë dhe eksperimenteve me jetën baritore janë bërë të njohura edhe mediatikisht në forume në internet, por që nuk paraqesin modelin e mirë të turizmit malor. Fotoja e bagëtive të therura në livadhe, gjuetisë së peshkut me dinamit apo plehrave që mbushin pyjet pas festave të shfrenuara me alkool dhe mish të djegur, nuk mund të ofrojë asgjë turistike.

Që turizmi të mos kthehet në një "ëndërr" të humbur të zhvillimit ekonomik, duhet menduar dhe vepruar për një strategji të prezantimit të resurseve turistike. Por edhe një prezantim të banorëve mikpritës e guidave në terren, në mënyrë që turistët që udhëtojnë mijëra kilometra larg, të mos bien viktimë.

Joseph-i dhe miqtë e tij e panë lindjen e diellit një mëngjes në Korab. Por u nisën shpejt për të kaluar kufirin, pasi gjithë natën nuk kishin vënë gjumë në sy nga të lehurat e qenve dhe zërat e banorëve që i përgjonin.

Bujar Karoshi



Ura e Muhurrit mbi Drin, e dëmtuar në maksimum, një nga nyjet kryesore të infrastrukturës rrugore në rrethin e Dibrës.

Rruga e Arbërit nr. 74

koment

Të ndryshohen toponimet sllave



Nga **Rexhep TORTE**

Në këtë jubile të ndritur mbarëshqiptar të njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, duhet bërë të pamundurën që në muajt që na kanë mbetur gjer te shënimi i këtij jubileu t'i ndryshojmë toponimet serbosllave të ngulitura në trojet shqiptare, ose të paktën të krijojmë mundësitë dhe të fillojë procesi i zëvendësimit të këtyre toponimeve me emërtime shqiptare. Në të kundërtën do të dëshmohemi të pandërgjegjshëm, të papërgjegjshëm dhe do tu mbetemi borxh për jetë të jetë të jetëve qindra mijëra e trimave sypatrembur, që dhanë jetën e tyre për të mbrojtur e çliruar trojet shqiptare dhe kjo padyshim do të mbetej një njollë e zezë në këtë vit jubilar madhështor kombëtar.

Në të gjitha trojet tona të lara me gjakun e trimave tanë duhet të figurojnë toponime që frymojnë shqip. Kjo mund të bëhet shumë më lehtë, sidomos tani në demokraci kur ekziston një sistem i konsoliduar administrativ, arsimor , historik e shkencor, e sidomos në shtetin amë Shqipërinë ku për këtë veprim nuk duhet pyetur askend.

Po t]i shikojmë hartat gjeografike, ose po të bëjmë një udhëtim nëpër trojet etnike shqiptare në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Luginën e Preshevës, Malin e Zi dhe Çamëri, do të hasim në shumë toponime serbosllave dhe greke që ta vrasin syrin duke i shikuar dhe veshin duke i dëgjuar. Këto toponime nuk kanë ardhur aqë lehtë. Janë bërë luftëra të ashpra dhe është derdhur shumë gjak shqiptarësh autoktonë. Është fakt i pamohueshëm që edhe sot e kësaj dite, në mbarë trojet shqiptare është shumë e përhapur toponimia serbosllave.

Historikisht është e njohur se valët e dyndjeve sllave në trojet shqiptare kanë filluar heret. Është shumë interesante se sllavët janë treguar tepër sistematikë dhe agresivë në ndryshimin e toponimisë së vendeve ku shkelnin. Kjo bëhej edhe përmes përkthimit të toponimeve vendase që i hasnin, përmes përdorimit të toponimisë kishtare orthodokse sllave dhe formave tjera. Qysh në Mesjetë në kanonikun e Car Dushanit ka patur edhe rregulla të zyrtarizuara për ndryshimin e këtyre emrave autoktone shqiptare.

Ndryshimin e toponimeve shqipe serbosllavët e kanë bërë në mënyrë të qëllimshme, të ndërgjegjshme dhe largpamëse, për të ngulitur sa më thellë rënjët sllave aty ku ata s'kanë qenë kurrë më parë. Sllavët me qenien dhe sjelljet e tyre kanë dëshmuar vuajtjen nga kompleksi. Ata janë ndje të kompleksuar nga mungesa e traditës kulturore dhe e lashtësisë së tyre historike. Me ardhjen e tyre në shekujt e mesjetës në trojet shqiptare, ata u ballafaquan me një qytetërim të lulëzuar dhe një kulturë të lartë ilire. Të gjendur pëballë kësaj kulture të zhvilluar sllavët e kanë ndje veten të poshtëruar, dhe kjo i ka shty dhe ua ka shtuar oreksin të punojnë në mënyrë sistematike dhe agresive për afirmimin e pranisë së tyre në këto troje.

SHQIPËRIA PËRPLOT ME TOPONIME SERBOSLLAVE

Studimet dhe faktet flasin se kjo e keqe e ka zanafillën nga koha e Car Dushanit, i cili e pushtoi Shqipërinë me dhunë,vrasje, djegie e tmerr të paparë, duke krijuar një territor të okupuar për të pasur pranë edhe detin. Kjo dhunë e madhe e ushtruar ndaj popullatës vendase shqiptare, bëri që të shpërngulet me forcë një numër i madh i shqiptarëve nga trojet e veta. Serbosllavët brenda një kohe shumë të shkurtër arritën ta vendosin toponiminë në fushat, malet dhe qendrat shqiptare të banimit, duke shkelur mbi gjuhën dhe psikologjinë e popullit autokton shqiptar. Serbosllavët kur e pushtonin dhe sundonin një vend, pa marrë parasysh se ai vend kishte toponiminë e vet, ata zbatonin taktikën e konceptuar të mentalitetit të tyre të vrazhdë të vendosjes së toponimeve me gjuhën e tyre sllave.

Për fat të keq kjo toponimi sllave në trojet tona është trashëguar gjatë dhe është e pranishme edhe në ditët e sotme. Flitet se në kohën e Mbretit Zog ka patur disa nisma që toponimet sllave të zëvendësohen me toponime burimore shqipe, por faktori politik dhe shkencor nuk është treguar shumë vigjilent në këtë drejtim.

Vizita ime kohë më parë në Shqipëri bëri që për të satën herë të lexoj shumë pllaka metalike të vendosura përbri rrugës e që janë të shkruara sipas toponimisë serbosllave.

Kjo më shtyri të blej edhe një hartë të rrugëve automobilistike, ku nga jugu në veri të Shqipërisë figurojnë emërtimet Finiq, Lukovë, Brathaj, Selenicë, Çorovodë, Potom, Novosellë, Patos, Babica e Madhe, Kapaj, Bulgarec, Golem, Divjakë, Lezhë, Ostren, Maminas, Krastë, Mamuras, Sllovë, Gollobërdë, Zllaticë, Dobrac, Bistricë, Bogove, Bradashesh, Dobraç, Dunavec, Morave, Orenjë, Pavlle, Pogradec, Shijak etj. Toponime të këtilla serbosllave ka edhe në të gjitha trojet shqiptare jashta trungut të shtetit shqiptar që administrohen nga shtetet fqinje.

EMRI SHQIP RUAN IDENTITETIN DHE AUTOKTONINË

Emri është elementi kryesor dhe legjitim i identitetit të një individi, një populli dhe një vendbanimi. Gjuha dhe emri janë argumentet që i japin kuptim, frymë dhe jetë lirisë së njeriut. Copëtimi i trojeve shqiptare në pesë

Në këtë jubile të ndritur mbarëshqiptar të njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, duhet bërë të pamundurën që në muajt që na kanë mbetur gjer te shënimi i këtij jubileu t'i ndryshojmë toponimet serbosllave të ngulitura në trojet shqiptare, ose të paktën të krijojmë mundësitë dhe të fillojë procesi i zëvendësimit të këtyre toponimeve me emërtime shqiptare.

shtete ka bërë të vetën dhe ka lënë pasoja të thella edhe në ndryshimin e toponimisë autoktone shqiptare.

Çuditërisht ky fenomen me dekada është duke u parë nga shqiptarët me një indiferentizëm dhe gjsakftohtësi që nuk duhet lejuar.

Kuptohet se shqiptarët që jetojnë në trojet e veta por në shtetet fqinje e kanë më të vështirë të marrin nisma për kthimin e toponimisë autoktone shqiptare,e lidhur me këtë kanë njëfarë arsyetimi, pasi ende nuk janë duke i gëzuar të drejtat tyre të plota e legjitime. Por shteti amë Shqipëria që gëzon pavarësinë e saj një shekull të plotë , nuk mund të gjejë asnjë arsyetim pse nuk e ka filluar dhe pse nuk e ka bërë gjer më sot zëvendësimin e toponimeve të huaja serbosllave me ato autoktone shqiptare. Për fat të keq gjer më sot ne nuk kemi dëgjuar që të jetë ndërmarrë ndonjë nismë e kësaj natyre.

Organizmat shkencore shqiptare dhe intelektualët e organizmat administrative vendore, duhet pa humbur kohë të ndërmarrin një fushatë dhe veprim konkret për të bërë shumçka në këtë drejtim. Akademia e shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i historisë, Instituti i gjeografisë dhe Instituti i guhës shqipe, i kanë të gjitha mundësitë dhe lirinë për ta studiuar mirë toponominë dhe mikrotoponominë vendase, për të gjetur e zbuluar toponimet e hershme shqipe të këtyre vendeve të zëvendësuara me toponime serbosllave dhe për t'i kthyer sërish në gjuhën shqipe.

Këtë angazhim dhe aktivitet duhet ta marrin në dorë edhe organizmat vendore në Shqipëri dhe në të gjitha trojet e tjera shqiptare ku jetojnë shqiptarët.

Toponimia lypset të vendoset mbi bazën e etnisë dhe në mënyrë të institucionalizuar. Në këtë drejtim edhe partitë politike shqiptare edhe inteligjenca shqiptare duhet ta luajnë rolin e tyre konstruktiv.

Në Kosovë onomastika sllave, që më parë ka qenë shqiptare,është e proviniencës sllave. Kishat serbe,bullgare e greke në trojet shqiptare që i kanë okupuar kanë imponuar onomastikën sllave në trojet shqiptare.

Sipas informatave tona në Kosovë ekziston një traditë të hershme për zëvendësimin e toponimisë sllave me emra në gjuhën shqipe. Për shembull Kishareka quhet Lumësi, Dobërveni- Miradi, Vuçitërni- Vushtri, Uroshevaci-Ferizaj e kështu me radhë. Është themeluar edhe kartoteka e minitoponimisë së Kosovës dhe mbi baza shkencore vazhdon puna në këtë drejtim.

Ndërkaq në Maqedoni lidhur me toponimet as që mund të flitet. Shqiptarët në Maqedoni edhe në vitet e demokracisë po përballen me meskinllëkun maqedonas për të drejtat e tyre legjitime. Botimi i Enciklopedisë maqedonase shtrembëruese, ofenduese dhe antishqiptare, botimi i papërshtatshëm i librave shkollorë në gjuhën shqipe, sulmet fizike mbi nxënësit shqiptarë, lejimi i rrënimit të shumë monumenteve kulturore e historike shqiptare. e mbi të gjitha zvarritja dhe opstruksionet nga ana e maqedonasve në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, tregojnë se as që mund të mendohet e flitet për ndryshimin e ndonjë toponimi sllav në këto troje shqiptare.

E aktualizuam këtë problematikë të rëndësishme për të sensibilizuar dhe mobilizuar të gjitha forcat intelektuale, administrative dhe politike shqiptare, për t'i flakur njëherë e përgjithmonë emërtimet serbosllave, këto çibanë që me shekuj po ndotin hapësirat dhe trojet tona shqiptare.

Letra nga lexuesit

Linja urbane e standardeve bashkëkohe që drejtohet nga dibranë

Tashmë vera ka startuar në Tiranë. Ajo krahas bukurisë e gjallërisë ka sjellë dhe shqetësimet e stinës. Një nga këta është dhe vapa e madhe. Në veçanti fëmijët e vegjël dhe të moshuarit janë më të prekur e më të rrezikuar nga temperaturat e larta, ndaj kërkojnë vëmendje e kujdes dhe nga bashkia. Tirana, metropoli shqiptar, me një popullsi një milion banorësh paraqet sa shqetësim aq edhe kujdes për organizimin e transportit qytetas urban sidomos këtë stinë të nxehtë vere . Nga shumë linja urbane që ka kryeqyteti ku për to ka patur dhe mjaft kritika e me të drejtë në media, këtë radhë ia vlen të ndalemi për linjën urbane të Tiranës së Re. Është ndoshta e vetmja linjë urbane që kooperon në Tiranë dhe ka bërë shumë për rritjen e cilësisë në transportin urban duke u bërë shembull pozitiv në të gjitha linjat e tjera. Deri para pak vitesh edhe kjo linjë ka qenë mjaft problematike si gjithë të tjerat ku qytetarët prisnin stacioneve më shumë se gjysmë ore që të niseshin në destinacionin e duhur. Tashmë shërbimi ka ndryshur totalisht. Vetë kompania që ka lidhur kontratë me bashkinë ka blerë autobus të rinj, komod dhe të gjithë me ajër të kondicionuar. Fakt është se qytetarët nuk presin as pesë minuta në stacion. Kompania i ka kushtuar shumë vëmendje kësaj linje por të njejtën gjë po bën dhe në linjat e tjera që mbulon kjo si uzina e Autotraktorëve e Tufina. Drejtori i shërbimit urban Saimir Deda, një djalë i ri ky me origjinë nga zona e Kalasë së Dodës edhe pse në zyrë mban mjaft letra falënderimi nga qytetarë të ndryshëm të Tiranës për shërbimin komod në këto linja urbane përsëri nuk është i kënaqur me stafin. Kërkon shumë prej tyre dhe vetë më së shumti qëndron në teren ku e gjejmë sa në një autobus në tjetrin.

-Vërtet kemi arritur standarde të larta në cilësinë e shërbimit urban, ndaj qytetarëve por kjo nuk është arritur vetëm me blerjen e autobusëve të mirë. Jo ne vazhdojmë të ushtrojmë kontroll të vazhdueshëm se pse jo, ka dhe individ të pandërgjeshëm që nuk duan të punojnë në mënyrë të kulturuar. Ne vërtet ndjehemi të kënaqur dhe komod në punën tonë por duam të dimë se sa komod e të kënaqur ndjehen qytetarët që udhëtojnë çdo ditë e çdo orë me linjat tona. Në linjën urbane të Tiranës së Re janë hequr njëherë e përgjithmonë pritjet e gjata në stacione. Është hequr rrëmuja në hipje dhe zbritje nëpër autobusë e bashkë me to dhe ajo e quajtura dukuri negative, vjedhje e qytetarëve. Kjo linjë është bërë një ndër linjat model sa ia vlen që edhe linjat e tjera që kooperojnë në Tiranë ti kthejnë sytë e të shikojnë këtë linjë e këtë shërbim urban. E mjaft qytetarë të ndryshëm, pensionist e njerëz të çdo lloj moshe shprehen se në këtë linjë urbane që ka kaq rregull e kulturë shërbimi punojnë e drejtojnë me kulturë qytetare dibranët. Le të shërbejë kjo linjë urbane si shkollë, si përvojë pozitive, si model edhe për linjat e tjera jo vetëm në Tiranë por edhe në qytete të tjera kudo ku ka shërbim urban qytetas

Enver Hasa, Halil Robi, Ilmi Dervishi

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

reportazh

Pranimi në shkollën "Sarina" bëhet mbi bazën e rezultaveve që nxënësit kanë arritur në klasat pararendëse. Shikohet sjellja dhe qëndrimi i nxënësit ndaj mësimit dhe vlerave njerëzore.

Te "SARINA" ide dhe dije



Nga: **SHAQIR SKARRA**

Fundi i këtij viti shkollor erdhi disi ndryshe për mësues e nxënës të shkollës jo publike "Sarina". Disi ndryshe se krahas pregaditjeve për të mbyllur këtë vit me rezultate sa më të larta, ashtu siç e kanë bërë traditë tashmë prej kaq vitesh, sivjet kishin dhe festën e madhe, kishin dhjetë vjetorin e shkollës. E data shënonte 30 maj ku jo vetëm oborri i shkollës por dhe rrugicat rreth e qark ishin mbushur me njerëz. Këtu kishte marrë çdo gjë pamjen e një feste të madhe. Kishte ende kohë për të ardhur ora nëntë, orë kjo që do të fillonin dhe veprimtaritë kulturore e artistike për nder të dhjetë vjetorit të shkollës jo publike "Sarina" por oborri ishte mbushur plot për plot. Ishte hera e parë që porta e kësaj shkolle që në mëngjes herët të ishte hapur kat e kat.Roja ishte bërë njësh me të ftuarit e shumtë. Nxënësit të veshur me uniformën e shkollës, maturantët me uniformën e maturës por dhe mjaft nxënës me kostume popullore kombëtare të cilët ashtu dorë për dore nën tingujt e vazhdueshëm të muzikës popullore kërcenin së bashku në oborrin e shkollës. Të gjithë të shkujdesur, të gëzuar dhe të mbledhur grupe grupe bisedonin lirshëm. Më i shqetësuar ishte i zoti i shtëpisë, administratori i shkollës Liman Hoxha i cili qëndronte tek porta dhe priste të ftuarit por dhe merakosej për mbarëvajtjen e këtij evinementi të veçantë për historikun e kësaj shkolle. Ora shënon 9 e mëngjesit dhe jo vetëm oborri por dhe lokali sipër ishin mbushur plot. Rrallë herë tjetër shkolla kishte patur kaq shumë mysafir, mysafir të moshave të ndryshme, që nga fëmijët e deri tek pleqtë flokë bardhë, ashtu siç u shpreh dhe moderatori Defrim Methasani, një dasëm e madhe por me krushq të zgjedhur.

15 VJETORI ME UNIVERSITET

Kishin ardhur drejtori i arsimit rajonal të Qarkut Tiranë zoti Bilbil Hoxha, drejtori i arsimit privat pranë Ministrisë së Arsimit zoti Fred Mullai, kryetari i komunës Kashar Besnik Fuqia, pedagogu i Akademisë së Sporteve Agron Kasa, zv dekane në universitetin Bujqësor Kamëz Etleva Delia, shkrimtarja e njohur dhe autorja e abetares Mimoza Gjokutaj si dhe shkrimtari dibranë Agron Tufa. Fusha e sportit ishte zbukuruar vërtet bukur, me flamuj, banderola të ndryshme por dhe me tavolinat e shumta ku ishin ulur nxënësit e të ftuarit pasi pikërisht këtu zhvillohej dhe aktiviteti mbi dhjetë vjetorin e shkollës. Si fillim vizita në mjediset e shkollës. Klasat e pastra e të rregulta, kabinete e laboratorë të përshtatshëm dhe të domosdoshëm për pregaditjen e nxënësve. Biblioteka mjaft e pasur me një larmi titujsh librash. E veçanta ishte se shkolla "Sarina" kishte ngritur dhe muzeun e saj, një sallë kjo e madhe e paisur me stenda por dhe historikun e shkollës. Këtu përveç monitorit të madh që të tregonte rrugën e gjatë e të bukur që ka bërë shkolla "Sarina" për të arritur deri këtu, vizitorët kishin në dorë dhe koleksionet e revistave e gazetës së shkollës që dalin po thuaj rregullisht. Pikërisht në këtë sallë të bukur të gjithë nga një gotë në dorë duke e bërë gëzuar.Dikush troket gotën e dikush shënon mbresa në librin e shkollës që ndodhet në tavolinë. Një urim të gjithë të pranishimit për administratorin e shkollës Liman Hoxha. Një urim ky i përbashkët: "15 vjetorin me universitet,rruga është e hapur, infastruktura gati ndaj vazhdo se je në kohën e duhur, je në rrugën e duhur. Kjo është dëshira e të gjithëve, kjo duhet të mbetet dhe ambicia e jote"

DHJETË VJET MË PARË

–E nisa para dhjetë vitesh me 53 nxënës gjithsejt e me ambiente të pakta afro 240 metra katror, nis e tregon Limani, por pa menduar se vetëm pas dhjetë vjetësh do të arrija këtu ku jam sot. Në fillim kishim 6 mësues ku drejtoreshë ishte Rudina Maksuti e nëndrejtor Mentor Hoxha.

Sot i kthehem edhe një herë atyre viteve ku kishim filluar me sistemin fillor e ja matura e katërt sot që po del nga shkolla "Sarina". Në këto dhjetë vjet shkolla jo publike "Sarina" nuk është ajo e vitit 2002 me 53 nxënës por ka pesëqind e ca nxënës. Nuk ka 240 metra katror por ka gjithsejt 4000 metra katror ndërtim si dhe po 4000 metra katror oborr, palestër, fushë futboli etj. Sot nuk kemi vetëm gjashtë mësues por kemi një personel prej shtatëdhjet vetash .Nga katër vite që kanë dalë nga maturat e shkollës "Sarina" kanë dalë gjithsejt 240

"E nisa para dhjetë vitesh me 53 nxënës gjithsejt e me ambiente të pakta afro 240 metra katror, nis e tregon Limani, por pa menduar se vetëm pas dhjetë vjetësh do të arrija këtu ku jam sot. Në fillim kishim 6 mësues, me drejtoreshë znj. Rudina Maksuti e nëndrejtor z. Mentor Hoxha."

maturant ku të gjithë kanë vazhduar arsimin e lartë, hiq këtu njëzet veta të cilët thjesht për arsye emigrimi apo martese nuk e kanë vazhduar dot. Ka studentë që sot vazhdojnë dhe në universitete të botës të cilët kanë përfunduar shkollën "Sarina". Nuk pretendoi se deri këtu ku kam arritur sot , të kem arritur vetëm. Jo!.E gjitha kjo është bërë në saj të punës së madhe dhe vërtet kualifikuese të kolektivit mësimdhënës të cilët jo vetëm që më kanë qëndruar pranë por kanë bërë të pamundurën që shkolla jonë të kishte vërtet rezultate. Dhe rezultatet në shkollën tonë kanë qenë nga viti në vit në rritje .

Në shkollën e mesme, për çdo klasë, nga e dyta deri në të tretën, ka nga tri paralele, kurse në klasat e para ka katër paralele, çka tregon se interesi për të ndjekur këtë shkollë vjen vazhdimisht duke u rritur dhe shkolla jonë asnjëherë në fakt nuk ka patur nevojë për reklama por të interesuarit e kanë kërkuar dhe e kanë gjetur vetë "Sarinën". Duke parë vërtet këtë dinamikë të rritjes së numrit të nxënësve nga viti në vit ne pretendojmë se së shpejti do të bëhemi një ndër shkollat më të mëdha në të gjithë Qarkun e Tiranës. Limani flet shumë në fakt sot, flet më shumë për shokët, mësuesit e më pak për vete.

-Unë nuk kam qenë vetëm asnjëherë dhe këtë rezultat të lartë, këto arritje të shkollës "Sarina" nuk ia dedikoj vetëm vetes e këmbënguljes time por të gjithë kolektivit mësim dhënës të cilët kanë bërë të pa mundurën që shkolla "Sarina' të arrijë këtu ku është sot.

Dhe më takon të përmend krahas emri të drejtorit zotit Besim Toçi i cili vjen në drejtimin e kësaj shkolle pas një përvoje mjaft të gjatë në fushën e mësimdhënjes edhe mësuesit e nderuar si: Azerm Teta, Shazivar Koka, Viktor Gjini, Hajrie Hoxha,Shkëlqim Salillari, Raimonda Cahoni, Miftar Velia, Tatjana Myftaraj, Bardha Qorri e mjaft të tjerë që ju kërkoj sinqerisht ndjesë që sot nuk mund ti përmend të gjithë. Shkolla "Sarina" prej kaq vitesh konkuron me shkollat më të mira në qarkun e Tiranës, në shkolla publike dhe jo publike. Nga kjo shkollë kemi nxënës që në olimpiada të ndryshme kanë marrë çmime të para dhe të dyta nxënës si Lunada Methasani, Ekzan Çakri,Taulant Prençi, Gerald Osmani e Sara Hoxha. Sot kjo shkollë ka konsoliduar jo vetëm arsimin nëntëvjeçar, por edhe arsimin e mesëm. Pranimi në shkollën "Sarina" bëhet mbi bazën e rezultaveve që nxënësit kanë arritur në klasat pararendëse. Shikohet edhe sjellja dhe qëndrimi i nxënësit ndaj mësimit dhe vlerave njerëzore.

DREJTORI KA ÇFARË TË TREGOJË

Dhe kur kishin mbaruar të gjitha e festës po i vinte fundi domosdo dhe drejtori i shkollës zoti Besim Toçi kërkon të flas.

-Edhe pse në fakt arsimi jo publik është biznes, ky është biznes elitar dhe vetë administratori ka qenë tepër i kujdeshëm në këtë drejtim .Që këtu fillon disiplina e rregulli i madh. Mjafton të bëjmë një pasqyrë të nxënësve në vite dhe kuptohet vetvetiu jo vetëm disiplina e rregulli por dhe niveli i mësim dhënjes në këtë shkollë.Nëse në vitin 2002 -2003 shkolla nisi me 53 nxënës, në vitin mësimor 2003-2004 vetëm një vit ma vonë shkolla do kishte 155 nxënës, pra trefishi i vitit të parë mësimor kur dhe shkolla ishte hapur. E sot në këtë përvjetor shkolla jonë ka gjithsejt 550 nxënës . Besoi nuk janë pak se me këto kërkesa që ka shkolla jonë i duhet të shtojë edhe më mjedise për klasa.Dhe kjo në një të ardhme të shpejtë do të ndodh se janë kërkesat e shumta ata që do bëjnë të mundur shtim hapësirash dhe mjedisesh për nxënës. E ardhmja e shpejtë e kësaj shkolle tashmë është dhe universiteti privat.Infrastruktura është gadi.

Çështje kohe dhe dokumentacioni ndaj dhe unë duhet të bashkohem me urimin e të gjithë të pranishmëve që thanë në fillim: 15 vjetori me universitet". Në fund përshëndetën të ftuarit, u shpërndanë çertefikata për nxënësit shembullor. Mimoza Gjokutaj, shkrimtarja dhe autorja e tekstit të abetares i dhuroi administratorit të shkollës Liman Hoxhës librin e abetares.

Vonë, shumë vonë njerëzit filluan të largohen por atmosfera e festës vazhdonte përsëri te "Sarina".





Në foto: Maturantët e diplomuar këtë vit dhe drejtori i shkollës, Besim Toçi. Foto. B.Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 74

edukim



© Foto. K.Alla

Nderim për mësuesit

Nga: **Zabit LLESHI, Shukri HAJDARI**

Dibra, veçanërisht Gryka e Vogël është patriote dhe arsimdashëse.Ajo mësuesin dhe shkollën e ka trajtuar si pasuri me vlera kombëtare. Populli i Dibrës i ruajti mësuesit si Seit Najdeni, Haki Stërmilli, Haki Sharofi, Jashar Zeneli, Hazhi Ademi, Abaz Xhafa, Fasli Cami, Zenepe Miftari etj, u krijoi mundësinë dhe i ndihmoi konkretisht për mësimin shqip e hapjen e shkollave në Malësitë e Grykës së Vogël.

Për rolin dhe misionin e mësuesit kanë folur shumë personalitete dhe figura te shquara të shoqërisë njerëzore. Pasi u hapën shkollat të gjithë kaluan nëpër duart e mësuesve, ndjemë përkëdheljet, shijuam buzëqeshjen, këshillat dhe kujdesin për mirërritjen, na mësuan të duam njerëzit, familjen, Atdheun.

Të nderosh e respektosh mësuesin është kulturë, emancipim shoqëror por jo vetëm kaq. Kjo tregon edhe shkallën e zhvillimit të një shoqërie, nivelin e përparimit të demokracisë në evoluim dhe prosperitet.

Të nderosh mësuesin është nderim për popullin, për kombin tënd.

Respekt për sakrificat e patriotëve tanë që luftuan me pushkë e penë për gjuhën shqipe duke flijuar jetën, familjen dhe pasuritë për t'i dhënë popullit dije dhe kulturë.

Dibra, veçanërisht Gryka e Vogël është patriote dhe arsimdashëse.Ajo mësuesin dhe shkollën e ka trajtuar si pasuri me vlera kombëtare. Janë të shumtë shembujt e kësaj natyre, që tregojnë për njëkulturë të hershme dhe që u transmetua brez pas brezi. Populli i Dibrës i ruajti mësuesit si Seit Najdeni, Haki Stërmilli, Haki Sharofi, Jashar Zeneli, Hazhi Ademi, Abaz Xhafa, Fasli Cami, Zenepe Miftari etj, u krijoi mundësinë dhe i ndihmoi konkretisht për mësimin shqip e hapjen e shkollave në Malësitë e Grykës së Vogël.

Këto motive i nxitën këshilltarët e Komunës Gjoricë që në kuadrin e 100 Vjetorit të Pavarësisë, si veprimtari e parë të këtij viti jubilar ta hapë me dekorimin e disa mësuesve si "Qytetarë Nderi" .

Kryetari i Komunës, Vehbi Xheka, një djalëi ri energjik, gjithnjë i qeshur entuziast bëri realitet së bashku me këshiilltarët e tij nismën që një grup mësuesish të shkollës 9-vjeçare Gjoricë ndërmorrën duke i propozuar dekorimin e mësuesve që disa dekada punuan në shkollat e Gjoricës.

Sheh Latifi, Haxhi Ademi u vlerësuan për hapjen e shkollës shqipe në Gjoricë 1925, konsolidimin e vazhdimin e shkollës gjatë viteve të luftës.

Shyrete Sharku ndër vajzat e para mësuese në Grykën e Vogël, për ta vazhduar profesionine mësueses në Zerqan, Gurë të Bardhë (Mat), dhe Bulqizë.

Zenepe Gjata (Miftari)një vajzë e re nga Elbasani erdhi nëÇerenec ku dhe krijoi familjen e saj.

Beqir Mera, Rexhep Lika, Liman Dani, Zenel Cela, Ilmi Gjura, e Besim Turja filluan karrierën e mësuesisë në luftën kundër anafalbetizmit, konsolidimin e shkollës, gjallërimine kulturës dhe ruajtjen e traditave në këtë fshat.

Elez Xheka e Bukurije Kaja (Lleshi) morën vlerësimin për një kontribut të veçantë si drejtues të shkollave. Për 30 vjet sidrejtues i shkollave në Shupenzë, Elez Xheka drejtoi me kompetencë dhe vizion duke i rradhitur shkollat e Grykës së Vogël në pararojë të Republikës. Ndërsa Bukuria si drejtuese dhe deputete (në 2 legjislatura) punoi për emancipimin e gruas, për mësimin dhe mënyrën e jetesës në Gjoricë, Majtarë e Maqellarë.

Ceremonia për dhënien e dekoratave u organizua në ditët e para të Qershorit, ku merrnin pjesë, të afërm të mësuesve të dekoruar si dhe nxënës të shkollës 9 vjeçare Gjoricë.

Kryetari Vehbi Xheka duke hapur ceremoninë tha se: "Të gjithëi kujtojmë mësuesit tanë, gjithnjë kemi ndier kujdesin e tyre për tu rritur të shëndetshëm me edukatë e kulturë, për të dashur e respektuar prindërit, shokët, Atdheun. Jeta dhe vepra e mësuesve që dekorojmë sot do të jetë një burim frymëzimi për të gjithë brezat e Komunëstonë ".

Për të përshendetur nismën e Komunës por edhe për të respektuar popullin e Gjoricës, në këtë ceremoni merrte pjesë Prefekti i Qarkut Dibër Z. Genc Sharku. Ai pasi vlerësoi punën e Komunës dhe Shkollës së Gjoricës që nga themelimi i saj 90 vjet më parë i emocionuar tha: "Sot kam edhe një detyrë tjetër të marr prej jush këtë dekoratë të nënës sime Shyrete Sharku ku një pjesë të jetës së saj e kaloi në gjirin e familjeve gjoricare e rrethuar plot dashuri e respekt, për të cilin ju jam shumë mirënjohës".

Tashmë si Qytetar Nderi përshëndetën edhe Elez Xheka, Bukurije Kaja, Ilmi Gjura, si dhe Ylli Miftari djali i Zenepe Miftarit, Shkëlqim Shehu nipi i Sheh Latifit, të afërm të mësuesve të dekoruar Ramazan Miftari, si prind etj.

Drejtori i shkollës Z.Shaban Izvira,nxënësit dhe mësuesit veçanërisht Shukri Hajdari e Hajri Alimani krijuan një atmosferë festive me këngë dhe recitime të përgatitur nga vetë nxënësit. Veprimtaria u kthye në një manifestim popullor duke krijuar emocione të forta dhe mbresëlënëse. Pas mbylljes së ceremonisë pjesëmarrësit vazhduan takimet mes tyre duke sjellë kujtime nga jeta e shkollës deri vonë. Ato u ndanë me lot në sy me urimin :

Faleminderit komuna, mirupafshim Gjorica!

Nisma e Komunës Shupenzë, Gjoricës, Zerqanit në rrethin e Bulqizës për vlerësimin e punës së njerëzve që kanë dhënë kontribute të veçanta duhet përshendetur e duhet të shërbejë si shembull për komunat e tjera.

Njerëzit gjatë punës krijojnë vlera, ato duhen njohur, mirëështënë gjallje, larg punës me fushata.

Histori njerëzore

Si i linda dhe rrita 18 fëmijë

Historia e jetës së nënës 70 vjeçare Xhaje Kuka, që lindi 18 fëmijë në kushtet e shtëpisë.



Vetëm rreth 5 kilometra larg Qafës së Buallit, në të majtë të rrugës nacionale drejt Burrelit, në një lagje të fshatit Plan i Bardhë, të bashkisë së Klosit në rrethin e Matit, na rastisi të njihemi me historinë e nënës 70 vjeçare Xhaje Kuka, e cila lindi dhe rriti 18 fëmijë. Nëna aktualisht gëzonte një shëndet të plotë për tu admiruar.

"Unë, - nis dhe tregon nëna, - kam ardhur në këtë shtëpi nga një fshat këtu afër, kur kam qenë vetëm 14 vjeçe, kuptohet pas një martese me shkuesi. Fëmijën e parë e kam lindur kur kam qenë 17 vjeç, dhe më pas pothuajse për çdo një apo dy vite linda edhe 17 fëmijë të tjerë, që vinin njëri pas tjetrit. Isha e vetmja nuse në shtëpi. Jetesa ishte shumë e vështirë, pasi nuk plotësohej asnjë lloj kushti për një jetesë normale. Ndaj duhej të bëja të gjitha punët e shtëpisë, si dhe të punoja në kooperativë, pa harruar edhe shërbimet për vjehrrin e vjehrrën sipas zakoneve të kohës. Dhe imagjinoni të gjitha këta shërbime duhej të bëheshin në kushtet kur unë isha shtatzënë, kujton Xhaja. Fëmijët vinin radhë. Të gjitha lindjet janë bërë në kushtet e shtëpisë, pa prezencën e mamisë apo infermieres që në atë kohë mungonin në fshatin tonë. Madje dy nga këto lindje janë bërë në mal. Duhej të bëja nga punët më të rënda fizike, siç ishte edhe ajo e mbajtjes së druve të zjarrit në kurriz. Ishte dimër. Shtatzënë në muajin e fundit, ngjitem lart në pyll për të marrë dru zjarri. Mëngjes herët poshtë në fshat asnjë oxhak nuk nxirrte akoma tym. Mes dhimbjeve të forta të lindjes, bëj barrën e druve, por lind edhe fëmijën të cilin e mbështjell me teshat e trupit. Në pamundësi të marr gjithë barrën e druve të zjarrit, pasi duhej mbart edhe foshnja e sapolindur, mbart në shpinë vetëm gjysmën e saj, për t'ju ruajtur përgojimit pasi do thoshin shkoi nusja në mal dhe u kthye pa dru. Vështirësitë vinin në rritje. Asnjë ndihmesë apo lehtësim e përkujdesje nga shteti i asaj kohe edhe pse thuhej se nënat me shumë fëmijë gëzojnë favore. Kushtet mizerabël të kësaj jetese, bënë që nëna të humbë 8-të nga fëmijët e saj. Jo që nuk gëzova asnjë favor, por kërkohesha të dal për çdo ditë në kooperative. Nëse nuk realizoja ditët e punës, më kërcënonin me pushimin nga puna të burrit, i cili punonte në minierë dhe siguronte një rrogë me të cilën kavatoheshim të gjithë si familje dhe rritnim fëmijët.

70 vjeçarja Xhaje Kuka, nënë e 18 fëmijëve dhe 52 nipërve e mbesave edhe sot mbahet mjaft mirë fizikisht. Ajo ende vazhdon të punojë në ndihmë të familjes së saj. Por, duket se vështirësitë e jetës ende vazhdojnë ta ndjekin atë. Fshati jonë në shumicë ka lëvizur drejt Tiranës dhe Durrësit, fare pak familje kemi mbetur këtu, pasi nuk kemi kushte jetese. Kryesorja, vijon të tregojë Xhaja, mungon rruga dhe uji, që na e vështirësojnë shumë jetën në këtë fshat. Për 20 vite demokraci asgjë nuk është bërë në fshatin tonë.

E lëmë nënë Xhajen duke mbartur ujë në shpinë me bucelë dhe teksa largohemi prej saj, ndjehemi të mrekulluar nga historia e jetës së saj, që për nga numri 18 i lindjeve të fëmijëve dhe veçanërisht kushteve skandaloze të këtyre lindjeve, përbën ndofta një rast për librin e rekordeve Gines.

HYSEN LIKDISHA

debat

Beteja e Torviollit u zhvillua në Fushën e Kalasë

Nga: **DESTAN RAMA**



Gryka e Madhe. © Fotot.D.Rama



Fusha e Kalasë (Torvjollit)

Skënderbeu, ky burrë trim, atdhetar i flaktë, njeriu i besës dhe i shpatës, që me bëmat e tij çuditi Evropën madje edhe botën është bërë sot objekt debati për të zbuluar të vërtetën mbi veprën e tij.

Seç më duket (qofsha i gabuar) sikur është bërë si mollë sherri për studiuesit, historianët e jashtëm, por edhe të brendshëm. Secili nga ata përpiqen ta identifikojnë atë si shtetasin e tyre, apo si të trevës së tyre. Madje edhe betejat e tij si të ndodhura në krahinën e tyre.

Më pëlqen dhe e vlerësoj debatin e çelur nga gazeta " Rruga e Arbërit" për vendin ku u zhvillua Beteja e Torviollit, ndaj dëshiroj që edhe unë të bëhem pjesë e tij, të jap kontributin tim për këtë problem.

* * *

Historiani Kristo Frashëri në librin e tij "Skënderbeu, jeta dhe vepra" kreu 8, Kuvendi i Lezhës dhe Beteja e Torviollit (1444) fq. 134, na njeh me situatën në të cilën ndodhej vendi pas kthimit të Skënderbeut në Krujë, si edhe masat që u morën për të përballuar armikun. Ndër të tjera ai thekson: "Marrja e Kalasë së Krujës nga Skënderbeu pa përleshje të armatosur me ushtritë osmane u bë e mundur ne sajë të fitores ushtarake të Huniadit dhe të gatishmërisë së popullsisë së kësaj treve, pa mohuar parapërgatitjen e kujdesshme te kthesës dhe pjesërisht rolin e fermanit të rremë. Si e tillë kthesa e nëntorit 1443 ishte një fitore politike, por jo ushtarake përderisa nuk pati asnjë ballafaqim si ato te Arianitit dhe Zenevisit me armatat turke. Ballafaqimi i armatosur ishte i pashmangshëm. .."

Po aty, në faqet 135, 138 mësojmë se më 2 mars 1444 (datën e jep Biemi) u mblodh Kuvendi i Lezhës, ku Skënderbeu u zgjodh kryetari i vetëm i Besëlidhjes dhe komandant i përgjithshëm të zotave të Shqipërisë. Si i tillë dhe si strateg lufte që ishte, në zbatim të vendimeve të Lidhjes mori masa efikase për të përballuar ushtritë turke. Ndër ta, pajisja me një ushtri të përbashkët, meremetoi dhe forcoi kalatë, vëzhgoi shtigjet, grykat e luginat e vendit, ku vendosi informator për të lajmëruar sa më parë me lajmëtarë të shpejtë ose me shenja zjarri afrimin e armikut. Me këto masa që mori ushtria shqiptare, ishte gati për të hyrë në luftë.

I rendita këto fakte që flasin për situatën në të cilën ndodhej vendi në atë kohë si dhe masat që u morën nga shteti i parë shqiptar i dalë nga Kuvendi i Lezhës, në rang vendi, por edhe për çdo krahinë për të dhënë argumentet e mia se Beteja e Torviollit u zhvillua ne Fushën e Kalasë (Torviollit).

Së pari.Ku ndodhet Fusha e Kalasë?

Fusha e Kalasë ndodhët në Dibër në Grykën e Madhe, komuna Zerqan. Në rrugën nacionale Peshkopi-Tiranë, rreth 8 km pa arritur në Bulqizë, do të përballesh me një grykë të ngushtë mali që e ngushton hyrjen për në luginën e Bulqizës. Si e tillë është vendi me i përshtatshëm për të zënë pusi armikut ndaj edhe Skënderbeu e pikasi atë për të realizuar qëllimin e tij strategjik (shfrytëzimin e terrenit) të pritshëm.

Në Grykën e Qytetit, në të majtë të rrugës automobilistike ndodhet Ura e Qytetit. Në një kodër shkëmbore mbi të, 609 m mbi nivelin e detit ka qenë i vendosur qyteti i Valikardhës. Në kujtesën e banorëve të zonës mendohet që ky qytet të ketë pasur deri në 12 000 shtëpi dhe zinte një sipërfaqe rreth 0.1 ha. Qyteti kishte kalanë e tij. Sundimtari i vendit kishte ndërtuar një statujë ku paraqitej një kalë me fre me kalorësin sipër. Gërmadhat e kalasë dallohen edhe sot. Nga kalaja e qytetit mori emrin Fusha e Kalasë, nga qyteti mori emrin Ura e Qytetit. Pranë qytetit kalonte rruga antike e karvaneve Dibër-Tiranë-Durrës. Fusha e Kalasë njihet edhe me emrin Fusha e Torviollit. Tregimtarët popullore në kujtesën e tyre thonë se kur u shkatërrua qyteti nga armiqtë në gërmadhat e tij, por edhe në tërë fushën mbiu një lloj bime që njihej nga vendësit me emrin "Volle"(bimë që bëjnë fruta të shijshme). Fushë e mbushur e tëra (tërë volle). Këtë thënie e pohon edhe studiuesi Agim Boba anëtari i Akademisë së Shkencave Shqiptaro- Amerikane, New York, marrë nga interneti.



Kulla e Skëndërbeut,mali i Temlës

Fusha vjen në formën e një lugu me fund të rrafshët me zgjatim nga jugu. Këtë formë duket sikur ia japin malet që e rrethojnë në të tri anët por me dalje,me rrugë këmbësore në gryka e qafa me të vogla. Konkretisht nga perëndimi dilet në Fushën e Lopës, nga veriu në Fushën e Liqenit të Bardhë - Liqeni i Sopeve, nga lindja përroi i Kazjakut - fusha e Zerqanit.

Ngjitur me fushën nga lindja e saj ndodhet fshati Valikardhë, pronë e të cilit është edhe ajo sot. Nisur nga përshkrimet që i bëjnë Fushës së Torviollit historianët si edhe nga strategjia e luftës e taktikat që përdori Skënderbeu për ta futur armikun në kurth në fusha a lugina të ngushta, mendoj se kjo i plotëson të gjithë treguesit.

Së dyti. Zalli i Buqlizës e ndan shkëmbin e qytetit nga Kulla e Skënderbeut, e cila është e pozicionuar në majën e shkëmbit gëlqeror në anën tjetër të zallit (në veri) i quajtur mali i Temlës. Këtu Skënderbeu vendosi pikën e vrojtimit e cila komunikonte me pikat e tjera të vrojtimit në vijën ajrore mali i Banjishtit mbi qytetin e Dibrës, maja e Lepurit(Qafë Buall) e më tej deri në Krujë. Ndërlidhja bëhej me vrojtues të shpejtë me flamur ose shenja zjarri. Rrugën për në malin e thepisur Skënderbeut ia tregoi një bari dhish, ku edhe sot njihet me emrin " Kalldrëmi i Mushkave". Bariu i dhuroi Skënderbeut një dhi,si simbol i fitores. Me emrin e dhisë dhe të pelës ka lidhje edhe emri i fshatit Peladhi që shtrihet në këmbët e malit të Temlës, që ngrihet mbi fshat, në veri, në formën e një gjysmëharku.

Së treti. Në prapavijë të ushtrisë së tij Skënderbeu ndërtoi për qëllime lufte një punishte katrani tek Livadhi i Ballit në lindje të zonës D. Katrani prodhohej nga rrëshira e pishës. (I. Kaca "Dibra në faqet e një ditari arkeologjik fq. 214.)

Së katërti. Gryka e Madhe është e vetmja grykë me përmasa më të mëdha se të tjerat, e cila ka shërbyer si urë kalimi duke lidhur dy Dibrat e më tej me internerarin Dibër- Qafa e Buallit – Plani i Bardhë- Guri i Bardhë- Shkalla e Tujanit- Tiranë (e njohur me emrin Rruga e Arbërit).

Ushtria turke e kishte më të përshtatshme dhe më të shkurtër rrugën për në kryeqendrën e Skënderbeut për të realizuar qëllimin e saj strategjik, pushtimin e Kalasë së Krujës dhe të rifitonte zotërimet e mëparshme.

Së pesti. Distanca nga Fusha e Kalasë, ku u zhvillua Beteja e Torviollit, në drejtimin Qafa e Buallit- Qafështame-Kala e Krujës nuk e besoj t'i kalojë 30000 hapa, siç e pershkruan Barleti në librin " Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, Princit të Epirit". Të gjitha këto masa që mori Skënderbeu bënë të mundur që ushtria e tij të përballej me ushtrinë më të madhe e më të fortë të kohës siç ishte ajo e sulltanit turk. Ky rast më në fund erdhi.

Një ushtri e madhe prej 25000 vetësh e komanduar nga Ali Pasha u nis nga Shkupi në drejtim të Shqipërisë. Ajo marshoi në Luginën e Radikës dhe doli në Rahonik. Skëndërbeu i lajmëruar për afrimin e turqve u doli përpara. Ushtritë u rreshtuan përballë njëra-tjetrës në Fushën e Dibrës.

Sipas planit të Skënderbeut ushtria shqiptare manovroi me mjeshtëri dhe u tërhoq, sikur të ishte e thyer derisa e futi ushtrinë turke në grykën dhe fushën e ngushtë të Torviollit me synimin ta pengonte atë me çdo kusht të mos hynte në Luginën e Bulqizës e të dilte në Qafën e Buallit. Ushtrinë e ndau në disa grupe. Vetë qëndroi në krye të kalorësisë, me luftëtarët e grupimit të qendrës. Në pyjet rrotull fushës ishin fshehur grupimet e tjera të forcës së rezervës nën udhëheqjen e komandantëve trima.

Në përkujtim të kësaj beteje është ngritur një përmendore në Grykën e Madhe, tek Ura e Qytetit, në hyrje të Fushës së Torviollit buzë rrugës automobilistike. Kësaj përmendoreje jo vetëm që nuk i duhet hequr pllaka, por duhet të restaurohet plotësisht, si simbol i zhvillimit të betejës së Torviollit, si modeli i fitores së parë të Skënderbeut ndaj ushtrisë turke.


Me 29 qershor 1444 në mëngjes filloi sulmi nga shqiptarët. Qe një sulm i furishëm me forca kalorësiake dhe këmbësorie me trungje, breza zjarri e hedhje gurësh nga shpati lindor i Temlës. Beteja arriti kulmin kur në fushën e betejës hynë forcat rezervë të fshehura në male duke e zënë armikun në kurth nga të gjitha anët. Luftëtarët e Skënderbeut luftuan heroikisht dhe arritën një fitore të shkëlqyer. Kjo fitore tërhoqi vëmendjen e gjithë Evropës. Populli i Grykës së Madhe e kujton këtë betejë me vargjet e këngës:

"Prej Torviollë m'Qafë Petralba,
Gjithë Torviolla m'gjak është la,
Me xhenaze mbush kala'
Nje pllamë tokë pa t'vdek nuk ka."

Në bazë të një studimi të kryer nga studiuesit dibranë Selim Alliu dhe Hilmi Sadiku "Mbi lokalizimin e disa betejave te Skënderbeut " mbajtur ne Konferencën e parë studimore shkencore e kulturës popullore dhe historisë te rrethit te Dibrës (dhjetor 1976) botuar në "Dibra dhe Dibranët" fq. 42,48 në përkujtim të kësaj beteje është ngritur një përmendore në Grykën e Madhe, tek Ura e Qytetit, në hyrje të Fushës së Torviollit buzë rrugës automobilistike. Kësaj përmendoreje jo vetëm që nuk i duhet hequr pllaka, por duhet të restaurohet plotësisht, si simbol i zhvillimit të betejës së Torviollit, si modeli i fitores së parë të Skënderbeut ndaj ushtrisë turke.

Mendoj se çdo gjykim ndryshe do të ishte i pavlefshëm.

Naim Berisha - poeti i jetës, atdheut, familjes dhe dashurisë



Nga**: BARDHYL XHAMA**
Mësues i merituar, Shkrimtar

KUSH ËSHTË NAIM BERISHA

Naim Berisha është dibran, nga një familje me tradita të shquara patriotike. Mbasi kreu shkollimin tetëvjeçar dhe të mesëm, mbaroi Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë për gjuhë e letërsi shqipe në vitin 1985.

Punoi, pastaj, si mësues i gjuhës dhe i letërsisë, mësues muzike, drejtues kulture në terren dhe në ushtri. Më pas, në Peshkopi, në Burrel dhe më në fund në Tiranë si gazetar dhe drejtues shkolle.

Në vitin 1998 emigron në Londër, ku jeton edhe sot. Aty ka kryer edhe disa kualifikime pasuniversitare, për media, muzikë, kritikë letrare, letërsi angleze etj. Punon si mësues gjuhe e letërsi angleze në një shkollë në Iling Brooduej, në Londër.

Naim Berisha ka një krijimtari të pasur në fushën e letërsisë artistike, duke lëvruar shumë gjini, ka shkruar romane, vëllime me tregime, poema, vëllime me poezi etj. Libri me poezi "Vjershë e ndaluar", botuar nga Shtëpia Botuese "Toena", është libri i pesëmbëdhjetë.

VËLLIMI ME POEZI "VJERSHË E NDALUAR", STRUKTURA, KOHA E KRIJIMIT

Libri poetik "Vjershë e ndaluar" u përurua pak ditë më parë në sallën e Akademisë së Shkencave. Vëllimi ka 140 faqe, përmban 107 poezi (një është poemë), i ndarë në 5 kapituj: "Pikëllimë", "Gjuha ka zemrën dhe sytë e poetit", "Ngryset lumturia", "Melhem për plagë", "Delli dhe padielli".

Koha e krijimit të këtyre vjershave është nga viti 1976 e deri më sot. Por shumica dërrmuese e poezive, 60, janë pas vitit 2000 dhe vetëm 14 poezi janë para vitit 1990. Kjo shtrije në kohë ka pasuruar tematikën, përmbajtjen dhe mesazhet që jepen nga autori.

Gjeografia e krijimit-pasuri tematike

Për mua ishte kuriozitet, por shpresoj se kështu do të jetë edhe për ju në sallë, po t'u them se Naimi frymëzimin poetik dhe shkrimin e vjershave e ka bërë në 14 vendbanime të Shqipërisë, ku vendin qendror e zë Peshkopia me 8 poezi e pastaj Tirana , Burreli e Fushë- Muhurri. Poezi janë shkruar në Korçë, Pogradec, Durrës, Shkodër, Sarandë, Kavajë etj.

Por më interesant është fakti se poezitë më të shumta janë skruar në shtete e qytete, që ndodhen në të katër anët e botës. Dhe nuk janë pak, por rreth 60 poezi. Ama, shumica, rreth një e treta e tyre, janë shkruar në Londër, ku jeton e punon, pa përfshirë ato të Glaskout, Birmingamit, Oksfordit, Kembrixhit, Liverpulit e në shumë qytete te tjerë. E kuptueshme kjo për të gjithë ne.

Vargu i "vendlindjes" së krijimeve vazhdon i gjatë, në disa shtete, si Çeki, Rusi, Tajlandë, Itali, Greqi, Kosovë, Maqedoni, Turqi, Portugali. Spanjë, Japoni e të tjera. Po përmendim dhe disa kryeqytete e qytete të botës ku Naimi ka shkruar poezitë e tij të këtij vëllimi: Dublin, Pragë, Moskë, Stokholm, Petersburg, Stamboll, Hong Kong, Bruksel, Lisbonë, Barcelonë, Pekin, Tokio e shumë e shume të tjerë. Dhe këto që u them janë tërësisht të sakta, sepse autori ka shkruar me dorën e tij në fund të çdo poezie vendin dhe datën e krijimit.

Nuk është se krijimet u janë kushtuar shteteve e qyteteve ku janë shkruar, sepse ato, në pjesën dërmuese, janë frymëzime të çastit të autorit, shumica për mëmëdheun, por që tregojnë se poezia nuk thuret duke u ulur në karrige e duke shkruar për ditë e javë me radhë, siç mund të shkruhet një roman. Ajo kërkon momentin, kërkon frymëzimin dhe ai vjen në çaste të caktuara.

Është vështirë të gjesh një poet, jo vetëm këtu, por dhe në botë, që 107 poezi të jenë shkruar në 55 vende të ndryshme të globit!

ATDHEU, VENDLINDJA DHE FAMILJA NË POEZITË E VËLLIMIT

Nuk është e rastit që autori u kushton disa nga poezitë më të ndjera Atdheut, vendlindjes dhe familjes. Që në gen familja e Naim Berishës është mbrujtur me atdhetari e trimëri. Dhe, me sa duket, edhe autori e ka shumë të spikatur këtë gen. Poeti i mirënjohur Fatos Arapi ka thënë: "Poezia e Naimit është e veçantë. Ajo mbart historinë dhe filozofinë e Dibrës, vendlindjes së tij..., ka identitet dhe mua më ka pëlqyer". Këto poezi lidhen pazgjidhshmërisht edhe me emigracionin, ku autori ka provuar vështirësitë e ndarjes nga mëmëdheu e familja e gjerë, mallin e brengën, por dhe punën e ndershme e suksesin.

Janë të shumta poezitë me këtë temë. Do të përmendim disa prej tyre. Te vjersha "Mëmëdheu" autori nënvizon:

"Më i ëmbël se buka që shtron në tryezë,
Më i bukur se lulja që çel me plot gaz...!
Unë, jam yt bir, gjersa të vdes,
Edhe pas vdekjes, ty të përkas."

Të arrira janë poezitë "Vajzat e Radomirës", që me qumështin që i vjelin hënës, mëkojnë çdo rreze dielli, "Zilet e tufës", ku autori ka mall për mal e det, për sofatet, për gjyshen që e pret në shtrojet e lëkurta, për shiltet e minderet dibrane, për të qeshurat në sokak, etj. Te vjersha "Vajzëria" gjejmë vargjet "Skuqin faqet e vajzave, si dikur mollët e Peshkopisë". Të kësaj teme janë poezitë "Skënderbeu është dibran", "Pikëllimë", "Gjuha e Naimit", "Si gjithë shqiptarët", etj:

Mjaft të ndjera janë poezitë që lidhen me familjen dhe vetë autorin. Përmendim disa prej tyre. E nisëm me vjershën "Pusullë". Janë 11 vargje të skalitur, kuptimplote, prekëse. Lexojini:

"Nga larg
Fisit tim
Po i nis një pusullë...
Shkronjëzon
Shpirti im,
Nis mallin për udhë.
Loti,
Përshkon kartën
Si një curril drite.
Po ju dërgoj zemrën,
Njerëz të tokës sime."

Të tilla janë dhe vjershat "Për prindërit dhe për vete" ,"Ne ishim çetë", "Ngryset lumturia" (kushtuar të ëmës në përvjetorin e ndarjes nga jeta), "Ç'borxh ju pati ati im" , "Fisi Berisha", "Të premtet e mia terse", ku rikujton dhe vdekjen e babait dhe , si emigrant, nuk mori dot pjesë as në mort. Në dy vargjet e fundit, thuhet:

"Para se të vdes,
Eshtrat do të mi brejë pengu në gji".

Me emigracionin lidhen veçanërisht poezitë: "Për ngushëllim" (tek një anglez), "Në Mbretërinë e Bashkuar", "Dekor", "Vera më zë", Njerëzore" etj.



Në foto: Naim Berisha dhe kopertina e librit "Vjershë e ndaluar"

AKTUALITETI I PARË PËRMES SYRIT TË AUTORIT

Ngjarjet e kohës që ka jetuar dhe jeton, që lidhen kryesisht me mëmëdheun, nuk kanë mbetur pa lënë gjurmë në krijimtarinë e Naimit.

Përmendim këtu poemën "Kali i të këqijave", të vetmen poemë të vëllimit. Autori e thekson që në nën titull: "Kushtuar gjithë poetëve të kohës së diktaturës, të cilët, në një formë a në një tjetër, të gjithë kanë qenë kundër asaj bote të egër". Poema mbart vlera të veçanta artistike dhe ideore. Po citoj vetëm një strofë:

"Sirtar i fshehtë ish bërë fjala jote,
Liria e fshehur në strofa e vargje,
Ngado që hidhje hapin e kishe një roje,
Në pyll e në arë, në udhë e në lagje..."

Ose le të marrim vjershën "Lufta", shkruar në Londër më 2002. Po lexoj 4 vargje:

"Ku nuk u thurën çerdhe lufte,
Çdo gjë barrikadë u bë....,
Rrënjë ulliri s'mbeti pa u shkulur,
Vetëm për paqen s'flitej më"

Ngjarjeve tragjike të vitit 1977, i është kushtuar dhe sarkazma "Kështu ka ndodhur", një poezi shumë e ndjerë , ku autori përshkruan me vargje therëse e prekëse "luftën e turpshme mes njëri-tjetrit" dhe përfundon:

"Kështu ka ndodhur në nëntëdhjetë e shtatën,
U vranë buzëqeshjet, bisqet e njoma."

Me këtë tematikë ka edhe poezi të tjera, çka tregon se autori, edhe pse jeton prej shumë vjetësh jashtë atdheut, asnjëherë dhe për asnjë çast nuk e ka ndjerë veten larg tij, ka jetuar me hallet e shqetësimet e vendlindjes.



FSHIKULLIMI I ZAKONEVE DHE VESEVE TË KËQIJA

Në disa nga poezitë e vëllimit që po paraqesim trajtohen me gjuhë poetikë zakonet dhe veset e këqija, si plagë të shoqërisë sonë të së kaluarës, por dhe të sotme. Vjersha "Gjak në Këmishë" flet për gjakmarrjen, si dhe vjershat "Burri matet me zemër", apo "Qyqja". Janë krijime të shkurtra, me pak vargje, por që japin mesazhe të qarta.

Vend të veçantë zënë poezitë për veset e njeriut. Në vjershën "Brenda dhe jashtë kohës zyrtare" zyrtari i korruptuar bëhet qëllimkeq i dyfishtë, që me një gur kërkon të vrasë dy zogj, tek "Sorra" thuhet se mezi kalon provimin e shkollës, ndërsa në provimin e jetës i bien puplat, te "Interesi" lexojmë se "sot për interes, dhe vëllai të vret", te "Ju vraftë buka" esenca e mesazhit jepet në vargjet " Të pabesë paskeni qenë, / Ju vraftë buka që ju kam dhënë", te poezia e fundit e vëllimit "Pema e ullirit" vlerësohet modestia, puna pa zhurmë e pa bujë, si e ullirit, që thotë shumë edhe kur "Fëshfërijnë, blertësisht/ Këto pemë mahnitëse/ Pa bujë pa zhurmë". Të kësaj natyre janë dhe vjershat "Grifshë", "Koha dhe dreqi", "Bushtra", Fluturaçkë" etj.

POEZITË E DASHURISË DHE LIDHJA ME JETËN INTIME

Poezitë e dashurisë zënë një vend qendror në këtë vëllim. Nervi poetik i autorit këtu merr një dritë të veçantë, vezulluese, madje hera-herës magjepsëse. Dhe shpesh herë, poezitë kanë brenda intimitetin, Naimi vargëzon artistikisht për ngjarje e ndodhi që duket se i ka përjetuar, si të thuash, e prek vetë bukurinë e vajzës, e përshkruan si e ndjen, si e sheh dhe jo nga një këndi largët.

Janë shumë poezi të tilla, por po citojmë vetëm pak prej tyre, si ato me tituj "Dreçkë", "Sa dëshirë", "Burrë e grua", "Djaloshi", " Vjershë e ndaluar" nga ka marrë edhe titullin vëllimi, ku adoleshenti shpërthen si

botime

vullkan në dashurinë ndaj mësueses. Mjaft të goditura janë dhe vjershat "Margaritë", "Mjegull", "Pranverore", " Mbrëmje me kashtën e kumtrit", "Flokëverdha" (që siç e përmendëm më lartë e ka shkruar në Pekin), "Do vete vrik një ditë në Lezhë", vjershë e bukur ku autori niset të takojë një ish-dashnore të hershme, ku i kërkon nëse i ka mbetur qoftë edhe një thërrime nga buka e vjetër.

Por kemi edhe një rast tjetër intimiteti. Në Uells, për shembull, Naimit i ka zënë syri ndonjë vajzë të bukur dhe nuk është përmbajtur deri sa të thurë poezinë "Efemere". Po e citojmë:

Kam përballë,
Një vajzë,
Një yll
Seç pikon një shi në diell.
Xhevahir i rrallë.
Ah ç'femër...!
Shih me sy e plas me zemër."

Karakteristikë e vjershave të dashurisë është shkurtësia , mesazhi jepet me pak vargje e fjalë të zgjedhura.

* * *

Së fundi, por jo nga rëndësia, autori na përcjell në këtë vëllim poezi me vlera të veçanta për njerëz konkretë, që shquhen në fusha të ndryshme të artit, apo për shokë e miq të autorit, të ndarë nga jeta para kohe në mërgimin e hidhur.

Veçojmë vjershën për Dritëro Agollin, që, për mendimin tim, është si një lapidar përsëgjalli që i ngrihet poetit të madh. Vetë Naimi e quan 'Ditiramb për poetin më të madh të shqipes së gjithkohshme letrare". Më lejoni të citoj disa vargje, me gjithë se është vështirë të zgjedhësh:

"Ti, një shkëmb i gdhendur, flokëbardhë
Nga mielli i magjes së madhe të shijeve.
E di. Dhe në shekujt që kanë me ardhë
Ti mbetesh Monarku i gjithë poezive.


Shumë e ndjerë është poezia kushtuar Vaçe Zelës, të cilën autori e quan "ujëvarë magjepsëse, që çmend madhështinë", "Personifikimi i diellit / Pas stuhisë së vjeshtës". E tillë është edhe vjersha kushtuar këngëtarit të shquar dibran Arif Vladi. Me tone prekëse, epike, shkruar me dhimbje shpirti, janë dhe dy poezi kushtuar miqve të tij të ndarë nga jeta në moshë të re në dhe të huaj. Të tilla janë "Epitaf për Fitimin" dhe "Rustemi".

PËRFUNDIM

Libri "Vjershë e ndaluar" e Naim Berishës mendoj se do të radhitet me dinjitet në librat më të mirë me poezi të botuar kohët e fundit. Vargu i skalitur, herë i lirë e herë i rimuar, gjuha e përpunuar letrare, me figura të përdorura me mjeshtëri e jo të stisura, përdorimi i fjalëve e shprehjeve popullore, mesazhet që mbartin poezitë e vëllimit në fjalë, e radhitin autorin ndër poetët më në zë të këtij njëzetvjeçari. Dhe, ashtu siç ka thënë Dritëro Agolli për Naimin që në vitin 1996 : "Deri tani e ka përballuar me sukses maratonën e pamëshirshme në hapësirën e poezisë...Naimi premton shumë për të ardhmen" . Parashikimi i Dritëroit ishte shumë i saktë. Naimi që nga ajo kohë e deri më sot ka ecur përpara në gjithë krijimtarinë e tij shumëplanshe. Dhe ecën e ecën gjithmonë përpara me vepra të tjera të përfunduara, që presin dritën e botimit.

Do të veçoj, së fundi, thirrjen që bën i ndjeri Bedri Dede, për poezitë e Naimit, me të cilin bashkohem plotësisht : "Lexojini me vëmendje poezitë e tij dhe do të vëreni se ato mbartin karakteristika të veçanta të shprehura me një figuracion funksional".

Ja, pra, kjo është thirrja, me të cilën bashkohem edhe unë e i ftoj të bashkohen dhe lexuesit.



Libra që përcjellin mesazhe njerëzore

Mesazhet në librat e Abdurahim Ashikut janë të ngrohta, të thëna me shumë dashuri, thjesht, qartë dhe me hijeshi



Prezantohet vepra letrare e publicistit të mirënjohur, Abdurahim Ashiku

Nga:
ILIAZ BOBAJ

Në seminarin e 5-të të Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi, i cili u zhvillua në qytetin e Patrës në datën 24 qershor të këtij viti, pati edhe një intermexo tepër interesante, e cila u prit me interes të veçantë nga dëgjuesit.

Në një seancë të tij u prezantua vepra letrare e publicistit të mirënjohur në Greqi dhe në atdhe, zotit Abdurahim Ashiku.

Mendoj se seminari në fjalë ishte edhe auditori më i përshtatshëm për paraqitjen e veprës së autorit, pasi një pjesë e konsiderueshme e veprës së tij, i përket shkollës shqiptare në emigracion, vështirësive që ajo ndesh, përmasimit të saj, por edhe nderimit për ata mësues që e ngritën dhe e sollën deri në ditët e sotme. Dhe, me siguri, do ta shpien edhe më tej. Me gjithë vështirësitë reale që ka ndeshur dhe ndesh ajo.

Ishte një thyerje e hijshme, e cila jo vetëm e rifreskoi këtë seminar, por që i njohu gjithashtu edhe pjesëmarrësit e tij me veprën e këtij publicisti të palodhur, i cili vijon të ngrejë fuqishëm shqetësimet që ka emigracioni shqiptar në Greqi dhe sidomos shkolla shqiptare në këtë vend. Me përkushtim dhe përgjegjësi. Me një këndvështrim të qartë, pa lënë ekuivok në paraqitjen e këtyre problemeve.

Do të doja të shtoja se paraqitja e librave të këtij autori të mirënjohur duhej bërë më herët dhe jam i bindur se vepra të tilla duhet të jenë përherë në fokusin e aktiviteteve të tilla. Për paraqitjen e tyre mund dhe duhet të organizohen aktivitete të veçantë, ku të sillen edhe vlerat që ato mbartin.

Ishte vet autori, i cili shpërfaqi para auditorit të seminarit veprën e tij, shqetësimet dhe problemet që ngre ajo ,pjesëmarrjen e tij aktive në problemet e emigracionit dhe më tej edhe në atdheun tonë, ku Dibra e tij e vendlindjes natyrshëm dhemb më shumë.

Tepër konkret në problemet dhe vlerat që trajton në veprat e tij, në motivet që e shtyjnë për të qenë përherë pranë njerëzve që ai i do, ai shpërfaqi para dëgjuesve edhe planet e tij të së ardhmes, për ta vijuar më tej veprën e tij.

Abdurahim Ashiku është një krijues i palodhur, aktiv, i ndjeshëm, kërkues.

Ai paraqiti para seminaristëve dhe pjesëmarrësve të tjerë pesë vepra të tij, të cilat janë pritur me mjaft interes dhe janë lexuar jo vetëm nga emigrantët shqiptarë në Greqi, por edhe në të gjitha trojet shqiptare dhe kudo që jetojnë shqiptarë.



1. Njerëz që i dua.
2. Rilindësit e kohës sonë.
3. Shkolla shqiptare e Athinës.
4. Po Dibrës, jo Skavicës.
5. Rrëfimet e komshiut.

Duartrokitja prej pjesëmarrësve shprehu edhe nderimin për veprën e zotit Ashiku, e cila do të jetë edhe një nxitje për më tej për autorin.

Veprën e publicistit Abdurahim Ashiku e përshkon dashuria për njerëzit. Me mirësinë e tij të njohur, autori i quan personazhet e tij realë: ''Njerëz që i dua''. Ky është motivi bazë i veprës së tij, motiv i cili shpërfaq edhe veçantinë e veprës së këtij autori.

Kësisoj ai i bën të dukshëm këta personazhe për shoqërinë, të cilët janë njerëz të thjeshtë, mësues që sakrifikojnë për mësimin e gjuhës sonë amtare tek fëmijët e shqiptarëve në Greqi, nxënës shkollash, dibranë të traditës që kanë bërë histori, i ngre aty ku meritojnë, duke përshkruar me shumë dashuri dhe nderim cilësitë e tyre, punën dhe përkushtimin, vlerat që i ofrojnë ata shoqërisë.

Pa kursyer as fshikullimin e pamëshirshëm për politikanët e mbrapshtë dhe qesharakë, të cilët ia kanë hipur së mbrapthi kalit të pushtetit, duke e përdorur për interesat e tyre vetjake.

Mesazhet që përshkon në veprën e Abdurahim Ashikut, janë përherë njerëzorë, të ngrohtë, të thënë me shumë dashuri, thjesht, qartë dhe me hijeshi njerëzore.

Duke shtuar edhe nderimin tim për autorin dhe veprën e tij, doja t'i uroja atë që i uruan dhe pjesëmarrësit në seminarin e Patrës:

Vijim të mbarë në veprën e tij të mirënjohur !



NJOFTIM

Në muajin shtator të këtij viti do të botohet libri "Historia e Dibrës", i historianit Kristo Frasheri.

Qytetarët apo biznesmenët që dëshirojnë të japin kontributin e tyre në botimin e këtij libri historik për Dibrën, mund të kontaktojnë në këtë numër telefoni:
+355 69 20 68 603
ose mund të na shkruajnë email
<mbbotime@gmail.com>

Stafi i M&B

Rruga e Arbërit nr. 74
botime

Referencat e preferencat e Xhelil Gjonit aromë jete, koncentrat e monoment vlerash kombetare

Duke lexuar librin "Personalitete në jetën time"

Nga: **FAIK XHANI**

Një shfaqje e tranzicionit është edhe larushia e botimeve. Shumë kush gjatë klësaj periudhe ka zgjidhur thesin e parave dhe ka botuar libra, mandej edhe voluminozë. Disa edhe pse asnjë herë nuk kanë firmosur në "arkivin" e botimeve, qoftë edhe të publicistikës, sot hapen shpatullash, rrahin gjoksin, ngrejn zërin, hakrrohen podiumeve se po rishkruajn historinë e po risjellin në ajrealin shqiptar vlera intelektuale, artistike e kulturore, që i kanë munguar lexuesit.

Edhe atij, që nuk i ka qenë dëgjuar zëri, në këta 20 vjet tranzicion, ka shpërthyer me krijimtari, duke zënë jo pak vënd në mjediset e kioskave të shitjes e tregtimit të shtypit e librit. Shumë prej tyre bëjnë historianin, filozofin, studiuesin, shkrimtarin e artistin me pendën e talentin e të tjerëve, ndërsa talentet e vërteta kanë heshtur, janë strukur, rrakamisen për mbijetesën, krijimet e tyre shpesh i zë pluhuri, për mungesë parash. Krijuesit e vërtetë, ndonëse janë harruar nga shteti, sakrifikojnë shumë nga nevojat jetike dhe botojnë diçka, që ia vlen.

Tranzicioni, një det i trazuar, në vendin tonë edhe në fushën e botimeve , jo rrallë nxjerrë në dritën e botimit bërllangun, antivlera dhe jo vlerat e vërteta të këtij populli e kombi plot vitalitet e vleraplot.

Në këtë "sheshbetejë" krijimi e botimi evidentohen edhe plot autorë fjalëmençur e pendëndritur, që prodhojnë vërtetë art, që vërtetë sjellin në memorien e lexuesit personazhe e problematika madhore. Një nga ata është edhe publicisti, studiuesi, analisti, politikani e krijuesi Xhelil Gjoni. Ai kohët e fundit ka sjell për lexuesin shqiptar librin me titull "Personalitete në jetën time". Është një libër me 265 faqe, ku ndihet aroma e bukur e jetës, komunikimi i ngrohtë e korrekt, dashuria njerëzore, vlerësimi për punën e kontributin e tjetrit, një koncentrat e monument vlerash shqiptare.

Jeta labirint e këtij auori, por gjithmonë me njerëzit e për njerëzit, me intelektualët e për intelektualët, me publicistët, shkrimtarët, artistët, shkencëtarët, kinastët, si drejtues deri në strukurat më të lartë të Partisë së Punës e të regjimit monist, të medies, të fushës së artit, kulturës, por edhe protoganist i aleancave e kompromiseve të duhura, i përjetimit e zgjidhjeve efiçente të problematikave komplekse, shpesh herë të mbushura me rreziqe për fatet e vëndit e të popullit tone, pasqyrohen me vërtetësi dhe rrezatojnë dukshëm në faqet e këtij libri. Ata nuk janë pasqyrim mburrjesh, rrahje gjoksi, delire personale shërbimi e kontribuimi, por janë pasqyrim mjeshtëror i kontribuimit, përkushtimit, përgjithësimit të vlerave më qenësore moderniste e progresiste kombëtare.

Xhelil Gjoni edhe tani, në pension, vjen tek lexuesi ynë me një botim modest, koncentrat vlerash kombëtare, jo me mëllef, jo me baltovinë, jo me diderombe ndaj vetes, partisë e regjimit, që kaloi, por me një analizë të thellë, me një reflektim të duhur, me një përgjithsim polivlerash humane, njerëzore, intelektuale, shkencore, krijuese, kulturore e artistike.

Ky autor vjen në librin "Personalitete në jetën time" si biri i mençur i Dibrës, midis të mençurve të Shqipërisë, si student i mirë midis studentëve shqiptarë, që studiuan

Në faqet e librit ngrihen si malet e larta të vendit tonë kolegë, publicistë, shkrimtarë, artistë, shkenctarë, krijues, piktorë, skulptorë, fotoreporterë, regjizorë , kinastë, pedagogë, njerëz të mençur, prindër të nderuar, kuadro të zot të fushave të ndryshme, anë e mbanë Shqipërisë, përgjithësisht intelektualë e krijues të të gjithë fushave, bashkëkohës dinjitozë, që meritojnë të mbeten si brerore rrezatuese në altarin e vlerave të kombit tonë. Në faqet e librit, si blindat e një godine ngrihen e pasqyrohen cilësi të tilla si: ngrohtësia, reciprociteti, respekti, vlerësimi, mirënjohja, nderimi e besimi i ndërsjelltë, të cilat janë domosdoshmëri e parimësi në se don të njohësh, të evidencoshë , çliroshë e pasuroshë individualitetin e gjithsecilit.

jashtë shtetit, si kontriboues e unitet vlerash kombëtare, si filozof, si politikan i moderuar, si krijues, si protoganist e moderator i uljes së tensioneve, kapërcimit të ngjarjeve e situatave të mbingakuara gjatë dy sistemeve, si i gjëndur gjatë gjithë jetës së tij midis shkrimtarëve, artistëve, kuadrove, të mënçurve, organizatorëve, drejtuesve e praktikcentëve më të mirë të vendit, që i dhanë jo vetëm atij, por gjithë Shqipërisë e shqiptarëve mençuri nga mençuria e tyre, talent nga talenti i tyre, aftësi nga profesionalizmi i tyre, shpirt e djersë nga djersa e tyre dhe gjithçka të mirë e të vyer të tyren, për lartësimin e progresin e atdheut.

Ai njohu dhe e njohën, u kujdes dhe u kujdesën, i ndihmoi dhe e ndihmuan, i vlerësoi dhe e vlerësuan dhe me librin e tij "Personalitete në jetën time" u jep fludimin rrezatues dhe hakën secilit, një hakë mbresëlënëse, një polivlerë kombëtare, që duhet njohur, mbrojtur, përgjithsuar e pasuruar gjithnjë e më shumë.

Në këtë libër Xhelil Gjoni, nga faqja në faqe, vjen me një mesazh shumë kuptimplot dhe shumë të duhur, me duetin referencë dhe preferencë.

Referencë ndaj atyre punimeve, krijimeve, botimeve, intepertimeve, ndaj veprës dhe veprimtarisë të atyre personaliteteve, që kanë lënë gjurmë të pashlyera në obeliskun atdhetar dhe në zhvillimin e progresin e vendit e të kombit tonë.

Preferencë për të gjithë ata, që kanë ditur të zbulojnë, përgjithsojnë e të ngrejnë në art vlerat e Dibres e të gjithë Shqipërisë. Këto referenca e preferenca tregojnë jo vetëm anën njerëzore dhe shpirtin human të këtij autori, por flasin edhe për horizontin e tij të gjërë, aftësitë e tij dhe talentin e tij, që me meritë, ngre në piedestalin e duhur punën e shumë personaliteteve të vendit tonë, që e meritojnë të vlerësohen e përjetësohen më së miri.

Ky libër sjell në memorien kombëtare kushtrimin për më shumë dashuri, për më shumë mirënjohje, për më shumë vlersim, respekt e nderim ndaj vetvetes, ndaj personaliteteve e figurave shqiptare pavarësisht kur jetuan e kontribouan. Është një mesazh brilant, që i duhet gjithmonë Shqipërisë dhe shqiptarëve, veçanërisht në këtë tranzicion të brishtë, ku jo pak hedhin baltë, mohojnë e denigrojnë personalitete e vlera kombëtare.

Xhelil Gjoni edhe në të shkruar nuk ofendon askënd, përkundrazi vlerëson realisht dhe ngrë në art personazhe e protoganistë dinjotozë me kontribute të spikatura, në dobi të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Në faqet e librit ngrihen si malet e larta të vendit tonë kolegë, publicistë, shkrimtarë, artistë, shkenctarë, krijues, piktorë, skulptorë, fotoreporterë, regjizorë , kinastë, pedagogë, njerëz të mençur, prindër të nderuar, kuadro të zot të fushave të ndryshme, anë e mbanë Shqipërisë, përgjithësisht intelektualë e krijues të të gjithë fushave, bashkëkohës dinjitozë, që meritojnë të mbeten si brerore rrezatuese në altarin e vlerave të kombit tonë.


Në faqet e librit, si blindat e një godine ngrihen e pasqyrohen cilësi të tilla si: ngrohtësia, reciprociteti, respekti, vlerësimi, mirënjohja, nderimi e besimi i ndërsjelltë, të cilat janë domosdoshmëri e parimësi në se don të njohësh, të evidencoshë , çliroshë e pasuroshë individualitetin e gjithsecilit.

Që në fillim të librit autori ka lidhur një kontratë me lexuesin: "Në qoftë se fati e koha moniste nuk i pranoi disa të mençur, unë i kërkoj, i nderoj dhe i kam pranë edhe ata. Sepse dituria e shqiptarizmi flasin përmes punës së tyre... (f. 8). Unë përsëri do të shkruaj pa u larguar nga e vërteta... Nuk ka rëndësi se si do më gjykojnë të tjerët, do të thonë po apo jo...?"

Dhe vërtetë realisht, me rrënjë fjale, me themele humanizmi, male mirënjohjeje e respekti dhe me peshore farmaceotike vlerson kolegët, bashkëpunëtorët, njerëzit e personalitetet të cilët ka takuar, komunikuar e vizituar. E rëndësishme është se autori i librit "Personalitete në jetën time" ka zbiruar çdo detajë të jetës e veprimtarisë të personazheve të tij dhe na i sjell ata të gjallë edhe pse disa prej tyre kanë vdekur. Gjithashtu autori fokusohet në veprat më dinjitoze, më të arrira, në krijimet, punimet, intepertimet më brilante e më mbresëlënëse, në kontributet, shërbesat, në përkushtimin, talentin e devocionin e tyre, shpirtin e madh, në përgjegjësinë e lartë, që kanë pas për detyrën, në sakrificat e mëdha që kanë bërë, për t'i shërbyer sa më mirë popullit, kombit e atdheut.

Këtij pasqyrimi gjithpërfshirës, përzgjedhës e përgjithsues i shtohet edhe trajtimi mjeshtëror artistik i një pende të hollë, me bagazhin e plot filozofik e shkencor, që asnjë herë s'i ka munguar e nuk do t'i mungojë Xhelil Gjonit.

Libri "Personalitete në jetën time" i autorit Xhelil Gjoni ngjason me një miniarkiv e minienciklopedi, ku përshfaqet, ruhet, përjetësohet e nderohet "ajka" e kombit, njerëz me dhunti e kontribute të veçanta si: Dhimitër Shuteriqi, Ukshin Hoti, Petro Marko, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Nasho Jorgaqi, Sofokli Lazeri, Jorgo Bllaci, Niko Nikolla, Nasi Lera, Sulejman Mato, Duro Mustafaj, Flutura Açka, Nuri Abdiu, Lutfi Hanku, Ilir Balili, gjënitë e artit figurativ si Piktori i Popullit, Abdyrrhim Buzo, Skulptori i Popullit, Mjeshtri i Madh i Punës Odise Paskali, Kristaq Rama, Sali



Shijaku, Zamir Shehu, Shaban Hadri, Mentor Shehu, kompozitori Nikolla Zaraqi, klasikët e muzikës Çesk Zadeja e Tish Daia, prof. Zhani Ciko, Rifat Teqja, Artistet e merituara, aktorë e regjizorë si: Drita Agolli, Xhenafize Keko apo drejtori kompetent i Kinostudios Viktor Gjika, armata e enrgjitikës me Prof. Petrit Radofickën, Edi Pinguli, Egon Gjadri, Ismail Ahmeti, Bestar Doke, Hektor Çaçi, Nasi Lubonja, Fareudin Hoxha, Emin Mysliu, Besnik Bekteshi, gazetarët e shquar të cilët i vesh me petkun artistik sipas aftësive profesionale e cilësive të karakterit të tyre, si kolonelë, majorë, gjeneralë, rebelë, modernë, lirikë, reformatorë etj. si Dashnor Mamaqi, Todi Lubonja, Xhako Dango, Spiro Dede, Pavllo Gjidede, Irfan Bregu, Thimi Nika, Arshin Xhezo, Fatmir Kumbaro, Vladimir Prela, Mitro Çela, Ibrahim Baçi, Astrit Nuri, korrespondentët me zë të veçantë në rrethe si Milto Ferro, Kola Stavri, Jorgji Papa, Spiro Kufo, Isuf Meta, Shaban Hadri apo mjeshtërit e fotogarfisë Niko Xhufko e Pandi Cici etj.

Jeta e aktiviteti i redaksisë së gazetës "Zëri i Popullit" vjen e gjallë, e larmishme, e ngarkuar me aktivitet, problematikë, përgjegjësi po edhe si një çerdhe harmonie, dashurie, vlerësimi e mirënjohjeje njerëzore, për kolegët e punës, ku krahas peripecive të punës e detyrës jepen edhe intimitete e veti njerëzore, të çmuara e rrezatuese.

I tërë libri është i mbushur me njerëz, me kontribute të veçanta, të cillët Xhelil Gjoni ka ditur ti zbulojë, t'i përzgjedh, t'i vlerësojë dhe t'i përjetësojë. Ata janë personalitete, që ia ndrisin nurin, bukurinë dhe hijeshin Shqipërisë dhe u japin brezave e gjeneratave të reja trasenë e duhur të atdhetarizmës, të ndjenjës së lartë ndaj punës e detyrës dhe mozaikun e krijimtarisë nga ku duhet, të korsojnë e të frymëzohen gjatë gjithë jetës.

Personazhet e këtij libri sjellin aromën e vërtetë të jetës, mbartin koncentratin e vlerave kombëtare, me të cilët duhet të krenohemi dhe të kërkojmë t'ju ngjajmë. Ata janë monomente vlerash kombëtare nga të cilat duhet të marrim shembull e të frymëzohemi në punë e në jetë.

I gjithë libri shpalos mençurinë, traditën, talentin, mjeshtërinë e gjenilitetin e këtyre personaliteteve.

Xheli Gjoni është protoganist i jetës shqiptare për gati 8 dekada ashtu si edhe disa të tjerë, prandaj duhet të eksplorohen e shfrytëzohen jo për veten e tyre, por më shumë, për të mësuar e për të nxjerrë vlera të vyera reale, e mbi të gjitha të vërteta, që i bëjnë mirë Shqipërisë dhe shqiptarëve.

arsim

"100 vjet shkollë shqype n'malci" me sytë e një gjimnazisti



Nga: **ZAMIRA GJELESHI***

Dibra është shumë afër, por edhe larg.

Ky është filli që lidh historinë e arsimit dibran nga Gjimnazi i Maqellarës në dokumentarin: "100 vjet shkollë shqype n'malci"

Nuk kisha asnjë mëdyshje se temën e preferuar mund ta tregoja me sytë e gjimnazistit të Maqellarës që është pamja më e mirë e arsimit dibran.

Prekim dy kulme: arsimi pas vitit 1912, para periudhës së Rilindjes dhe sot në 100 Vjetorin e Pavarësisë.

Emri i dokumentarit është shumë domethënës.

E di që Dibra është moderne, por ato pak pjesë të mbetura arkaike të saj i përdora për të shfaqur idenë time. Dokumentari u shfaq si aktivitet i fundvitit që është traditë e gjimnazit dhe tepër i suksesshëm. Dua të them se njerëzit dinë shumë pak rreth arsimit dibran. Ai vazhdon të jetë i panjohur. Kaq afër, por edhe kaq larg.

Kjo përbënte interes për mua kur fillova të punoj për historinë e arsimit dibran. Udhëtuam shumë, studiova thellë historinë, kulturën dhe kuptova lidhjen time personale, ku mësimdhënien e shoh si mision. E di mirë se Dibra tenton të bëhet moderne, por të them të drejtën ka ende hapësira që janë vërtet shumë arkaike, ku tradita dhe dëshira për arsimim janë shumë të rëndësishme. Arsyeja e parë ishte që arsimin dibran ta tregoja me sytë e gjimnazistit që merr përsipër përgjegjësinë e fjalës dhe të përshkruajë kontrastin e madh mes dy periudhave.

Kjo ishte arsyeja pse vendosëm për imazhin arkaik të Dibrës.

E dija shumë mirë se është një Dibër krejt tjetër. Ishte shumë e vështirë të mbanim mbi supe një barrë të tillë, kujtoj udhëtimet, intervistat e shumta, përvoja prej vitesh në arsim, ka një vit që po merrem me këtë temë, aq më tepër një mësuese fizike përpiqesha të bëj një dokumentar për arsimin.

Historia tregohet me sytë e misionarit të gjimnazit.

A është e mjaftueshme?

Besoj se janë të rinjtë ata që duhet të mbajnë flakadanin në misionin tonë të shenjtë. Institucionet dhe shoqëria duhet të kenë kujdes në ruajtjen e dokumenteve mbi arsimin.

"…me saktësi të plotë nuk i dimë të gjitha të fshehtat dhe misteret e Kullës, as fanitjen e shpirtrave apo të gjarprit, as për Markajt e Demën, as për Cenin dhe Sulën, për fanitjen e Vajzës gjysmë zanë e gjysmë imazh..."

"**.. ju lutem zotëri, nëse keni Abetare nga ata që na keni dërguar më parë, të na dërgoni sa më shumë, sepse bashkëfshatarët kërkojnë pa pushim prej atyre Abetareve që kanë mësuar të lexojnë dhe të shkruajnë. …**"

"…nxënësit i ndiqnin mësimet në kushte shumë të vështira, por etja për të mësuar gjuhën shqipe, për dije dhe kulturë ishte e madhe…"

.....

"Emri yt vallë si quhet.
Se na duhet për Shqipni.
Se ky emër nuk harrohet.
Do ta shkruajmë në histori.

Historia do ta përdorë!
Emrin tand me lavdëri.

E di që Dibra është moderne, por ato pak pjesë të mbetura arkaike të saj i përdora për të shfaqur idenë time. Dokumentari u shfaq si aktivitet i fundvitit që është traditë e gjimnazit dhe tepër i suksesshëm. Dua të them se njerëzit dinë shumë pak rreth arsimit dibran. Ai vazhdon të jetë i panjohur. Kaq afër, por edhe kaq larg.

Fillikat vetëm një malësor.
Bani luftë me një ushtri!"

Nuk ka asnjë dërrasë të zezë në qiell ku shkruhet:

"Jashar Bllaca, një ushtarak strategjik që ka jetuar në gjysmën e parë të shekullit XX,…"

Eshtrat e tij prehen poshtë lisit, që deshifron kodin e lashtë me nipat dhe mbesat:

"…poshtë dheut ai lis , ënjtur lotët rrokullis ,

Derdha lot farmak , mbi lule , zambak …
.....
Bota, që keni lënë: hon e kanion
Eshkë kundërmon,Gjysh, o strall mungon…
.....
Ju dhe ne, ne dhe Ju, përgjithmonë bashkë!"

Përsa i përket ekipit kishim një përvojë të bukur të "Sekretit", ata janë të gjithë brilantë. Esmeralda B, Lorenc L, Besim C, Ardit M, Manuela L, Albion Xh, si dhe Foto Ardit e Video Arbi që injektojnë teknologjinë dixhitale.

Në pjesën e dytë duket sikur ne ndaluam pasi në rrugëtimin tonë nuk dinim drejtimin që do të zgjidhnim. Na u dha shenja e kalimit për ekipin tim ra prej qiellit, për mua ishte Universi që interferoi frekuencat e idealit, mendimeve dhe ideve të mia me z. Muis Llani, kryetar i Komunës Shupenzë.

Muis "dibrani" ka krijuar stereotipin e dibranit të ri, ndoshta emri i tij vjen nga legjenda "Mojso Shupenza". Nëse fati do të fryjë në favor të tij, mbase Dibra do të ketë karakterin e saj mashkullor në Shqipëri dhe në botë.

Në 100 Vjetorin e Pavarësisë besoj se misionin tonë të shenjtë e kemi kryer me nder dhe përgjegjësi të plotë.

"Vramëni, por mblidhmani gjakun se do t'iu duhet nipërve për të shkruar gjuhën shqipe!"

Urimet më të mira në arritjen e qëllimeve fisnike! Sprova të reja na presin…

***

I gjithë ky udhëtim përmblidhet : "Në kërkim të një miku!"

Muis Llani, njeriu me përmasa të veçanta, që e ka vënë jetën e tij në shërbim të komunitetit.

Muisi është më i dashuri i njerëzve, drejtuesi që ka lënë gjurmë në Komunën e Shupenzës, është më bujari, më i përkryeri, më i vyeri,…

Ata që e votuan e pritën me padurim, që ai të zbriste në skenën e sprovës, ndërsa tani vazhdojnë të mos heshtin së vlerësuari.

Të rinjtë e ndjekin me besnikëri dhe u lidhën fort me kauzën e tij: "Në këtë fytyrë nuk ka gënjeshtër!"

Për herë të parë tronditi fort mentalitetin e zonës duke hapur rrugë, që padituria të merr fund njëherë e përgjithmonë.

Ai u trajtua si njeriu që këputi vargonjtë e diktaturës, për më tepër është model qëndrese, sakrifice e besnikërie.

Motoja e tij: "E drejta është e drejtë dhe e gabuara, e gabuar!"

Ky dokumentar është dëshmues i idealit, vizionit dhe vlerave të tij.

Puna e tij është model i mishërimit të virtyteve më të larta. Zgjidhja me lehtësi e çdo problemi e bëjnë misionin dhe kauzën e tij gjithpërfshirëse dhe universale.

Humanizmi i tij është pjesë e Nënë Terezës:

" O Zot!
Lutem në përshpirtje,
Vëllezërve të mi nga fati prangosur,
Falu urtësinë, që rishtas të kthehen.
Të munduarit endurnëpër shekuj!
.....
As shpërfilljet e fatit mizor , as ndëshkimet,
Besimin në Ty, Zot s'ma shembën!"

Në shumë marrëveshje ai të mbështet vetëm të të mundësoj suksesin.

Gjithkush që e sheh për herë të parë, mahnitet nga mesazhet, që transmeton si shërbëtor i komunitetit të tij.

"…ndihem krenar që Gjimnazi i Maqellarës ka vlera, mësues të denjë dhe nxënësit që studiojnë këtu do të kenë të ardhme dhe do ta ndriçojnë Maqellarën…"

Ai braktisi komoditetin dhe luksin për të ndriçuar si një yll komunitetin e tij me dije, edukatë dhe mirësi. Emri i tij i ka kapërcyer kufijtë e Dibrës dhe përmendet me dashuri e respekt.

Ai po pushton mendjet, arsyet, zemrat dhe shpirtin e komunitetit të tij dhe atij , që ka fatin ta takojë dhe të dëgjojë për të.

Zëri i tij është kumbues, i ashpër, i mprehtë, tipik shqiptar për nga toni, melodia, shqiptimi, shpërthimi tronditës,...

Muisi është modeli i njeriut të përsosur. Nëse e vështrojmë nga dritarja e kohës, që jetojmë do të vëmë re se mënyra se si i zgjidh problemet më të pazgjidhshme, fjalët, jeta, vlerat, virtytet dhe cilësitë e tij janë modeli i njeriut, që sot shoqëria jonë ka më tepër nevojë se kurrë….

Shpresojmë ta shohim në tribuna botërore me flamurin shqiptar në zemër i duartrokitur nga mijëra spektatorë...

Portreti i tij u gdhend përkrah Jashar Zenelit në fluturimin e shqipes, ciklonet e stepave nuk mund t'i brejnë…. Dibra ka djalë legjendash!

Vetëm një titan me ideale të larta mund të ngjitet në piedestalin njerëzor!

* *Gjimnazi Maqellarë, Peshkopi*

Poezi nga Nexhi Baushi

NË DY ...

Jam ajo që kurrë s'do mundesh pa mua
Se, bota
Në dy u ngjiz, e
Në dy nis një fillim të ri
Në dy ndizet zjarri
Që brënda vetes ke

Jam shtizë fort e ngulur
Në kraterin diellor, e
Sfidueshëm endem
Qiejve të qelqta
Se, dhëmbja në dy u mboll
Në kopshtin e durimit
Në dy.
Arnohet e keqja
Largohet dhëmbja
Ndalet vetmia
Mbulohet brenga
Jam frymëlla brënda teje
Që zgjoj ëndrrat, e
pafajësisë së virgjër
Se shpresa
Në dy u mboll, e
Në dy shpërthen gëzimi
Se në dy
Përballohet sfida, e
në dy,
Jetës i vihet
Kurorë pavdekësie

VETËTIMË NË NJË PREKJE

Për miken nga kalaja e nemitur
Në qoshe nuk më ka ngujuar njeri
Jo! Jo!
E kam ngujuar vetë veten
Flaka e dashurisë më ka ngujuar
Që po ditka të ndez!
Po ditka të të robërojë!
Po ditka të të bëjë vuajtjetar!

Për miken buzë Kalasë
Në qoshe nuk më ka ngujuar njeri
Jo! Jo!
Dhe as më të voglën përpjekje bëj
Nga ajo dashuri të shqitem
E shumë dëshira kam
Aty fuqia të më lërë, e
Të shuhem prej saj
Vetëm të mos jetoj pa të.

Për ty mike kjo dashuri
Një fjalë ish nga një libër i tërë
Një vështrim ish nga shtatë palë qiej
Një klithmë ish në një ofshamë
Një bulëz loti, nga një oqean
Ish vetëtima në një prekje
Njëmijë vjet ishte brenda një çasti.
Më vrau buzëqeshjen mikja ime
Nga qyteti i gurtë buzë kalasë
Atë buzëqeshje që në shpirt
Si zambak më kish mbirë.
Buzëqesha ... edhe kur më lëndoi
Trishtimin e nxora siç e dija vetë.

SE MË DESHI...

Ndërsa qeshja,
duke lexuar Eseninin:
Dashuria është një gjest,
një e thënë
nuk flet me fjalë ...
Tani ... s'mendoj ... flas ...
klithmoj ... përgjëroj
Këngën time të ma dëgjojë, e
Flas ... flas ...
për krenarinë e gabuar



Ndjesë kërkoj,
për heshtjen time të harruar
që fjalën e dashurisë e vrau
Se më deshi
Si t'isha agimi i parë i mëngjesit.
Si shi i lehtë që mbi supe pushon, e
Në tërë qenien vetëm për mua.
Se më deshi,
Siç duhet dashuria e parë.

PREHËRI I DHEMBJES

(Kushtuar nënave)

Përse druhem, e
dora dridhet ...?
Përse mendja mpihet,
kur nis e shkruaj për të ...?
*
Të lidhur kam gjuhën
kur sjell ndër mend, si
Fati, bota – shpesh përbuzshëm,
trupin e brishtë, plaçkë tregu ja kthyen.
Keqas poshtërisht mirëbesimin
të pabesët, pabesisht ia shkelën, e
lashtësisht mëkatit
emrin e sajë i vunë!!!
*
Zemrës kataraktit, do t'i shkul,
llavën përvlonjëse, e
me penën e shpirtit, vargun kostelacion,
galaktikës, për të do t'i shkruaj:
Për syt e sajë të tharë pa lot,
si plis i përmbysur anës vijes zhuritur
vështrimin kur hedh krijesës së pafajshme,
muzgjeve, mëngjeseve
uritur thithte nga gjiri
frikën për jetën
trishtimin, ëndrrën, e
rishtaz, sytë e tharë, pa lot,
të gënjyer, të mashtruar të humbur,
qiellin vështronin
pikën e vtme të kristaltë,
jetën për të vazhduar ...
*
O, klithmë nanuritëse varur në lidhëza yjesh
Ti gjysëm e botës përthyer në dysh
Me pasion plazmik prej gruaje
Ekzistencë qelizove
Me dhimbshuri prej nëne ardhmërinë mëkove
Atje ku mbretëronte vdekja
Misterin zbulove, e
Jetën sfidove!
*
Mirënjohje për të!
O prehër i dhembjes ku kokën ndër shekuj
njerëzimi mbështet!

NOKTURNO

Përtej hënës, yjeve, përtej planeteve
Një botë shpaloset drejt meje pa cak
Një botë përtej times imagjinatë
Mbushur me plotë shpresë e afsh.

Fabula nga Mevlud Buci

Këshilla e bilbilit

Një trumcak e një lejlek
Na u takuan tek nje shtek,
Trumcaku mburrej me fjalët
Lejleku lavdëronte shalët
Tha trumcaku or lejlek
Shalët e tua duan brekë
Tha lejleku i skuqur flakë
nuk ke mend ore trumcak(!)
mbiu një pemë atje tek ara
dëgjoi bilbili plot të shara
me urtësi i doli urata
s'ecet me të shara e vetë lëvdata

Vjetulla

Futej fshehtas si tinzare,
mu në mesin e një are
hante e merrte nën sqetull
në mesnatë e gjora vjetull

Në agim të një mëngjesi
në mes arës e zuri stresi
nevrikosur dhe e tronditur
na u kap duke grabitur.

Kur i doli sheshit skandali
qeshi bufi edhe çakalli,
tha një plak: kush bën sqetulla (!)
kapet mat siç u kap vjetulla.

Stil

E kish bërë zakon çapa
kem-kem-kem turrej nga mbrapa,
po kështu bënte dhe zagari
poshtë e lart gjetkë nga pazari
sapo i pa foli një plak mentar
lehjet tha t'bëjnë çapë e zagar
lehjet kot të bëjnë pa vlerë
të çojnë drejt e në humnerë
Një i urtë me plot talent
lehje shohim tha në parlament
asnjëherë nuk u pushon llapa
koha i quan zagar e çapa.

Iriqi dhe palloi

Nëpër natën e zezë sterrë
ecte iriqi nën një ferrë
me samarin plot gjemba
qeshi iriqi e foli menjëherë
të përqesh një i pa vlerë
-o pendë bukur, o sharlatan
veç i shari tjetrin shan

Keci

Një cjap brirë përdredhur,
e pa kecin duke bredhur,
mos u hidh i tha, mos u shmang kot
Ec me tufën e kullot...



Jo, tha keci, baba cjap
e di vetë ku eci në shpat....
i përkëdhelë nga mëma dhia
i pëlqente kecit vetmia.
Sa e pa ujkun rrëzë shaptit
iu kujtuan fjalët e cjapit
thonë se keq e pësoi mistreci
siç e pësoi prej ujkut keci.

Fati i ariut

Kur po ngjitej në thepajë,
përmbi mal doli hëna
një arushë me këlyshët e sajë
gjueti bënte me thana.

Për çudi tek lisi në anë,
ku kish llucë edhe baltë,
miza bletë, sytë i panë
vate ariu m'u në mjaltë.

Fundi i dhelprës

Tek po dilte nga qylari
zogëzat prerë e copëtuar
tha po më vete për së mbari
vraponte e gëzuar.
Thonë se e bëri udhë e ngrata
gati i mbaroi zogëzat e qylarit
Ndodhi e treta e vërteta
u bë gëzof i gjuetarit.

Pësimi i cjepëve


Një ditë qëmoti gjetkë në kullotë,
i printe bariu tufës në male.
Sapo nisi të bjerë dëborë e shqotë
pranë iu afruan veç delet manare.

Nuk e begenisën bariun fare,
cjeptë kryeneça që ikën në arrati
nga bishat shpëtuan veç delet manare
e pësuan cjeptë që ikën pa bari.

cyan magenta yellow black

kulturë

Libri i ri





63 vjet Asambli i Zall Dardhës

Me 29 qershor 2912, Ansambli i Zall Dardhës mbushi 63 vjet. Me këtë rast, shoqata kulturore-artistike "Valët e Drinit", në bashkëpunim me QKMBM, në sallën e Qendrës Kulturore të Ushtrisë, zhvilluan një veprimtari kulturore – artistike.

Fjalën e hapjes e mbajti koordinatori Gëzim Bara, ndërsa u paraqitën me kumtesa z. Xhelil Ymeri, prof. Dr. Vasil S. Tole. Më pas u shfaq një dokumentar për Zall Dardhën dhe ansamblin në vite, si dhe një koncert me këngëtarët e ftuar nga Zall Dardha si Lirie Rasha, Qerim Sula, Caje Poleshi, Shaban Meziu e Sherif Dervishi.

Në sallën e mbushur plot me dernjanë dhe nga e gjithë Shqipëria kishte muzikantë, shkrimtarë e gazetarë. Në fund të programit u ndanë certifikata mirënjohjeje për udhëheqësin e parë të grupit të Zalldardhës z. Qazim Selimi.

Certifikatë mirënjohjeje ju dha edhe grupit të valleve të të rinjve, që e mori koreografi i valles "Kuvendi" dhe valltari i kësaj valleje Hysen Ndreu.

Po kështu u nderua edhe kolonel Beshir Cala dhe ushtaraku në detyrë Shefqet Shira.

Risi në këtë aktivitet ishte hapja e një ekspozite fotografish me pamje nga aktiviteti i ansamblit në vite, botimi i Gazetës "Ansambli i Dardhës", numër special me botues po dernjanët, Mina Hysa, Gëzim Bara dhe Ilmi Dervishi.

Me emocione u prit kënga kushtuar muzikantit nga Zall Dardha Muharrem Xhediku, themeluesi i tangos shqiptare, me muzikë nga Qemal Toluli, tekst të Ilmi Dervishit dhe kënduar nga pjesëmarrësi i këtij ansambli, këngëtar Kujtim Çerpja.


(Korresp. "RR.A.")



Rruga e Arbërit nr. 74
kujtesë

Një dëshmi tronditëse nga masakra e Tivarit

Masakra e Tivarit ka hyrë në histori si një nga tronditjet më të mëdha në historinë e kombit tonë. Shumë përfliet, shumëpyetje e pikëpyetje ngrihen: si kush ndihmoi (se organizimi dihet), pse, si, sa etj. Një nga ata që e dinte, por heshti, ishte Latif Jata (Vilë - Lumë),. Këtë dëshmi e ka treguar në vitin 1962 që e kishte marrë prej Zeqir Radushës,dy tri vjet më vonë ngjarjes.



KUSH ISHTE LATIF JATA?



Latif Jata lindi më 1883, njohës i disa gjuhëve të huaja. Në vitin 1915 ka qenë përkthyes në Vjenë në një delegacion me krerët e Shqipërisë së Veriut, përkthyes i gjermanishtes i Elez Isufit në këtë delegacion. Mik i familjes së nderuar të Ndreve të Dibrës. Ka shërbyer në detyra ushtarake në kohën e Zogut. Ka qenë tri vjet në përbërje të Çetës së Pezës dhe pas Luftës së Dytë Botërore ka kryer detyra të rëndësishme, si n/prefekt e drejtor në ndërmarrje bujqësore etj.

Pas dënimit me pushkatim të të vëllait, Dinit, në vitin 1952 lirohet nga të gjitha detyrat. Vdes në fshatin Bushtricë në vitin 1979, i nderuar nga bashkëfshatarët, por jo nga pushtetarët.

RRËFIMI

Në vitet 1945 deri në fillimin e viteve 1950-të, isha me detyra të ndryshme në Lumë-Kukës. Punët në atë fillim ishin mirë me Jugosllavinë dhe kjo "e mirë" ra mbi shqiptarët, veçanërisht për rrethet e afërta këndej e matanë kufirit, sidomos deri në vitin 1948, kur u prishën lidhjet me Titon. Kishte hyrje-dalje të kufizueme në Kosovë, që gjithsesi ndihmonin ekonominë e njëri-tjetrit, por lidhja mes dy vendeve pati dhe pasoja. Një nga ngjarjet më tronditëse asht vrasja e mijëra djemve kosovarë, që i prunë prej Kosove nëpër Kukës e i çuen në Tivar, që siç e morëm vesh më vonë i zhdukën.

Kur kaluen nëpër Kukës, i kam pa me sy të mi. Ishin të gjithë nga mosha 18-35 vjeç, që i mblodhën me forcë nëpër viset e Kosovës e në mënyrë të organizueme, i kaluen nga Morini në Kullë të Lumës, në kambë për Qafë Mali e Pukë, nga Shkodra e në Tivar. Ne nuk e dinim mirë se përse shkonin këta djem ashtu të lidhun për rruge, por nji zë i fshehtë qarkulloi në Lumë. "I ka përzanë Tito prej Kosove" dhe kaq. Më vonë morëm vesh se çfarë hataje ishte ba me ta.

Ngjarjen ma ka tregue Zeqir Radusha a Dobrusha, nga nji fshat mes Prizrenit e Reçakut, në një bisedë pas tri vitesh në një takim në fshatin Bardhoc-Kukës . Vetë Zeqiri në moshën 23 vjeçe ka qenë në rresht me këta djem, që thoshte se kemi qenë afër 7 mijë vetë. Kur na tregoi për ketë ngjarje, isha me gjithë Hasan Fasli Çejkun dhe Hasani fliste e ne na dridhej gjithë trupi. Ai vetëm pak lot nxori në sy. Ja si na e tregoi ngjarjen:

DËSHMIA E ZEQIR RADUSHËS

"Para disa ditëve kisha zanë nuse (isha fejue) në Rugovë. Miku ishte i fismë dhe aty kishte qenë fati me ba mik. Nji natë nëpër shpitë tona dolën e na mblodhën gjithë djemtë e rinj në Rahovec. Se pse nuk e di as sot, që po flas me ju. U bëmë grumbuj grumbuj e na rrethuen me njerëz me armë, që thojshin se janë partizanë. Na nisën nga Rahoveci, në Prizren, në Kukës e në Mal të Zi. Gjatë rrugës ndonji që bëri tentativë të ikte, e vranë. I vritnin e i linin ashtu rrugës pa mbulue. Kur shkuem në Tivar, na hipnin në makina lufte të vjetra dhe shtynin makinën e me gjithë makinë na lëshonin në humnerë. Ai që mbetej gjallë, që lëvizte sadopak, skuadra e pushkatimit rrinte gati e i lëshonte nji plumb në krye.

Kështu ndodhi edhe me mue. Na hipën 20 vetëve në makinë me duer të lidhuna dhe na lëshuen në nji vend që s'dilej prej andej edhe i shëndoshë të ishe. Shkëmb rreth 50 metra poshtë që s'kishte dalje, veç të ngjiteshe me litar. Unë rashë mbi trupa të vdekun që i kishin lëshue para nesh, pa u gërvishtë askund.

Thashë: D"esh Zoti, shpëtova!" Por kisha pa se sa të ngriheshe në këmbë, merrje plumbin në krye, prandaj nuk lëviza fare nga vendi e u bëra si i vdekun.

Mbi kokë kishim ata që na vëzhgonin. Sipër meje erdhën dhe trupa të tjerë pa jetë e të përgjakun, që sa lëviznin i qëllonin. Unë nuk dhashë asnji shenji jete. Kisha frikë se do të më zane ndonji makinë që e lëshonin poshtë, por dha Zoti e nuk më kapi asnji. Mbi trupin tim vinte gjaku si lum; ishte gjaku i të tjerëve!

Mendova: Ma mirë me vdekë këtu nën peshën e shokëve të mi të vramë, se sa të më vrasin të pafetë. Por nuk i kishin hedhë të gjithë atë ditë. Nji pjesë e lanë për nesër, pasi nuk i vritnin natën, por ditën në atë vend të fshehtë, që nuk binte dielli e jo më të kalonte njeriu. Prisnin mëngjesin prej frikës se ndoshta shpëton ndonji e nuk e shihnin natën.

U err dhe unë mbeta i vetmi i gjallë në atë turrë trupash të djemve të rinj.

Kisha peshë të madhe mbi vete; kisha shumë shokë të mi që qëndronin mbi mue. Kur u ftohën, shtuen peshën. Por unë mora forcë e nisa të dal. S'lëvizte asgja.

Trupi im u ngri nga gjaku i shokëve, që më kishte lagë rrobat e trupit. Kur nisa me lëvizë, filloi me copa-copa gjaku i ngrimë. Sikur u lehtova pak dhe duke u zvarritë, se nuk besoja se s'kishte njeri që më shihte, dola në nji shkurre. Kalova shkurren e trupa të tjerë të vdekun grumbuj-grumbuj, si i kishte lanë makina e vjetër. Eca mbi to ngadalë se s'kisha kah të kaloja. S'dëgjova asnji zë dhe hyna në nji pyll dhe e pashë veten të shpëtuem.

Ku të shkoja, nga t'ecja? Po të më zinin, prapë aty do përfundoja! Në mes të nji pylli qëndrova dy ditë. Aty ishte dhe nji burim uji e lava rrobat natën. Kur dëgjoja zhurmë, stukesha në nji shkurre. Edhe natën e dytë i lava më mirë rrobat se ashtu siç qeshë, trishtoja gur e dru.

Natën e tretë u ngjita nalt pa e ditë se ku shkoj. Kisha marrë rrugën që të çon në Hot e Grudë dhe, duke ecë vetëm natën, kalova disa bjeshkë, me synimin për të shkuue në Rugovë te miku që kishëm zanë nusen. Por nuk dija të shkoja në shpinë e tij se s'kisha shkue asnjiherë në atë rrugë. Prandaj nji natë iu drejtova nji shpie për të kalue natën si njeri. I zoti i shpisë më priti mirë dhe më garantoi se këtu s'ka as malazez, as as serb, as forca shqiptare.

Rri si në shpinë tande! më tha. Më mbajti në shpi gati tri javë derisa e mora pak veten. Mbas tri javësh, më dha rrobat e çobanit të vet dhe më tha që të shkoja duke pyetëpër ketë rrugë, sikur më kishin humbë dy cjep. Ashtu shkova duke kalue bjeshkë mbas bjeshke e rashë në shpinë e mikut tim.

***

Aty rashë në nji siklet tjetër. Shpia e mikut tim kishte darsëm. Nuk e dija se kë martonte, por për mue ishte nji e papritun. Nji javë para se të më zinin mue, kishim caktue ditën e darsmës tonë. Pra, mbas nji jave do të martohesha.

Fjala kishte shkue se unë isha vra dhe në shpi më kishin ba dhe mortën. Para do ditësh në ketë shpi kishte ardhë baba em dhe i kishte thanë se djali im asht vra e ti jepe çikën (ashtu i thonë ata vajzë) diku tjetër. Ishin nda me lot në sy dy miqtë për ketë që kishte ndodhë.

Babai i vajzës e kishte dhanë (e kishte fejue) me dikë tjetër. Kishin pritë derisa të bëhej e katërdhjeta e vdekjes time, siç e do zakoni dhe të bëhej darsma.

Nata e katërdhjetës teme më takoi që të jem në shpinë e mikut, te nusja ime!

Krushqit kishin hy brenda dhe po bahej gati nusja. Nusen time do ta merrte dikush tjetër!

Mue askush nuk më njohu. Isha dobësue e zvogëlue. Jo vetëm kaq, por edhe se vetëm nji herë më kishin pa e, për më tepër, "kishëm vdekë". Hyni nana e nuses mbrenda dhe më pa me habi. M'u drejtue: Prej toke ke dalë, or bir!?

Bisedova si veç me nanën e nuses, i tregova se kush isha, si më ka ndodhë dhe ajo më tha: "Mos i thuej askujt se cili je! Siç e sheh vajzën kanë ardhë me e marrë krushqit që janë mbrenda. Po ti mos fol se nuk e di si e kanë mendjen këta miq. Që të mos ndodhë shamatë, sidomos ndonji e keqe për ty, do bëjsh si të them unë. Janë 100 darsmorë, që e kanë të vështirë me u kthye pa nuse. Po ti merr nusen e ik për te shpia jote, se tani për tani nuk kemi me u tregue këtyne krushqve".

Kështu veprova. Mora nusen e për gjithë natën mbërrijta në shpinë time. U çuditën babë e nanë e gjithë faefisi. Kur panë nusen, që ishte që ishte ajo që më kishin zanë baba e nana, u habitën ma shumë. U tregova për ngjarjen prej fillimit e deri në fund dhe tani ishte problemi i krushqve të tjerë, të atyne që i lashë në shpinë e mikut.

Filluen me u ba gati në dy variante: Ose me qenë të gatshëm me u përballë me pushkë, ose me gjetë mënyrën me pajtim.

***

Në shpinë e nuses erdhi koha që të krushqit të merrnin nusen dhe të dilnin. I pari i krushqve, sipas zakonit, i thotë të zotit të shpisë: "Me na dhanë leje, se kemi do rrugë me ba!"

I zoti i shpisë, në atë siklet që ishte, i thotë se si ndodhi. Pra ata nuse nuk kishin. Krushqit mbetën si të shtangun, por i pari i tyre thotë: "Mue më ka caktue të parë i zoti i darsmës për me marrë nuse, por s'paska qenë kismet!

Shyqyr që ka ardhë gjallë fati i parë dhe ka marrë nusen e vet! Na jep leje, o i zoti i shpisë! Po u thom nji fjalë ty edhe shokëve të mi. Kështu siç jemi, pas meje, do të shkojmë e ta urojmë mikun e ri. Nuk ka ma mirë, kur njeriu shpëton shëndosh!"

U nisën të gjithë së bashku e erdhën te shpija ime. Thirrën babën e i thanë se kemi ardhë si miq e do të vijmë mbrenda si miq, për shyqyr që të ka shpëtue djali e shyqyr që e martove. Hynë mbrenda, pinë kafe dhe bënë muhabet nja dy orë. Morën leje, duke thënë se: Na presin te darsma tjetër, edhe pse jemi pa nuse!

Baba u thotë: Ju paçi faqen e bardhë! Do të prisni nja dhjetë minuta, derisa të bahemi gati me u përcjellë!

Kur dalin në oborr, shohin kalin e bardhë me nji nuse, të përgatitun sipas zakonit. Babai i djalit kishte ba gati nji vajzë dhe e kishte hypë në kalë nuse për krushqit e rinj. Morën nusen dhe e dërguen në shpinë e vet....".

Pregatiti: **Fejzulla Gjabri**

Kur kaluen nëpër Kukës, i kam pa me sy të mi. Ishin të gjithë nga mosha 18-35 vjeç, që i mblodhën me forcë nëpër viset e Kosovës e në mënyrë të organizueme, i kaluen nga Morini në Kullë të Lumës, në kambë për Qafë Mali e Pukë, nga Shkodra e në Tivar. Ne nuk e dinim mirë se përse shkonin këta djem ashtu të lidhun për rruge, por nji zë i fshehtë qarkulloi në Lumë. "I ka përzanë Tito prej Kosove"

histori

Kontributi i Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit është i pamohueshëm



Foto marrë nga <ekonomia-ks.com>

Nga: **Rexhep TORTE**

Më 10 qershor të këtij në Prizren dhe në viset tjera shqiptare në mënyrë madhështore e solemne u shënua 134 Vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që përkon edhe me vitin jubilar të 100 Vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Këto data na bëjnë të jemi krenarë dhe janë dëshmi e fuqishme e përpjekjeve të paraardhësve tanë për të patur shtetin dhe lirinë tonë kombëtare.

Ajo që na ra në sy dhe na habiti në shënimin e 134 Vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit por edhe në përvjetorët e mëparshëm, është fakti janë mbajtur edhe simpoziume, por pa praninë e historianëve nga zona e Dibrës, ku janë dorëzuar edhe mirënjohje për kontributin e qyteteve në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke anashkaluar Dibrës, edhe pse Dibra ka dhënë konributin e saj në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe se Iljaz Pashë Qoku – Dibra ka qenë edhe kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Lidhjet e Dibrës me Kosovën janë shekullore. Për këtë flasin lidhjet tradicionale, dokumentet dhe ngjarjet e shumta historike.

Iljaz Pashë Qoku – Dibra më 10 qershor 1878 u zgjodh kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Patrioti dhe iluministi dibran Said Najdeni, përveç me Ismail Qemalin e vëllezërit Frashëri bashkëpunoi ngushtë edhe me Hafiz Ibrahim Mitrovicën, Haxhi Zekën dhe shumë patriotë kosovarë . Në fjalimet e tij asokohe në Kosovë, Said Najdeni, thoshte, " Shqipnia s'ka miq fare dhe që të shpëtojë nga rreziku, një rrugë i ka mbetur. Me u zgjue kombi, me mësue gjuhën e tij, e me i dalë zot vetes".

Sa për njoftim na duhet të informojmë se, Shoqata e historianëve dhe Muzeu i Rrethit-të Dibrës së Vogël - Peshkopisë më 6 qershor dhe Shoqata e historianëve të Dibrës së Madhe më 7 qershor 2003, në pallatet e kulturës së qyteteve të tyre, mbajtën sesionin shkencor kushtuar 125 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me temë "Roli i Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit".

Mois Kamberi, historian nga Peshkopia, në fjalën e hapjes së këtij sesioni shkencor, tha se:"Në jetën e popullit shqiptar ka ngjarje që sipas domethënies së tyre qëndrojnë udhërëfyese në udhëkryqet e mëdha të historisë. Shqiptarët në fund të shekullit 19 krahas kryengritjeve të armatosura bënë përpjekje edhe në drejtim të zhvillimit të arsimit, kuturës e ideologjisë, brënda dhe jashtë vendit kundër "Naçertanies" dhe megaloidesë greke. Lufta Ruso-Turke shtoi rrezikun e copëtimit të tokave shqiptare, që rezultoi me nënshkrimin e traktatit të Shën Stefanit në mars të vitit 1878, me reagimin e ashpër të shqiptarëve dhe me rishikimin e tij në Kongresin e Berlinit qershor 1878.

Në këto rrethana u përhap idea për themelimin e një lidhje të përgjithshme kombëtare pavarësisht nga krahina, feja dhe pozita shoqërore. Lidhja Shqiptare e Prizrenit që filloi punimet në 10 qershor 1878 kryetar i së cilës u zgjodh patrioti dibran Iljaz Pashë Qoku-Dibra, bashkoi masat popullore mbi bazën e një programi të ri e të përparuar të lëvizjes kombëtare për çlirim kombëtar dhe për mbrojtjen e tërësisë së trojeve shqiptare, për bashkimin e shqiptarëve në një unitet shtetëror autonom kombëtar. Në zjarrin e luftës dhe në kuvendet popullore, Lidhja Shqiptare e Prizrenit para faktorit ndërkombëtar paraqiti kërkesën për njohjen e kombit shqiptar si tërësi, ruajtjen e paprekshmërisë së tërësisë së trojeve shqiptare dhe bashkimin e trojeve shqiptare në njësi të vetme adinistrative, gjuhësore me kryeqendrën e vet, duke iu kundërvënë traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit dhe apetiteve pansllaviste.

Dibra në themelimin dhe veprimtarinë e Lidhjes së Prizrenit zë vend të veçantë në aspektin e kontributit dhe të personaliteteve si Iljaz Pashë Qoku- Dibra me shokë, që e bënë Dibrën qendër në planin politik dhe ushtarak, me veprimet në Prizren, Shkodër, Shkup, Manastir, Gjirokastër etj. Dibra u bë qendër e kuvendeve të rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në drejtim të ruajtjes së tërësisë, autonomisë dhe zhvillimit të arsimit e kulturës, Lidhja e Prizrenit la gjurmë të pashlyera në vetëdijen dhe kujtesën e popullit shqiptar që ndikoi në ngjarjet e mëvonshme të Rilindjes Kombëtare.

Pashko Vasa, shkruan, "Populli shqiptar i thotë Evropës. Unë dua të jetoj, të përparoj dhe të jem i lumtur. Përse doni të më coptoni. Jam antar i familjes suaj, më ndihmoni të futem në shoqërinë tuaj dhe të ndjej me ju të mirat e qytetërimit".

Nebi Xhembulla, historian nga Dibra e Vogël - Peshkopia, duke trajtuar temën "Dibra në vitet e krizës lindore", u shpreh se:"Diplomacitë e huaja të vendosura në Ballkan ndiqnin me vëmendje aspiratat sllave për shkëputjen e tokave shqiptare, e njëherit reagimet dhe përgatitjet e popullit shqiptar për t'i bë rezistencë të fuqishme këtij copëtimi. Konsulli anglez nga Selaniku njoftonte Londrën për patriotin dibran Selim Bej Rusi, i cili kishte mobilizuar 4000 ushtarë vullnetarë dibranë për të mbrojtur tokat shqiptare nga aneksimi serb në veri dhe 15 mijë ushtarë vullnetarë nga aneksimi grek në jug.

Kuvendet e Dibrës patën një rezonancë të gjerë të përhapjes në vilajetet shqiptare dhe në kancelaritë e mëdha evropiane, duke i detyruar ato që të merren më shumë me trojet shqiptare dhe me Dibrën në veçanti.

Duke ndjekur veprimtarinë e LSHP, konzujt e diplomacive të huaja vënin në dukje rolin e Dibrës për të mbrojtur me gjak trojet shqiptare, sepse në këtë periudhë edhe LSHP kalon në Dibër dhe që këtu organizohen çetat vullnetare për të mbrojtur trojet e rrezikuara.

Nga e gjithë kjo del se Dibra me veprimtarinë e saj politike e ushtarake u bë barometër i politikës patriotike mbarëshqiptare. Kjo i detyroi diplomatët e huaj që të shkruajnë për shqiptarët, të merren me shqiptarët dhe të marrin parasysh qëndrimin e tyre".

Dr. Lutfi Turkeshi-Dibër, studjues nga Dibra e Madhe duke folur në temën "Kontributi i Iljaz Pashë Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, shtoi se: "Kriza lindore dhe traktati i Shën Stefanit i dhanë zjarr diskutimit në shkallë ndërkombëtare të çështjes së kombit si kategori historike, kombëtare, me të drejtat kombëtare të popujve për të formuar shtetin e vet kombëtar. Sipas parimit të miratuar nga opinioni publik shkencor, populllsia e një vendi që nuk përbënte komb nuk mund të gëzonte të drejtën për të formuar shtetin e vet kombëtar. Në këto kushte në emër të këtij parimi ishin vënë në lëvizje pendat publicistike ballkanike me lakmitë e tyre ekspansioniste ndaj trojeve që ndodheshin në sundimin osman, duke propaganduar të drejtën e tyre "historike' për trojet që aspironin dhe për të vërtetuar se gjoja shqiptarët nuk përbënin një komb. Shqiptarët për t'i zhvlerësuar tezat e armiqve nxorën një plejadë personalitetesh politike shqiptare që me devotshmeri ngritën dhe mbrojtën çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Në këtë kuadër Iljaz Pashë Qoku- Dibra, shquhet si atdhetar, kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe veprimtar i lëvizjes gjithkombëtare. Si tribun i mendimit dhe si luftëtar Iljaz Pashë Qoku veproi me kredon politike nga e cila nuk u lëkund për asnjë çast, se atdheu i tij i mohuar nga perandoria osmane, i papërfillur nga diplomacia evropiane dhe i lakmuar nga fqinjët gllabërues, do ta fitonte betejën. Ai bashkëpunoi ngushtë me Abdyl Frashërin. Ishte vlerësues realist i situatës së ndërlikuar në të cilën ndodhej çështja shqiptare. E dinte se shteti shqiptar nuk mund të themelohej brenda natës dhe se fara e mbjellur në arë do të korrej, por në kohën e vet. Lidhja Shqiptare e Prizrenit u themelua nga krerë të krahinave të ndryshme me përmasa mbarëkombëtare, për t'i bërë ballë rrezikut që kërcënonte vendin. Këtë ia thoshte Iljaz Pashë Qoku-Dibra populit në Dibër, Kosovë e gjetkë. Si kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit fjala e tij kishte vlerë dhe peshë në frymëzimin e patriotëve shqiptarë, ndaj e çmonin mendimin e tij ".

Mois Murra, studiues nga Dibra e Vogël- Peshkopia, duke foli për temën "Kuvendet e Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", thekso se: "Kuvendet në Dibër janë mbajtur si domosdoshmëri për të rregulluar nomalitetin në rafsh krahinor e ndërkrahinor me rrjedhime thellësisht të pastra kombëtare. Nga ana juridike dhe socialpolitike ato barasvlerësohen me parlamentet më demokratikë të Evropës së sotme moderne. Këto kuvende gjatë pushtimit osman kanë patur për qëllim të mos prekej popullata nga reformat e Portës së Lartë, të fitohej pavarësia e të jetohej në liri, ndërsa gjatë pushtimit serb, bulgar e austrohungarez në këto kuvende është bërë organizimi për dëbimin e pushtuesve. Kuvendet kanë patur vlera historike e atdhetare, dhe kanë qenë me karakter demokratik, pa marë parasysh gjendjen sociale, krahinore, hasmëritë dhe bindjet fetare. Vetëm në Qernanicë janë mbajtur 4 kuvende, me përmasa mbarëkombëtare-ai në korrik 1878, nëntor 1880, shkurt 1899 dhe korrik 1909. Më 2 korrik 1878. Lidhja Shqiptare e Prizrenit miratoi programin për ruajtjen e tërrësisë së tokave shqiptare nga rreziku i shovenistëve fqinjë. Për realizimin e këtij programi dhe për krijimin e degëve nëpër krahina kërkohej mbështetja e dibranëve, jo për arsye se në fund të programit figuronin nënshkrimet e Iljaz Pashë Qokut - Dibra, Sadik Pashë Hoxhollit, Ismail Agait, Ismail Markes, Haxhi Iljaz Hoxhës dhe Mahmud Mujë Rekës, por se këtu mishëroheshin identiteti dhe qenia kombëtare. Pas Kongresit të Berlinit që ishte vazhdimësi e vendimeve të Shën Stefanit, ku Plava , Gucia, Rugova iu dhënë Malit të Zi, Vranja, Piroti-Serbisë, Thesalia, Çamëria-Greqisë, krahu radikal i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit , përqëndroi vëmendjen në mbrojtjen e trojeve në veri dhe në jug të Shqipërisë.

Abdyl Frashëri pjesëmarrës në njërin nga Kuvendet e Qernanicës në Dibër, shkruan:"Në këtë Kuvend u shtru pyetja, "Kush është më i rëndësishëm atdheu që e ka krijuar natyra, apo kanuni që e kanë bërë njerëzit". Kështu u bë akti më madhor i faljes së gjaqeve. kur dhjetë mijë njerëz lëshuan armët në tokë dhe iu drejtuan njëri tjetrit, "Falma Gjakun-e për këtë besë"- "Gjakun falë- e besa-besë".

(Vijon në faqen 19)

Rruga e Arbërit nr. 74

portret

Said Najdeni punonte me të gjitha forcat. Ai kishte program pune. Njihte mirë psikologjinë dhe vetitë e popullit të tij. Ideja e tij për hartimin e veprës "Fe –Rrefenjës Myslimane" ishte që ai t'u jepte në dorë shqiptareve një material te plotë, të bukur në gjuhën shqipe

Said Najdeni (Hoxhë Voka)
Atdhetar dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare



Nga: **XHELAL ROÇI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Said Najdeni, pasi bisedoi me shumë njerëz, u nis përsëri për në Stamboll. Duke kaluar në Manastir, Saidit iu bë pritje e shkëlqyer nga shoqëria e Manastirit dhe nga simpatizantë e shokë të tij. Atje u takua me Avdulla Skikulin nga Dibra, i cili ngeli i habitur nga pritja që iu bë Saidit. Ai kishte pasur mendime tjera, e urrente Saidin, e kishte quajtur kaur dhe të pafe. Ngaqë i la përshtypje kjo pritje, Avdullai, u interesua të informohej se pse nderohej ai aq shumë në këtë qytet. Çfarë vlerash dhe meritash paska ky njeri. Kur Avdullai u kthye në Dibër, ia tregoi këtë ngjarje të atit të Saidit dhe e përgëzoi për vlerën e madhe që kishte i biri.. Ai i shpjegoi të atit të Saidit se kishte dëgjuar fjalët më të mira për të në Manastir dhe i tregoi për shokët e tij që e respektonin aq shumë. Në vitin 1899, në muajin e ramazanit, Said Najdeni u kthye nga Stambolli në Dibër të Madhe dhe do të nisej për në Bosnje me rastin e agjërimit të muajit të ramazanit. Gjatë rrugës ai takoi në qytetin e Selanikut kajmekanin e vendit, Nexhi Bej Dragën, një shqiptar, patriot e atdhetar nga qyteti i Mitrovicës së Kosovës. Nexhip Bej Draga e priti dhe bisedoi me respekt e dashuri të madhe Saidin. Ata zhvilluan së bashku bisedime për disa orë për çështjen kombëtare, për problemet e kohës që preokuponin Shqipërinë. Vend të rëndësishëm në bisedimet e tyre zinte problem i gjuhës shqipe. Elementet kundërshtar të lidhur me qeverinë turke, gjuhën shqipe e quanin të papërpunueshme, prandaj kishte pak shkrime letrare e pak shqiptarë që dinin të shkruanin libra e artikuj. Kjo i lodhi shumë shkrimtarët, - thoshin ata, për të gjetur fjalë të përshtatshme. Në përfundim të bisedimeve me Nexhip Bej Dragen, ata të dy ranë në ujdi dhe përcaktuan detyra që në të ardhmen të përpiqen për përhapjen e gjuhës shqipe dhe të luftojnë së bashku kundër atyre që pengojnë përhapjen e gjuhës shqipe. Gjuha, diskutuan ata, duhet të pastrohet nga fjalët e huaja, sidomos nga turqizmat, fjalët sllave dhe greke. Gjatë bisedës morën një shembull se si mund të përkthehet në gjuhën shqipe fjala "dovlet". Saidi shpjegoi se fjala "dovlet" përkthehet "shtet" dhe kjo fjalë përdoret edhe në Dibër. Në përfundim të bisedës, Nexhi Bej Draga i tregoi Saidit telegramin shifër që i kishte dërguar Ministria e Punëve të Brendshme nga Stambolli. Nexhipi ia deshifroi në prezencë, përmbajtjen e telegramit, ia dha në dorë Saidit ta lexojë. Saidi e lexoi atë në gjuhën turke dhe të përkthyer në shqip.

Ja teksti i telegramit:

"- Lajmërohemi nga burime të sigurta se një i quajturi Said Najdeni, i veshur me petkun fetar është nisë në drejtim të Kosovës me qëllim që opinionin e atij populli të kulluar ta përlyejë me ndjenjat revolucionare e të poshtërojë idetë kombëtare shqiptare. Prandaj në mënyrë urgjente, ju porosis të merrni masa të shpejta e të plota për të kapur e ndaluar atë menjëherë. Saidi e lexoi telegramin. Buzëqeshi dhe ia ktheu telegramin Nexhip Beut, i cili e mbylli në kasafortë dhe filluan përsëri bisedimet për problemet kombëtare. Këto bisedime ishin kundër interesave të qeverisë turke, ajo kishte marrë e forcuar shumë masat e kontrollit në drejtim të personave të dyshimtë. Nexhip Bej Draga e përcolli Said Najdenin për në qytetin e Shkupit të shoqëruar nga njerëzit ë tij me besnikë, ndërsa Ministrisë së Punëve të Brendshme në Stamboll i ktheu përgjigje telegrafisht se një njeri i tillë nuk është parë në këtë rajon." Marrë nga bisedat me z.Vasfi Xheladini, sipas kujtimeve të Said Najdenit.

Sahid Najdeni, pasi arriti në Shkup, shkoi e takoi Hafiz Pashën, që ishte vali i Shkupit. Hafiz Pasha ishte turk, me origjinë kurde, por një ndër valitë më të aftë të shtetit turk për kohën. Ai ishte përkrahës i Mitat Pashës, kishte pikëpamje xhonturke. Punonte në mënyrë të maskuar, gjoja besnik i shtetit turk. Sahid Najdeni kishte njohje të hershme me të dhe bisedoi fillimisht me atë. Ata i bashkonin pikëpamjet kundërshtare ndaj shtetit turk. Said Najdeni punonte për interes të kombit shqiptar, ndërsa Hafizi, për interes të vendlindjes së tij, për Kurdistanin. Të dy këto kombe i shfrytëzonte për interes të tij shteti turk. Bisedimet e tyre zgjatën për rreth 24 orë. Tema e bisedimeve ishte përgatitja e një lëvizje të madhe, kundër shtetit turk, Sulltanatit, për të fituar lirinë. Said Najdeni, pasi u nda me Hafiz Pashën, u nis për në Mitrovicë të Kosovës, për tu takuar me shokët ë tij të ngushtë të mendimeve dhe të veprimeve të Hafiz Ibrahim Mitrovicës. Said Najdeni qëndroi disa ditë në Mitrovicë. Atje takoi e bisedoi me Hafiz Ibrahimin dhe me disa burra të ndershëm, patriotë e atdhetarë kosovarë. Temat e bisedimeve ishin për çështjet e kombit shqiptar. Ndërsa Saidi vazhdonte punën propagandistike kundër qeverise turke, nga Ministria e Punëve të Brendshme turke në Stamboll vazhdonin njoftimet me telegrame Valiut të Shkupit, Hafiz Pashës. Ata i jepnin urdhër:

"Një talebe, Said Najdeni, (Hoxhë) të gjindet ku të jetë dhe menjëhere të ndalohet. Veprimet ndaj tij të bëhën me kujdes, të mos shkaktohen trazira në popull." Ky urdhër i Stambollit vërtetonte edhe një herë se sa i rrezikshëm ishte për qeverinë turke Said Najdeni dhe sa e rëndë ishte fjala dhe penda e tij kundër Turqisë në atë kohë. Hafiz Pasha e dinte se ku ndodhej Said Najdeni, ai dinte edhe qëllimin e tij, që ai i kishte vënë vetes. Hafiz Pasha dërgoi nga Shkupi në Mitrovicë komisarin e policisë dhe dy punonjës policie, që ta merrnin Saidin nga Mitrovica e ta sillnin në Shkup. Valiu u dha porosi që atje ta merrnin me urtësi, duke i thënë se mos të trembet. Hafiz Pasha e bëri këtë që ta ketë vetë nën kujdes. Policia e kreu detyrën. Ata shkuan e morën dhe e sollën në Shkup. Porsa hyri në Shkup, populli i doli përpara Saidit. Saidi shkoi në zyrën ë e Hafiz Pashës, i cili e priti me nderime të mëdha.

Pasi bisedoi me të, e la të lirë të shkonte në një hotel për të qëndruar. Hafiz Pasha lajmëroi Stambollin për ndalimin e tij dhe kërkoi nga ata se si duhet të vepronin me të. Stambolli dha porosi: "Said Najdeni të mbahet në Shkup në kontroll të fortë, duke i krijuar përshtypjen, se qeveria turke nuk ka gjë me të". Ndërsa nga ana tjetër porosiste që masat e kontrollit ndaj tij të jenë të forta dhe të përdoren në mënyrë shumë sekrete. Jemi në vitin 1899, shteti turk ishte dobësuar shumë. Turqia kishte fituar luftën më Greqinë, por tokat e pushtuara nga Turqia iu kthyen Greqisë. Në vitin 1898, të gjithë shqiptarët që kishin qenë në luftë kundër Greqisë ishin kthyer. Turqia në luftë më Greqinë humbi Selanikun. Grekët, bullgarët, serbët dhe malazezët që kishin qenë nën sundimin turk, kishin fituar lirinë, gjuhën ë tyre, të drejtat për të hapur shkolla, ndërsa shqiptarët nuk kishin fituar asgjë. Shoqëritë shqiptare në mërgim kishin ngritur zërin dhe kërkonin me lutje pranë Sulltanit të drejtat e tyre. Turqia nuk i merrte parasysh këto kërkesa, përkundrazi qeveria turke kërkonte nga shqiptarët taksa dhe ushtarë. Në vitin 1898 komitetet bullgare e serbe kishin pretendime për çështjen e Kosovës. Malazezët sulmonin disa fshatra shqiptare në veri të Shqipërisë dhe kërkonin t'i futnin nën sundimin e tyre. Situata politike në Ballkan ishte e ndezur. Çdo veprim bëhej në kurriz të shqiptarëve. Kishte ardhur koha dhe ishin krijuar kushtet që edhe shqiptarët të kërkonin të drejtat e tyre kombëtare. Në këtë situatë, Said Najdeni, punonte natë e ditë. Ai vazhdonte të merrte takime, bisedonte me njerëz patriotë e atdhetarë. Në këtë kohë ai këshillonte e propagandonte "besë e bashkim". Ka ardhur koha që secili shqiptar duhet të japë kontributin e tij për çështjen kombëtare. Në këto kushte u mblodh në qytetin e Pejës të Kosovës "Kuvendi i Pejës", i kryesuar nga Haxhi Zeka. Vendimet e Kuvendit të Pejës më kryesore ishin:

- Të ruajmë Atdheun nga fqinjët armiq.
- Të ndalohen vrasjet, vjedhjet, grabitjet në Shqipëri.
- Të organizohen itifaqe. Të hiqet dorë nga hakmarrja.
- Të vendoset rendi, qetësia e rregulli kudo në Shqipëri.

Në kuvend u diskutua për të gjitha problemet kombëtare shqiptare që ishin më prekupante. Në muajin shkurt të vitit 1899, pas Kuvendit të Pejës, u bë edhe Kuvendi i Dibrës. Në Kuvend morën pjesë delegatë nga Dibra, Mati dhe Reka. Në Kuvend u shtrua detyra që të lidhin besën për t'i dalë zot Atdheut e Kombit dhe të sigurohet qetësia publike brenda vendit. Në krye të organizimit të Kuvendit dhe të gjithave veprimeve që u kryen ishte Said Najdeni. Turqia ishte kundër këtyre veprimeve të shqiptarëve, prandaj Said Najdenin shteti Turk e ndiqte këmba- këmbës. Turqia nuk dëshironte të përdorte forcën e dhunës ndaj shqiptarëve. Hafiz Pasha në Shkup, pasi bisedoi edhe njëherë me Stambollin, mori porosi nga autoritetet turke që ta lironte Said Najdenin të shkonte në Dibër të Madhe, pasi t'i merrte një garanturë (dorëzanë). Dorëzane për Said Najdenin u bë Zenel Hajdaraga nga Dibra e Madhe, i cili deklaroi: "Hoxha Said Najdeni bën fli veten për Atdhe dhe unë bëj fli veten time për atë". Sait Najdeni ishte komunikues me cilindo. Ai kishte të shkuar të mirë edhe me pjesëtarët ë familjes. Said i kërkoi të atit të tij t'ia linte atij në dorë fejesën e të vëllait Sefedinit. I ati, Islami, ishte dakord. Vëllain, Sefedinin, propozoi Saidi, do ta fejomë me një vajzë nga fisi Marke, në fshatin Bovmovë. Bovmova ishte fshat afër qytetit të Dibrës së Madhe buzë lumit "Drini". Nga Bovmova, mbasi kaloje lumin Drin, del në fshatin Viçisht e në Gjoricë futesh në Grykë të Vogël dhe në fshatra të tjerë. Po kalove Çerenecin futesh në Grykë të Madhe e vazhdon në krahina të tjera të vendit. Fisi Marke janë me origjinë nga fshati Zogje i Grykës së Vogël. I ati, Islami, e pyeti Saidin se çfarë i duhej miqësia me atë shtëpi atje. Saidi shpjegoi: "Edhe kjo miqësi mua më lypset shumë, se më krijon mundësi të lidhem me fshatrat e Grykës Së Vogël, Grykës së Madhe dhe të thellësisë. Unë kam mundësi që nëpërmjet tyre ta shtrij aktivitetin tim në favor të kombit dhe të Atdheut. Për këtë e kam të nevojshme të lidhem me shtëpi të forta në malësi. Ne do të shtrijmë propagandën në këto vende dhe do të përgatitim kryengritjen e përgjithshme." Miqësia u përfundua, fejesa u krye dhe dasma u bë brenda vitit.

Nga propaganda që zhvillonte me pjesëtarët e familjes, Said Najdeni kishte arritur që prindërit e tij, vëllezërit dhe motrat ishin bërë atdhetare të flaktë, përkrahnin mendimet e tij dhe luftonin me të gjitha mundësitë për çështjen e për interesat kombëtare. Ata shkruanin dhe lexonin shumë mirë në gjuhën shqipe për kohën. Motra e tij, Razija, megjithëse ishte në moshë të vogël, gjuhën shqipe e shkruante dhe e lexonte shumë mirë. Kujtime nga biseda me Razije Pregja me banim në Tiranë.

Saidi ishte i sëmurë me turbekuloz. I ati ishte shumë i shqetësuar për shëndetin e tij, pasi Saidi kishte mungesë oreksi, kishte fytyrë të zbehtë dhe gjithmonë dukej i lodhur. Islami disa herë e kishte këshilluar Saidin të hiqte dorë nga puna e tepërt, pasi përbënte rrezik për jetën e tij. "- Nuk bëj llogari shpenzimet që ke bërë dhe po bëni, por shikoj se ke shëndet të dobët", - i fliste shpesh i ati. "- Jam gati të shkrij të gjithë pasurinë time për juve, jam gati të shpenzoj edhe ata qe kanë mbet. Dëshiroi të qetësohesh, të kthehet shëndeti dhe fuqia. Kjo do t'i sherbente edhe rrugës qe këni nisur juve për çështjen kombëtare."

Saidi iu përgjigj të atit: "Unë nuk i prisja këto fjalë prej jush. Ju duhet te jeni kryelartë për përpjekjet qe po bëjmë dhe për mendimet që kemi dhe duhet të bëjmë edhe më shumë për çështjen kombëtare. Unë nga vetja ime jam i pakënaqur se nuk kemi mundur me ba sa duhet. Ju falënderoj juve edhe vëllezërit e mi që nuk keni kursyer gjë për mua dhe e shkritë të gjithë pasurinë tuaj. Sakrifica që keni bërë juve, nuk më përket mua, por të gjithë Shqipërisë, Kombit dhe Atdheut. Mundin, djersën dhe gjakun çdo shqiptar ia ka borxh Atdheut dhe kombit të tij. Po shkon Shqipëria, po merret nëpër këmbë nderi i Shqiptarit. Çfarë vlere ka jeta ime, kur po vdes i gjithë kombi shqiptar e po copëtohet Atdheu?!" Saidi vazhdoi: "Mua Sulltani i Turqisë me afrue me më paguae një rrogë të majme, vetëm mjafton që unë të bëhem vegël e tij. Nuk mund të pajtohem me ata që luajnë me fatin e Shqipërisë e të Shqiptarëve. Nuk vuaj për grada e për para, por po punoj për komb e për Atdhe. Dua që shqiptarët të fitojnë lirinë, të mësojnë gjuhën shqipe, të njohin veten, t'i njoh bota dhe të punojnë për veten e tyre."

"Shqipërisë i kanosen rreziqe të mëdha dhe duan ta copëtojnë. Rruga e vetme e shpëtimit të Shqipërisë është zgjimi i kombit, mësimi i gjuhës shqipe dhe ne duhet t'i dalim zot vendit. Edhe unë me shokët e mij, - vazhdoi Saidi, këtë qëllim i kam vënë vetes time që të sakrifikojmë për vendin tonë. Këtë kërkoj edhe nga ju pjesëtarët e familjes time, që të sakrifikoni për vendin tonë."

Saidi kudo shkonte shpërndante libra në gjuhën shqipe. Këto në mënyrë ilegale i transportonte me anën e shokëve e dashamirësve të tij. Ai i kalonte librat dhe materialet në gjuhën shqipe nga një vend në një tjetër me anën e tyre. Propagandën që zhvillonte kundër Turqisë dhe në favor të kombit shqiptar e shoqëronte me libra.

Pasi u fliste për gjuhën shqipe, ai u jepte libra. Librat, zakonisht, pasi vinin në Dibër të Madhe me anën e qiraxhinjve nga shoqëritë shqiptare në mërgrim, i kalonte nga Dibra e Madhe në Bovmovë, në Grykë të Vogël, në Bllacë, në Zogje, në Grykë të Madhe, në Bulqizë, Në Mat, në Tiranë, në Luzni, në Dohoshisht, Brezhdan, e deri në Lurë. Këtë punë sa të vështirë dhe më rreziqe ai e realizonte me anën e miqve dhe simpatizantëve të tij. Autoritetet turke e kishin nën kontroll si njeriun e dyshimtë. Organet qeveritare turke në Dibër të Madhe kishin informacione te sigurta për veprimtarinë e Said Najdenit, sidomos në lidhje me shpërndarjen e librave. Në atë kohë mytesarifi i Dibrës, Hysen Pasha, pasi ishte informuar se Saidi kishte në shtëpi libra në gjuhën shqipe, dha porosi të bëhej kontrolli i banesës së tij dhe në rast se do t'i gjenin libra, ta arrestonin menjëherë. Për këtë qëllim mytesarifi konsultohet dhe me këshilltarin qeveritar në Dibër, Hysen Xhekalçe, tregtar në Dibër të Madhe. Gjatë bisedës ai i shprehu Hysen Xhemalçes se në qytetin tonë gjendet edhe një hoxhë, Said Efendi Najdeni, i cili mban në shtëpi dhe shpërndan libra të dëmshëm në gjuhën shqipe që ndalohen nga ligjet e shtetit tonë. Nuk e besoj, - i përgjigjet Hysen Xhemalçe. Ky njeri është nga qyteti. Ka krye shkollë të lartë fetare në Stamboll. Në muajin e madhërueshëm të ramazanit lëviz nëpër shokë e miq.

Është edhe i sëmurë me turbekuloz. Megjithatë është e drejta e juaj, ju mund të urdhëroni edhe atij t'i bëhet kontrolli i banesës, po u gjetën materiale të ndaluara në kundërshtim me ligjet e shtetit tonë, mund ta arrestoni. Këto fjalë e zbutën mytesarifin, i cili nuk mori masa të shpejta atë ditë, por e la për më vonë. Hysen Xhemalçe, porsa doli nga mbledhja e këshillit, shkoi në dyqan të Islam Najdenit dhe e vuri në dijeni për të gjitha bisedat që kishte zhvilluar me mytesarifin dhe e këshilloi që menjëherë

Në vitin 1962, Presidiumi i Kuvendit Populllor të Republikës Populllore të Shqipërisë, për aktivitet politik e revolucionar e dekoroi Said Najdenin me Urdhrin "PËR VEPRIMTARI PATRIOTIKE TE KLASIT TË DYTË".

të largojë librat nga banesa. Islami e lajmëroi Saidin dhe e porositi që të largonte çdo gjë të ndaluar nga shtëpia dhe nga vende të tjera ku mund të kontrollonin. Të mos linte asnjë shenjë të dyshimtë. Të nesërmen komandanti i xhandarmërisë në Dibër të Madhe, Hajredin Pustina, me një togë xhandarësh rrethoi e kontrolloi shtëpinë e Said Najdenit dhe të shokëve te tij, por ata nuk gjetën asgjë. Librat dhe sendet të tjera kompromentuese ishin larguar më përpara se të shkonin xhandarët. Një pjesë e tyre kishte shkuar në fshatin Bovmovë, me porosi që ata të kalonin, matanë lumit Drin dhe të shkonin në vendet e caktuara, në malësi të Dibrës.

Në fillim të shekullit XX-të ndërgjegjja kombëtare në Dibër të Madhe ishte rritur në një shkallë më të lartë. Kishin filluar të organizoheshin mbledhje dhe Kuvende për të dalë nga sundimi i rëndë i Turqisë. Populli nuk mund ta përballonte shtypjen e shfrytëzimin e egër të Turqisë. Taksat e rënda e kishin rënduar shumë. Populli kërkonte të drejtat e tij, lirinë, çlirimin shoqëror, arsimim në gjuhën shqipe. Varfëria u bë shkak për revolta e kryengritje dhe lëvizje që kundërshtonin regjimin turk. Lëvizje të tilla shpërthyen në të gjithë krahinat me popullsi shqiptare si në Shkup, Dibër, Tiranë, Kosovë e tjerë. Shkupi e përzuri valiun Hafiz Pasha. Qeveria turke, e detyruar nga presioni i masave, bëri disa lëshime, të falë pagesat në disa vende shqiptare dhe në Dibër. Edhe në drejtime tjera situata në Dibër filloi të ndryshojë. Qeveria turke në Dibër, me detyrën e mytesarifit caktoi Xhemal Pashë Zogun, me besnikun e tij Avdurrahim Matin dhe Sali Bej Dohoshishtin (Agollin), i cili ishte krushku i Xhemal Pashë Matit, pasi kishte martuar të bijën me djalin e tij, Emin Agollin.

Said Najdenin e lidhte miqësia me këta persona që ishin në shërbim të shtetit turk. Ai, pasi kishte biseduar disa herë me ta, mundi t'i bindë, tu marrë leje dhe nën mbrojtjen e mbikëqyrjen e tyre, të hapë një shkollë të vogël shqipe, për të mësuar gjuhën amtare. Në cilën ndërtesë ka funksionuar kjo shkollë, nuk kemi informacion të saktë, sepse kjo bëhej në mënyrë shumë ilegale. Disa njerëz nga Dibra kujtojnë se ka qenë në shtëpinë e Avdulla Manjanit, që ndodhej ballë për ballë me çezmën e xhamisë se Dollmehallës. Në këtë shtëpi banonte Xhemal Pashë Zogu. Këtë shtëpi e bleu Ramadan Tërnova. Në këtë shtëpi punoi e veproi për të përhapur gjuhën shqipe Muharrem Ramadan Ternova. Kjo shkollë nuk dihet se sa funksionoi. Ajo u diktua nga qeveria turke dhe u mbyll menjëherë. Kundër njerëzve iniciatorë që e hapën, nuk u mor asnjë masë, pasi ata qenë nën mbrojtjen nga ana e Xhemal Pashe Zogut dhe Sali Bej Agollit, Dohoshishtit. Nxënësit e kësaj shkolle i vazhduan mësimet edhe më vonë nëpër bodrume të errëta të shtëpive dhe të dyqaneve. Gjatë viteve 1902-1903 Maqedonia dhe Bullgaria kishin filluar të ngrinin krye kundër Turqisë. Ata i kishin sjellë shumë shqetësime qeverise turke. Gjatë vitit 1903 shpërthyen kryengritjet masive në Maqedoni e Bullgari. Në qytetin e Ohrit torturohen e vriten tradhtisht nga bujqit e tyre, që ishin anëtar të komitetit bullgar të Maqedonisë vëllezërit Bexhet, Nazif e Xheladin Tërshana nga qyteti i Dibrës së Madhe. Po në këtë vit, duke udhëtuar për në Perlepe për të kontrolluar pronat e tyre, vritet gjatë rrugës në Llazrapole Abdurraman Bej Kodra dhe Lito Cami. Edhe këto torturohen barbarisht e vriten tradhtisht. Këto pasiguri që ishin krijuar, kishin irrituar popullin e Dibrës dhe ishin nisur në drejtim të Dërbëcës për veprime hakmarrje. Gjatë rrugës ndodhën përplasje me armë me Komitetin Bullgar. Disa nga këto i kapën rob të gjallë, i sollën në Dibër dhe i burgosën. Për të shuar grindjet, ndërhyri Metropoliti Bullgar në Dibër dhe i liroi nga burgu. Këto ngjarje e ulën shumë autoritetin e qeverisë turke. Në mes të pazarit në qytetin e Dibrës te Ura e Selamit furrtari bullgar Kresteia me lopatën tentoi të godasë Bexhet Mustafën, që ishte kryetar bashkie në kohën që po dilte nga zyra. Në këtë moment ndërhyri Sulejman Meta, një pemëshitës që u ndodh prezent, i cili qëlloi me revole dhe e vrau Kresten. Autoritetet qeveritare e burgosën Sulejmanin. Këto veprime tregonin se për shqiptarët ka qeveri e ligje dhe nuk ka liri. Lëvizja bullgare u përhap në të gjithë Maqedoninë. Kjo e detyroi qeverinë turke të marrë masa dhe të shtypë lëvizjen. Për të mbrojtur të drejtat e Maqedonisë ndërhyri

Në Republikën e Shqipërisë mbajnë emrin e Said Najdenit, një lagje në qytetin e Peshkopisë, një rruge, shkolla e mesme Peshkopi dhe në fshatin Selishtë shkolla tetëvjeçare e këtij fshati. Figura dhe shembulli i këtij atdhetari të flaktë do të kujtohet gjithmonë me dashuri dhe do të shërbejë për edukimin patriotik të brezave të ardhshëm dhe të të gjithë masave punonjëse të vendit tonë e të kombit shqiptar. Emri i tij do të kujtohet brez pas brezi.

Rusia dhe Austria, të cilët e detyruan Turqinë të nxjerrë e të zbatojë amnistinë e përgjithshme dhe të shpërblejë dëmet që ishin shkaktuar maqedonasve dhe të marrë masa reformuese në administratën e tre vilajeteve; në Selanik, Manastir e Kosovë. Në këto vilajete u caktua një inspektor i përgjithshëm që të mbrojë të drejtat e maqedonasve. Qeveria turke u detyrua të bëje lëshime, të japë disa të drejta dhe autonomi për Maqedoninë.

Maqedonasit kërkonin që të shtriheshin deri në Qafë Krrabë e në Qafë Murrizë, duke përfshirë edhe prefekturën e Korçës. Këto padrejtësi kërkoheshin të zbatoheshin në kurriz të copëtimit të Atdheut tonë, kjo shtroi detyra të ngutshme përpara nacionalisteve shqiptarë. Nacionalistët shqiptarë filluan bisedimet me xhonturqit. Ata filluan të lëvizin dhe të organizohen kundër regjimit të Sulltan Hamitit. Për këtë u vendos që të bëhet një kongres ne Tarabullus-Garb (Tripoli) në Afrikë nën drejtimin e Rexhep Pashë Matit që ishte caktuar nga qeveria turke Vali në atë territor. Në këtë kongres u thirrën shumë delegatë nga Shqipëria. Për Kosovën e Dibrën u caktua delegat Said Najdeni, për Shkodrën Refik Toptani dhe për Janinën Ismail Qemali. Said Najdeni, përpara se të niset për në Tripoli, mori takim me disa krerë të Dibrës dhe te Kosovës, me të cilët jo vetëm u konsultua, por ata i dhanë edhe miratimin e tyre, duke i dhënë kompetenca që të përfaqësojë këto dy krahina. Akoma pa u nisur për rrugë Said Najdeni, qeveria turke në Stamboll u informua dhe ajo menjëhere njoftoi telegrafisht Dibrën që të arrestohet Saidi. Mytesarifi i Dibrës nuk e njihte Said Najdenin dhe ai për këtë problem takoi mikun e tij Sheh Emerllain e Këllëçbabës dhe i kërkoi të dhëna për Said Najdenin. Ai i ekspozoi Sheh Emërllait se kishte marrë urdhër ta arrestojë Saidin. Shehu iu përgjigj Mytesarifit se ky njeri është fare pa rëndësi, është Hoxhë, banon këtu në qytet dhe kurdoherë e ke gati. Mjafton t'i dërgosh një xhandar, ta thërrasësh dhe ai vjen vetë. Pasi mori këtë informacion, Mytesarifi qetësohet dhe qëndroi me Shehun në Teqe deri afër mbrëmjes që ishte ditë e premte. Në mbrëmje Sheh Emërllai, pasi e përcjell Mytesarifin, hëngri darkën, ndezi fenerin, dhe në errësirën e natës niset e shkoi në shtëpi të Said Najdenit. Megjithëse ishte larg, ai vajti e lajmëroi Saidin që të largohej sa më parë nga shtëpia se ka ardhë urdhër nga Stambolli për ta arrestuar atë. Sheh Emërllau largohet menjëherë për në Teqe. Saidi futet në shtëpi bën gati rrobat, shkruan një letër për të atin e tij, Islamin, i cili nuk u ndodh në shtëpi, takohet me pjesëtarët e familjes dhe, pasi u la letrën në dorë për të atin, në errësirën e natës u nis për në fshatin Bovmovë. Nga Bovmova kaloi në Grykë të Vogël dhe vazhdoi rrugën, në Grykë të Madhe, Bulqizë dhe shkoi te Xhemal Pashë Zogu në Mat, ku qëndroi tre ditë. Xhemal Pasha me njerëzit e tij e përcolli për te Refik Toptani në Tiranë. Atje u takua me Refik Toptanin. Edhe ky kishte marrë lajmin se do të bëhej në Tripoli të Afrikës një Kongres, në të cilin do të merrte pjesë Said Najdeni, Ismail Qemali, Refik Toptani nën kryesinë e Rexhep Pashë Matit. Said Najdeni me Refik Toptanin njihej që më parë. Ata i kishte njohur me njëri-tjetrin Ismail Qemali në Stamboll. Saidi së bashku me Refik Toptanin bënë planin e udhëtimit për në Tripoli. Ata bashkë zbritën nga Kamza në qytetin e Tiranës dhe pasi u takuan me Mulla Ramazan Efendiun, i kërkuan atij që të hartonte dy shkresa, me të cilat të vërtetonte se Hafez Mustafa Efendiu, emër i maskuar i Refik Toptanit dhe Hafez Mehmet Efendiu që do të ishte emër i maskuar për Said Najdenin, ishin studentë të medresesë "Taleba Ulumit" në Stamboll. Pasi siguruan këto dy certifikata false në Myftininë e Tiranës u nisën për në Durrës dhe i vërtetuan dokumentet me vulën e Myftinisë së Durrësit. Policia e Durrësit u lëshoi dy pasaporta për të shkuar në Vlorë. Ata ndryshuan veshjen, u veshën me rrobat fetare, me shall, lanë mjekër të parruar. Pasi arritën në Vlorë, të dy së bashku me Refik Toptanin morën dy bileta për në Brindizi të Italisë. Nga Brindizi shkuan në Napoli, ku u takuan me Ismail Qemalin, i cili gjatë bisedës, u shpjegoi se kishte biseduar me Rexhep Pashë Matin që edhe këto bashkë me delegatët e vendeve të ndryshme që ishin nën sundimin e Turqisë të kërkonin shkarkimin nga detyra të Sulltan Hamitit dhe në vend te tij të vinte në front Sulltan Murati që ishte i burgosur. Në mbledhje të bisedohej me pjesëmarrësit e kongresit për çështjen shqiptare, porositi delegatët Ismail Qemali. Para se të niseshin nga Napoli, Ismail Qemali u dha disa letra e dokumente për t'ia dërguar Rexhep Pashë Matit në Tarabullus. Gjithashtu, u dha edhe 20 napolona flori, para për rrugëtim.

Pasi arritën në Tarabullus u takuan me Rexhep Pashë Matin dhe biseduan për problemet e kombit shqiptar. Pas përfundimit, Rexhep Pashë Mati, para se t'i përcillte për rrugë, u dha disa dokumente për t'ia dërguar Ismail Qemalit në Firence të Italisë dhe prej andej do të vinin në Shqipëri për të përgatitur e ngritur popullin në kryengritje të armatosur kundër Turqisë. Rexhep Pashë Mati i dha Saidit para flori për rrugëtim. Gjatë rrugës Said Najdeni u sëmur keq nga dizenteria. Me gjithë gjendjen e keqe shëndetësore, Saidi arriti në Durrës. Nga Durrësi shkoi në Kamzë. Pasi qëndroi dy ditë i fshehur në shtëpinë e Refik Toptanit, Said Najdeni ditën e tretë u nis me disa qiraxhinj për në Dibër, i përcjellë nga Avdyl Bylyku dhe dy shërbëtorë të tjerë. Said Najdeni ankohej se ishte i sëmurë dhe mezi qëndronte në këmbë. Pas katër ditë rrugëtimi arriti në Dibër, i shoqëruar nga njerëzit e Refik Pashë Toptanit. Kur arriti në Dibër, pjesëtarët e familjes së tij mezi e njohën Saidin. Ai ishte dobësuar nga dizenteria. I kishte rënduar edhe sëmundja e turbekulozit dhe ai menjëherë zuri shtratin, për të mos u ngritur më. Çdo ditë që kalonte, Saidi dobësohej. Ai shpresonte të jetonte e ta shikonte Shqipërinë e lirë, ta shikonte se si mësohej gjuha shqipe në shkolla. Edhe i sëmurë në takime me shokët e miq, u shpjegonte atyre, se këtu në Shqipëri, do të mësohet gjuha shqipe. Kjo ditë do të jetë shumë e afërt. Gjatë bisedës i shprehu të vëllait, Qazimit, se unë po vdes i dëshpëruar dhe pak ditë më kanë ngelur për të folur gjuhën shqipe në këtë botë. Mua nuk do të më kalbë toka, se nuk arrita të shikoj me sytë e mi se si mësohët gjuha shqipe. Po të le amanet: "Në varrin tim mos më vini gur, derisa të çlirohet Shqipëria dhe të fitohet liria. Gurët të m'i vini të shkruar në gjuhën shqipe. Në këto gur të ngulni edhe flamurin e kombit shqiptar, të cilin për fat të keq nuk po e shikoj për së gjalli.

Këto biseda të tij, ia kundërshtuan pjesëtarët e familjes, motrat, vëllezërit dhe njerka e tij, duke i dhënë kurajo për jetën se ai do të jetonte dhe do t'u mësonte vetë njerëzve gjuhën shqipe. Në shtëpi të tij vinin për ta takuar Saidin shumë njerëz e dashamirës nga të gjitha shtresat e popullsisë, fshatarë, qytetarë, fetarë, intelektualë e parësi e vendi. Megjithëse i sëmurë, Saidi bisedonte me ata për problemet e kohës si çështja e lirisë, autonomisë, pavarësisë së vendit, për shkollat shqipe e për mësimin e gjuhës shqipe. Ai i porosiste të gjithë ata që takonte se duhet të punojmë të gjithë për të mirën e Atdheut, Shqipërisë. Bullgarët, grekët, serbët, maqedonasit duan ta copëtojnë Shqipërinë. Shqiptarët duhet të jenë të bashkuar, theksonte ai gjithmonë. Të lidhim besën dhe ta mbajmë atë, për të mbrojtur Atdheun, kombin dhe nderin e Shqiptarit.

"Shqipëria sot është në buzë të varrit, po vdes ashtu siç po vdes unë. Ju duhet të hapni sytë." Ata vërtetonin fjalët e Saidit. Kur largoheshin shprehnin: "Ky është duke vdekur dhe mendon për Atdheun, për Shqipërinë. Gjithë jetën e tij e kaloi në shërbim të vendit, popullit dhe të kombit."

"Në radhët tona ka njerëz që janë të lidhur me të huajt, i shërbejnë Turqisë, janë bashkuar me atë, ka nga ata që marrin rroga, që mbajnë grada, ofiqe dhe nuk mendojnë për popullin dhe për Shqipërinë". I ati e qortonte që të mos i rëndonte njerëzit që vinin e vizitonin për të sëmurë, në shtëpinë tonë. Ashtu është, - i përgjigjej Saidi të atit, por nuk më durohet. E shikoi rrezikun që po i kanoset vendit, Shqipërisë. Kjo ka të bëje me dashurinë e madhe që kam për Atdheun, për kombin Shqiptar. U lutem të me falni gabimet, të m'i bëni hallall të gjitha.

Në muajin dhjetor të vitit1903 Said Najdeni vdiq në vendlindjen e tij, në qytetin e Dibrës së Madhe duke mbajtur në gojë përpjekjet që duhet të bëjnë shqiptarët për liri, autonomi, pavarësi, për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe mësimin e përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha administratat e vendit. Të afërmit e Saidit u larguan nga Dibra e Madhe dhe u vendosën me banim në qytetin e Tiranës. Shqipëria e fitoi pavarësinë dhe u bë shtet, u hapën shkolla shqipe, u mësua gjuha shqipe, u vendos administrata me nëpunës shqiptarë dhe gjuhë zyrtare u bë gjuha shqipe, por Said Najdeni vdiq para kohe duke lënë stafetën e tij pa e çuar deri në fund. Ai la në pikëllim pjesëtarët e familjes, shokët, miqtë e dashamirësit e tij që bashkëpunoi me ta gjatë gjithë jetës së tij për interes të kombit shqiptar.

Said Najdeni ishte i pajisur me kulturë të gjerë, njohës i disa gjuhëve të huaja, si turqisht, arabisht, frëngjisht, serbisht. Ai nuk pranoi të punojë në administratën e korruptuar burokratike osmane. Ai i kishte vënë vetes vetëm një qellim: T'i shërbejë kombit shqiptar. Sa ishte gjallë, ishte një pionier i arsimit kombëtar, mik e bashkëpunëtor i respektuar i vëllezërve Frashëri, Ismail Qemalit, Rexhep Pashë Matit, Dervish Himës, Hamdi Ohrit, Refik e Said Toptanit, Petro Nini Luarasit, Nikolla Naços, Kristo Luarasit, Shahin Kolonjës e të tjerë. Ai mbeti figurë e shquar, e dashur dhe e respektuar, njeri i nderuar, i matur, i butë e i urtë dhe me zemër të gjerë e të madhe. Në vitin 1956, kunata e tij, Nusrete Najdeni, erdhi përgjithmonë dhe u vendos më banim në qytetin e Tiranës. Ajo solli me vete flamurin e kuq me shqiponjë dy krenare që e mbante Said Najdeni

Në vitin 1962, Presidiumi i Kuvendit Populllor të Republikës Populllore të Shqipërisë, për aktivitet politik e revolucionar e dekoroi Said Najdenin me Urdhrin "PËR VEPRIMTARI PATRIOTIKE TE KLASIT TË DYTË". Në Republikën e Shqipërisë mbajnë emrin e Said Najdenit, një lagje në qytetin e Peshkopisë, një rruge, shkolla e mesme Peshkopi dhe në fshatin Selishtë shkolla tetëvjeçare e këtij fshati. Figura dhe shembulli i këtij atdhetari të flaktë do të kujtohet gjithmonë me dashuri dhe do të shërbejë për edukimin patriotik të brezave të ardhshëm dhe të të gjithë masave punonjëse të vendit tonë e të kombit shqiptar. Emri i tij do të kujtohet brez pas brezi.

- FUND -

Për hartimin e kësaj monografie janë shfrytëzuar këto materiale:

1. Libri i Haki Stërmillit "Dibra në prag të historisë", dorëshkrim.
2. "Kujtime historike", të shkruar nga Ismail Strazimiri.
3. Kujtime historike, lënë nga mësuesi Haki Sharofi.
4. Materiale nga dosja e tij në Muzeun Historik te Dibrës.
5. Fjalori Enciklopedik Shqiptar në faqet 142-143.
6. Kujtime nga leksioni "Djelmnia Shqiptare", shkruar 1937, grup autorësh.
7. "Dibra dhe Etnokultura e saj". Vëllimi dytë.
8. Shkollat e para kombëtare shqipe, autor Hysni Mezini, faqe 140-180.
9. Kujtime nga mësuesi Myslim Shehu, Peshkopi.
10. Kujtime nga veterani Vasfi Xheladini.
11. Monografia e tij e hartuar nga grup autorësh: Sotir Temo, Lulzim Bilbili, dhe Petrit Najdeni. Botim i vitit 1980.
12. Dekreti i Presidiumit të Kuvendit Populllor i R.P.Shqipërisë Nr. 3608 datë 26,02.1962 "Mbi dekorimin e Said Najdenit (Hoxhë Voka) me Urdhër "Për veprimtari Patriotike të Klasit II-të"
13. Kujtime nga mësuesi Haxhi Adem Skenderi ne Gjoricë.
14. Monografia e Dervish Himës. Autor Kristaq Prifti.
15. Artikuj, shkruar periodikisht ne gazetën "Ushtima e Maleve"

Rruga e Arbërit nr. 74

histori

Vitit 1911 qe një këmbanë e fuqishme që sinjalizonte perendimin e Perandorisë osmane nga Shqipëria.

Kryengritja kundërosmane e vitit 1912

Nga: **MOISI MURRA**

Vitit 1911 qe një këmbanë e fuqishme që sinjalizonte perendimin e Perandorisë osmane nga Shqipëria. Këta sinjale zgjuanë ndjenja aneksioniste të vendeve ballkanike, fqinje me Shqipërinë, të cilat po përgatiteshin për krijimin e aleancave në dëm të territoreve shqiptare. Kështu më 13 mars 1912 u nënshkrua traktati i miqësisë dhe i aleancës ndërmjet Serbisë e Bullgarisë. Ajo përmbante një shtojcë të fshehtë sipas së cilës Bullgaria i njihte Serbisë të drejtën mbi teritorin në veri dhe në perendim të Bjeshkëve të Sharit, kurse Serbia i njihte Bullgarisë të drejtat mbi teritorin në lindje të Rodopit dhe të lumit Struma. Teritori midis Bjeshkëve të Sharit, lumit Struma dhe liqenittë ohrit me qytetet kryesore Dibër, Kërçovë, Gostivar, Tetovë Kumanovë dhe Shkup u konsideruan si zona të diskutueshme dhe si arbitër për zgjidhjen e kësaj çështje u caktua cari i Rusisë.Më 29 maj u nënshkrua dhe Traktati greko-bullgar dhe në korrik Mali i Zi e Bullgaria përfunduan një marrëveshje verbale. Më 12 janar 1912 ndërmjet Ismail Qemalit dhe Hasan Prishtinës, u vendos të mbahej një takim nga një grupi personalitetesh të jetës politike shqiptare. Takimi u bë në mesin e muajit janar, nën kryesinë e Ismail Qemalit, në shtëpinë e Syrja Vlorës, në lagjen Taksim të Stambollit. Në të morën pjesë, përveç Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës e Syrja Vlorës, edhe Myfid Libohova, Esat Toptani, Aziz Vrioni, Bedri Pejani, Mustafa Kruja e të tjerë. Mbledhja e Taksimit ripohoi përfundimin se shqiptarëve, për të siguruar të drejtat kombëtare e politike, nuk u kishte mbetur rrugë tjetër përveç organizimit të një kryengritjeje të përgjithshme. Nga ana tjetër turqit osman, po bënin përpjekje periodike për të mbajtur nën ombrellën e gjysëm hënës të katër vilajetet shqiptare. Të gjëndur përballë sulmeve të forta të partisë "Liri e Marveshje", në opozitë, që kishte dhe përkrahjen e kombësive të tjera, kabineti i turqëve të ri, me shpresë e bindje se po të hynin në zgjedhje do të fitonin dhe do të siguronin shumicën absolute në parlamentin e ri, më 18 janar 1912 shpallën shpërndarjen e parlamenti. Me qëllim që të siguronte epërsi në fazën e parë të zgjedhjeve parlamentare dhe më tej të merrnin në duarë tërë situatën, Porta e Lartë urdhëroi Ministrin Punëve të Brendshme, Haxhi Adil beu, ish kryetar i Komitetit 'Itihad ve Terakki" (Bashkim e Përparim), të vinte në Shqipëri, gjoja "për të vue në zbatimme disa reformat të deklarueme në favor Shqipnisë". Por në të vërtetë ishte sigurimi i zgjedhjeve në favor të partisë "Itihad ve Terakk" Haxhi Adil beu vinte në Dibër me tri kërkesat në xhep, që kishin i dërguar dibranët Portës së Lartë, më 12 janar 1912. Konsulli austrohungarez në Manastir Halla, i raportonte Ministrit të Jashtëm Erental, më 5 shkurt 1912 për një tubim që ishte mbajtur në Dibër më 20 janar 1912 se në Sanxhakun e Dibrës, shqiptarët e Dibrës kërkonin nga qeveria t'iu njihte po ato të drejta, të ciët iua kishin njohur dikur malësorve si: kthimin e armëve që iua kishin marrë gjatë çarmatosjes së popullësisë, zvogëlimin e tatimeve, veçanrisht xhelepin dhe kryerjen e shërbimit ushtarak në pjesën evropiane të Turqisë. Më 11 shkurt1912 Haxhi Adil beu kishte arritu në Shkup dhe pasi përshkoi në 17 qytete, aty nga ditë e para të muajt pritej të stacionohej dhe në Dibër. Por ndër kohë në Dibër nuk ka qetësi. Në 26 e 27 mars 1912 në Dibër të Poshtme, nën kryesinë e Elez Isufit e Selman Alisë kishin shpërthyer konflikte të armatosura ndërmjet dibranëve që mbështesnin kandidatit për deputet Basri bej Dukagjinin*) dhe ushtrisë turke. Sipas parashikimit të të turqëve të ri Basri beu e kishte të sigurt zgjedhjen e tij në parlamentin e ri turk. Për këtë zgjedhjet në Dibër ishin shtyrë tri herë deri në ardhjen e Ministrit të Brendshëm turk, Haxhi Adil beut.**) Ai qëndroi pesë ditë më Dibër. Në një fjalim që mbajti ato ditë iu deklaroi dibranëve se kishte ardhur në Dibër për të parë si jetonte popull, në ç'gjendje ishin rrugët, si punonin gjykata, si mund të zhvillohej tregtia dhe zejtaria. Dhe në fund bëri premtimin rutinë siç bëhet në fushatat elektorale se Dibra brenda një viti do të lidhet me hekurudhë me Manastirin dhe më vonë dhe me Shkupin.Haxhi Adil beu duke mbajtur në njërën dorë kërbaçin dhe në tjetrën kulaçin arriti t'i maniplonte zgjedhjet në Dibër duke nxjerr fitues kandidatin e partisë tij një farë Shefqet bej Fishta. Pas kësaj Basri beu e ndjente veten të pa sigurt. Dibranët e morën nën mbrojtje dhe e strehuan në Malësi. Qëndrimi i autriteteve civile e ushtarake osmanë në Dibër me rastin e zgjedhjeve shkaktoi pakënaqësi, protesta dhe qendresë të shqiptarëve. Pas kërkesave të cilat iu drejtuan Ministrit të Brendshëm, Hxhi Adil Beut, me rastin e qëndrimit të tij në Dibër, filloi dhe konflikti i armatosur në mes shqiptarëve dhe ushtrisë turke. Gazeta bullgare "Pravo", që dilte në Selanik shkruante se rreth ditës së Shëngjergjit, 6 maj 1912, malësorët, nën udhëheqjen e Mersim Dmës, ishin hedhur në kryengritje dhe si shkak kishin shërbyer ngjarjet që lidheshin me zgjedhjet. Kjo mund të ketë qënë një shkak. Edhe Ministri i Jashtëm turk, Asim Beu, disa ditë më vonë, do të pranonte para ambasadorit austro-hungarez në Stamboll se "shkaku i kryengritjes në Shqipëri janë gabimet e bëra në zgjedhjet". E verteta është se dibranët e kishn bërë të qartë qendrimin e tyre në kërkesat që i kishin dërguar Portës së Lartë. Me që Porta e Lartë vazhdonte si gjithnjë t'i hidhte pas krahëve kerkesat e shqiptarëve, Mersim Dema i Homeshit dhe Sheh Sula i Zerqanit ditët e para të majit 1912, thirrën "Kuvendin e Dheut" në vendin e quajtur Gropat e Ukut ""një vend i rrethuem n'katër anët me male" me pjesëmarrjen e 5000 malësorëve nga Gryka e Vogël, Luznia, Gryka e Madhe dhe Bulqiza. Kuvendi i Dheut i kaloi caqet e Dibrës. Nga Vlora erdhën përfaqësues e Labërisë, Braho Kanina e Çeço Gjera. Për lebrit ky kuvend qe i çuditshëm, një kuvend me plora e parmenda. Mersim Dema e Sheh Sula i Zerqanit i kishin marrë të gjitha masat për mbarëvajtjen e kuvendit. Ata kishin organizuar çeta me malësorët e Grykës së Vogël, në krye të të cilave kishin vënë Xhemal Camin, Sali Metën, Jashar Zenelin, Mane Lleshin, Shahin Dacin e Çup Dukën. Këta çeta kishin zënë qafat që kontrollonin të gjtha rrugët që të çonin në Gropa të Uku. Kuvendi zgjati 22 ditë. Aty u diskutua dhe u miratuan një sëri kërkesash që në atë kohë u quajtën "Vendimet e Kuvendit të Dheut". Këta ishin: njohja e të drejtave kombëtare shqiptarëve sipas premtimeve të bëra para shpalljes së Kushtetutës Osmane, 24 korrik 1908, të mos paguanin taksa e të dhjeta Turqisë, në shenjë proteste të mos punonin tokën për tre vjet, të sulmoheshin dhe të largoheshin nga malësia patrullat që ishin sjellur që në kohën e Turgut Pashës, të sulmohej e të çlirohej qyteti i Dibrës së Madhe, me qëllim që të bëhej qendër e koordinimit dhe e veprimit kundër Turqisë, zgjodhi përfaqësues për në Kuvendin e Junikut. Vendimet e Kuvendit të Dheut u publikuan rreth 7 a 8 majit 1912. Ata ishin në sinkron me kërkesat politike që do t'i paraqiteshin Haxhi Adil beut disa ditë më vonë nga 10 përfaqësues të Dibrës së Epërme, Dibrës së Poshtme dhe Matit. Autoritet civile e ushtarake turke në Dibër të Madhe, pasi u informuan rreth vendimeve të Kuvendit të Dheut, dërguan një grup oficerësh, në Gropa të Ukut, për t'iu kërkuar malësorëve që të hiqnin dorë nga kërkesat që kishin formuluar dhe bërë publike. Mersim Dema flakë për flakë iu shte përgjgjur; "Na kërkojmë që asqeri i Turqisë të shkoi për nga ka ardhë e t'i dhe heqi karakollet dhe s'kemi me mbjellë nji kokërr përderisa qeveria të na lajë rehat me jetue simbas zakonit t' pleqëve se na nuk jem turq, por shqiptarë. Natën malësorët grupe-grupe ndizni zjarre për tu treguar autoriteteve osmane në qytetin e Dibrës së Madhe, që është ballëpërballë me Gropat e Ukut se malësorët kryengritës kanë dalë në male dhe si qëmoti, janë të organizua dhe të betuar për të fituar dhe gëzuar liritë dhe zakonet e trashiguar nga të paët. Gjatë ditës malësorët këndonin këngë atdhetare. Sipas një pjesëmarrësi në "kuvendin e Dheut", Mersim Dema ulej me malësorët dhe bisedonte për punët e Shqipërisë. "Gjithë sa jemi këtu, - u fliste Mersim Dema malësorëve të mbledhur në Gropa të uku, - kemi lidhur besën se do të luftojmë gjerë në vdekje për me e çliruar këtë tokë nga sundimit anodollak. Unë u çova fjalë që në shenjë kundërshtimi, të mbledhim të gjithë ploret e parmendat dhe grumbullohemi këtu. Ta marrë vesh turku se na nuk do t'i lamë të qetë në arat tona, tokën do ta lamë djerr, pa mbjellë sanjë kokërr bereqet, deri sa të çlirohemi nga shtypja e turkut. Po qe se turqit nuk do ta marrin vesh kundërshtimin tonë e nuk do të hiqen nga mallet tonadhe e gjithë Shqipria, na do të rrokim armët dhe do të sulemi kundër pushtuesit. Plorët do t'i lëmë, në Gropa të Ukut deri në fitoren përfundimtar. " Duke parë këmbënguljen e malësorëv për të mos lëshuar pe, turqit dërguan përsëri një përfaqësi oficerësh madhor për të hyrë në bisedime me Mersim Demën. Ata i thanë: "More Mersim Dema, nuk e ke mirë këtë punë, mos i dilni kundër Baba Dovletit, ne jemi vllazën, jemi mysliman dhe duhet të rrimë të bashkuem, përndryshe ka me ardhë kaurri me na sundue." Mersim Dema, Sheh Sula i Zerqani, Osman Karaj i Bulqizës iu kthyen përgjigje oficerëve turq se ne jemi betuar dhe nuk heqim dorë nga kërkesat tona. Ndërkohë malësorët të paisur me cfurqe në duarë e me parmenda në krah kalonin grupe-grupe përpara oficerëve turq duke thirrur: "Nuk duem me na sundue qeveria e Shehrit! Të hiqen karakollet prej maleve tona! Duem me pas kanunet e të parëve tanë!" Malësorët për t'iu treguar oficerëve turq se ishin një forcë e madhe, hynin në një pyll, pastaj dilnin e hynin në pyllin tjetër të radhitur ndryshe e një herë me qylaf e një herë pa të. Turqit hapnin sytë e habiteshin se si nuk mbaronin këta katundar dhe kur u ngritën me ik, thanë dhe një herë: "Nuk e keni kap mirë, mor katundarë, mos i kundërshtonin Baba Dovletit se do të baheni pishman." Pas katër pesë ditësh, qeveritarë turq në Dibër të Madhe e tërhoqën ushtrinë nga Nandë Malet, por lanë zaptiet në disa karakolle. Mersim Dema, në krye të një grup malësorësh zbriti nga Gropat e Ukut në katundin Homesh dhe aty arriti t'i bindi disa nga oficerët turq që të largoheshin nga malësia. Nga ana tjetër. Çetat e komanduara nga Çup Duka, Xhemal Cami, Sali Meta, Jashar Zeneli, Mane Lleshi e Shahin Daci sulmuan karakollet turke që kishin ngritur turqit që në 1910 me urdhërin e Turgut Pashës, çarmatosen një patrull turke, sulmuan dhe dogjën stacionin e xhandarmërisë në Homesh dhe dogjën gjithë mjediset që kishin ngritur turqit në pazarin e Homeshit. Sipas Xheladin Manjanit, pjesëmarrës në këta ngjarje, "Ushtria turke, mbas kësaj dite, nuk shkeli ma në malet tona". Në të vërtetë në qershor të vitit 1912 turqit provuan dhe një herë të vendosnin autoritetin e tyre në Malësinë e Grykës së Vogël. Vendimet e "Kuvendit të Dheut" gjeten mbështetje e u pranuan dhe nga krerët e kryengritësve të visëve të tjera të Shqipërisë. Më 11 maj 1912 midis përfaqësuesve të Dibrës dhe krerëve kryengritës të Mirditës, Kthellës, Malësisë së Lezhës, bajrakut të Kurbinit dhe të bregut të Mates, u lidhë besa për të nxjerrë turqit nga krahinat e tyre. Me të drejt Haki Stërmilli ka shkruar se Kuvendi i Dheut qe lëvizja gatitëse e kryengritjes së përgjithshme që plasi ma vonë parë politike që përgatiti kryengritjen e përgjithshme kundër osma në Dibër, që do të shpërthente dy muaj më vonë. Ai shënoi një faqe të re në historinë e Maleve të Dibrës, një demonstrim i paparë mençurie e force, që kulmoi me përzënjen e Turqisë nga Malësia e Grykës së vogël tre muaj se Turqia të pranonte kerkesat e kryengritësve shqiptarë. Ndërkohë, përfaqësues nga viset shqiptare ishin nisur drejt junikut, ku pritej të mbahej një kuvend me përmasa kombëtare. Drejt Junikut ishin nisur dhe Mersim Dema e Sheh Sula i Zerqanit, të shoqëruar nga malësor të armatosur nga katundet e Grykës së Vogël dhe të Grykës së Madhe. Me ta drejt Junikut historik udhëtonin dhe përfaqësuesit e Toskërisë, Braho Kania e Çeço Gjera. Kuvendi i Junkut (21-25 maj 1912) u lidh besa dhe u vendos të ndërmerrej një kryengritje e përgjithshme kundër sundimit të huaj. Krerët autonomistë, në kundërshtim me parinë turkomane të Kuvendit, shpallën këtu programin politik të kryengritjes, i cili u miratua nga Kuvendi dhe iu dorëzua qeverisë së Stambollit. Më 26 maj 1912 Juniku u gëdhi i qetë. Delegatët bashkë me çetat kryengritëse kishin marrë udhën e kthimit për në viset e tyre, me një shpresë, me një dëshirë, me një urim: "U pafshim në shqipërinë e lirë!

(Vijon numrin e ardhshëm)

Konsulli austrohungarez në Manastir Halla, i raportonte Ministrit të Jashtëm Erental, më 5 shkurt 1912 për një tubim që ishte mbajtur në Dibër më 20 janar 1912 se në Sanxhakun e Dibrës, shqiptarët e Dibrës kërkonin nga qeveria t'iu njihte po ato të drejta, të ciët iua kishin njohur dikur malësorve si: kthimin e armëve që iua kishin marrë gjatë çarmatosjes së popullësisë, zvogëlimin e tatimeve, veçanrisht xhelepin dhe kryerjen e shërbimit ushtarak në pjesën evropiane të Turqisë.

Natën malësorët grupe-grupe ndizni zjarre për tu treguar autoriteteve osmane në qytetin e Dibrës së Madhe, që është ballëpërballë me Gropat e Ukut se malësorët kryengritës kanë dalë në male dhe si qëmoti, janë të organizua dhe të betuar për të fituar dhe gëzuar liritë dhe zakonet e trashiguar nga të paët. Gjatë ditës malësorët këndonin këngë atdhetare.

*) Basri beg Dukagjini pretendonte se ishte shqiptar nga fisi i njohur i Dukagjinëve, Pal e Lek Dukagjini. Por në të vërtetë qe një mysliman bullgar, që u vu në shërbim të këtyre të fundit. Në parlamentin e parë të turqëve të ri ishte deputet i Dibrës. Më 11 janar 1916 komanda bullgare në Shehër e solli në Dibër Hasan Basriun dhe në një mbledhje që u organizua me pjesëmarrjen dhe të parfaqësuesve të komandave gjermane, austrohungareze dhe bullgare doli një "qeveri" që me Hasan Bastriun Kryeministër dhe ministër të punëve të jashtme, Elez Isufin ministër të brendshm dhe Bajram Currin lufte. Më 17 prill 1916 arrestohet nga austriakët në Shkodër dhe internohet ne Bohemi ku mbahet i arrestuar në kështjellat Jozefshtad dhe Koniggatz. Lirohet në 1919 dhe po këtë vit ikën në Paris. Ka shkruar një sëri veprash.

**) Sipas një dokumenti Haxhi Adil beu erdhi në Dibër më 7 maj 1912.

shënime

Një jetë në shërbim të vegjëlisë

Nga: **IBRAHIM EGRIU**

Xheladin Strazimiri, lindi më 1845, në fshatin Pocest të Peshkopisë dhe ndërroi jetë , më 1925. Me profesion bujk dhe i ka takuar shtresës së vegjëlisë; këshilltar dhe delegat në kuvendet e Nëntë Maleve të Dibrës, mendjemprehtë, fjalëzjarrtë dhe patriot i shquar shqiptar.

I brumosur me ndjenjën e humanizmit patriotik, me urtësi e fisnikëri, jetoi dhe veproi në periudhat më të errëta të intrigave, dallavereve, të shfrytëzimit e të eksploatimit të popullit tonë nga ana e anadollakëve dhe të veglave të të tyre, marioneta të pushtetit osman.

Tërë jetën, duke sakrifikuar moralisht e materialisht, Xheladini veproi për një të ardhme më të ndritur e të pavarur të popullit tëpopullit shqiptar.Ky burrë sypatrembur, kurrë s'i përfillte ligjet e osmanlinjve dhe asnjëherë s'u pajtua me krerët shqiptarë servilë e kapadahi, pavarësisht se i mungonte Sofra. Emri i Xheladin Strazimirit jehoi anë e këndKrahinës së Dibrës, veçanërisht tek shtresat e ulta të vegjëlisë. Andaj, duke depërtuar thellë në shpirtin e vegjëlisë, atij i besuan tre poste:

1.-Këshilltar për zgjedhjen e të drejtave të popullit të Maqellarës me rrethinë.

2.-Anëtar në Këshillin e Organizatës së Abetares.

3.-Delegat në Kuvendin e Nëntë Maleve të Dibrës.

Sipas të dhënave të pleqve, në Kuvendin e Nëntë Maleve, që u mbajt në Maqellarë, fjala e tij përshëndetej e përqafohej nga të gjithë të pranishmit. Në Kuvend janë parashtruar çështje mjaft të rëndësishme, siç janë: -marrja e të rinjve shqiptarë ushtarë në ushtrinë turke, pagesa e taksave dhe e tatimeve dhe hapja e shkollave në gjuhën tonë.

Siç dihet, në atë kohë, vëllavrasja si plagë e kahmotshme, ka ekzistuar edhe në Krahinën e Dibrës së Madhe. Kjo veti e ka shqetësuar pa masë këtë plak mentar, i cili ishte i lidhur ngushtë me popullin, si thoji me mishin, veçanërisht me shtresat e varfëra, të cilët nuk kanë gëzuar kurrfarë të drejtash morale e materiale, jetësore e ligjore. Ai. me plot vigjilencë, fleksibilitet e matutri,diti si ta mbështesë e ta marrë në mbrojtje vegjëlinë nga kurthet e intrigat e osmanlinjve e të bajraktarëve të ndryshëm.Siç bëjnë të ditur disa pleq të moshuar, derisa Paria e atëhershme përdorte hurin e zjarrit në popull, Xheladin Strazimiri, me ibrik uji përpiqej të shuante çdo konflikt e të pajtonte sa më shumë gjaqe, ashtu siç veproi në vitet e'90-ta në Kosovë, Anton Çeta.Si shembull konkret, rrëfejnë dëshmitarët për dy vëllezërit: -Haxhi dhe Ramadan Burnazi, të cilët për nevojat familjare shkojnë në Dibër të Madhe tek Maliq Begu dhe huazojnë një sasi të hollash me kamatë (interes) për një kohë të caktuar. Mirëpo, me plotësimin e afatit, të dy vëllezërit s'ishin në gjendje që ta paguajnë borxhin gjatë asaj periudhe, atëherë, Maliq Begu shkon në fshatin Pocest që t'ua konfiskojë pasurinë e tundshme me përdhunim vëllezërve -Burnazi. Mirëpo, kur Begu në fjalë e përfundon konfiskimin në tërësi, mandej e nis karvanin me sende t e konfiskuara në drejtim të Dibrës; në ato çaste, vetëtimthi, me armë në dorë, del në pritë plaku gojëmbël dhe mendjemprehtë, Xheladin Strazimiri me disa fshatarë të tjerë trima, ndaloi karvanin, duke iu drejtuar Maliq Begut me këto fjalë: "Deri sa të kemi frymën e fundit, kurrë s'do lejojmë të kryhet konfiskimi i djersës së fshatarëve, por sa më parë të kthehet karvani me bagëti, se për ndryshe do të bëhet gjaku deri në gjunj".Maliq Begu, me të vërejtur vendosmërinë dhe këmbëngulësinë e trimit Xheladin me shokë, ai dorëzohet pa kushte. duke mbetur duarthatë si Ali Çiçja me lëkurat, pa kamatë, pa para e pa plaçka të konfiskuara. Raste dhe shembuj të tillë kanë ndodhur edhe me bejlerët e Maqellarës, të cilët poashtu u jepnin fshatarëve fukarenjë para me fajde (me kamatë). Këto forma të aplikuara nga beglerët e Dibrës së Madhe e të Maqellarës, vendosmërisht i kundërshtuan këshilltarët e Zonës së parë nga Xheladin Strazimiri, i cili me elikuencën dhe oratorinë e fortë që ia kish falë natyra, gjatë debateve me bajraktarë të ndryshëm, fajësonte beglerët për dhënien e të hollave me fajde (me interes) fshatarëve të varfër, të cilët s'dispunonin pasuri të tundshme, por çdonjëri prej tyre ka pasur nga një bisht dhie apo deleje, lope apo kali.



Tërë jetën, duke sakrifikuar moralisht e materialisht, Xheladini veproi për një të ardhme më të ndritur e të pavarur të popullit tëpopullit shqiptar.Ky burrë sypatrembur, kurrë s'i përfillte ligjet e osmanlinjve dhe asnjëherë s'u pajtua me krerët shqiptarë servilë e kapadahi, pavarësisht se i mungonte Sofra. Emri i Xheladin Strazimirit jehoi anë e këndKrahinës së Dibrës, veçanërisht tek shtresat e ulta të vegjëlisë.

Ai, i sugjeronte bejlerët që të dinë se kujt t'ia japin paratë me interes (kamatë). Gjatë sundimit të Austrisë në Shqipëri, bejlerët e Maqellarës së bashkume një oficer austriak, shkojnë në fshatin Pocest për të grabitur ujin e burimit "Cercec". Me atë rast, me të marrë të dhënat për një veprim të tillë, këshilltari Xheladin, menjëherë mobilizoi fshatarët:burra e gra, pleq e të rinj, me armë në dorë e zhbllokuan burimin. Kështu që nga ajo forcë e madhe mobilizuese e masës, pushtetmbajtësit në fjalë, kthyen me turp nga patën ardhur.

Po të njëjtët bejlerë, kryen edhe një veprim tjetër të shëmtuar tek popullata e Zonës së Maqellarës me rrethinë. Ata, pa pëlqimin e masës vendosën që nga 4 – 5 veta nga çdo fshat t'ua dorëzonin autoriteteve austriake, të cilët do t'i dërgonin të kryenin punë tepër të vështira, diku larg në Serbi. Në listën e fshatarëve, që duhej të shkonin ishte edhe Ragip Gjoni, babai i Osmanit e të tjerë. Mirëpo, pasi informohet Xheladini për një aksion të tillë, ai, si këshilltar pengoi dërgimin e fshatarëve në Serbi.

Siç rrëfeu kryeplaku i zgjuar, Aqif Rustem Spahia dhe shumë pleq të tjerë, bëjnë të ditur se nëpër konaqe dhe oda burrash, flitet dhe sot e kësaj dite me respekt e krenari për plakun e zgjuar, trim e fjalëzjarrtë, Xheladin Strazimirin, i cili, jo vetëm që i dha emër fisit Strazimiri, por emri i tij përmendet anë e kand Shqipërisë e Kosovës.Në vitet e pas luftës, pleqtë e Maqellarës e të Pocestit, parashtruan kërkesën tek përgjegjësi i Muzeumit të Maqellarës -Tosum Xhemili, që kooperativa e Maqellarës të pagëzohet me emrin e Xheladin Strazimirit, mirëpo kërkesat e tyre s'u përfillën përshkak të birit të tij -Qamilit, i cili paskësh qenë oficer i mbretit-Zog.

Mbesim me shpresë se në të ardhmen, popullata e asaj treve, do t'ia jep vendin e merituar edhe këtij trimi-humanisti të vegjëlisë.

Malme – Suedi, qershor 2012

Histori

Kontributi i Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit është i pamohueshëm

(Vijon nga faqja 15)

Në këtë kuvend u morr vendim për t'i kërkuar Portës së Lartë njohjen e Shqipërisë si vilajet autonom dhe ruajtjen e tërësisë territoriale nga lakmitë shoviniste fqinje. Për shkak të shpirtit atdhetar dibran dhe kërkesave autonomiste dibrane, në nëntor 1880, selia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kalon në Dibër, dhe Dibra për nga aktivitetet dhe veprimtaria që zhvillonte, ishte si kryeqytet i Shqipërisë, me kërkesë autonomi të plotë të Shqipërisë deri në Vidin, me Manastirin e Ohrin. Siç raportonte konsulli britanik Blanti nga Selaniku, në Dibër u vendos të dërgohet një fuqi ushtarësh vullnetarë për mbrojtjen e Ulqinit dhe të viseve jugore të Shqipërisë. Por Porta e Lartë dërgoi gjeneralin famëkeq Dervish Pashën që e shkatërroi LSHP. Dibra deri në tetor 1881 mbeti e fundit e pa u nënshtruar, derisa Dervish pasha me dinakëri preu në besë dhe arrestoi përfaqësuesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u mori deklarata se njohin sulltanin dhe pushtetin turk, që shënoi edhe fundin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Sipas dokumenteve arkivore osmane, ruse, serbe, angleze e frenge, kontributi i Dibrës dhe dibranëve në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit ka qenë i pranishëm dhe përcaktues. Ngulmi që Prizreni, Manastiri, Ohri të bëhen kryeqytete, mbështetej në faktin se, asokohe këtu shihej rreziku i shkëputjes së trojeve, sepse po të ishte ndryshe, kufiri i sotëm politik do të kishte trajta tjera nga ato që ka.

Ndalimi i gjakmarrjeve në Dibër në vitin 1878, është jë apel që u bëhet shqiptareve dhe klasës politike në dy anët e kufirit , se për interesat madhore të kombit, duhet ngritur mbi interesat partiake".

Dritan Murrja, studiues nga Dibra e Vogël - Peshkopia, në temën e tij "Përpjekjet e atdhetarëve dibranë për arsimin dhe kulturën gjatë dhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", tha se:"Patriotët dibranë ndoqën tezën racionaliste se pa emancipim arsimor e kulturor, nuk mund të ketë emancipim politik. Në këtë drejtim në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20 ndjenjat kombëtare kishin marrë përmasa të fuqishme, që pasqyrohej me përhapjen e abetareve shqipe dhe me hapjen e shkollave shqipe që nga Kristoforidhi, Josif Bageri, Said Najdeni, Dervish Hima e Hamdi Ohri. Në Kuvendin e Dibrës në mars 1899, ndër kërkesat kryesore ishte edhe lëvrimi i gjuhës shqipe, çelja e shkollave shqipe dhe financimi i tyre. Këtu rol me rëndësi luajti edhe Klubi "Bashkimi" në Dibër nën kujdesin e Hafiz Sherif Langut, Kadri Fishtës, Riza Rusit e patriotëve tjerë. Ky klub thotë Stërmilli "Rrënjosi idenë me mësue gjuhën kombëtare e cila për popullin dibran ishte tapia e vendit". Edhe në Kuvendin e Dibrës në korrik të vitit 1909, thuhej, "Asnjë popull nuk mund të mësojë për nevojat e jetës së tij në një gjuhë tjetër" dhe se "gjuha shqipe krahasohej me burime pa të cilat thaheshin ara e kopshtije". Dibranët në hapjen e shkollave shqipe përveç kundër turqve, rezistuan edhe kundër sllavëve dhe grekëve. Dibranët paraqisnin kërcënonin autoritetet turke se, "nëse Porta e Lartë nuk hapën mejtepe shqipe, atëherë Drini i vjetër do të marë ngjyrë tjetër". Kjo pozitë e përparuar e Dibrës në fushën e arsimit kombëtar spjegohet me patriotizmin e dibranëve dhe me dëshirën e madhe për gjuhën shqipe, me nevojën për tu bërë ballë presioneve asimiluese të shteteve fqinje, dhe se në saje të pozitës malore dhe qëndresës së vazhdueshme, Krahina e Dibrës nuk kishte qenë aqë e nënshtruar nga pushtuesi osman siç ishin krahinat e tjera", tha në fund Dritan Murrja.

Tani që Kosova e ka edhe shtetin dhe pavarësinë e saj, duhet krijuar kushte dhe mundësi për të thelluar e forcuar këto lidhje mes Dibrës e Kosovës, duke mos harruar bëmat e lavdishme historike të paraardhësve tanë, por përkundrazi të hedhim më shumë dritë ndaj këtyre ngjarjeve dhe figurave që sakrifikuan dhe dhanë konributin e tyre mbarëkombëtar në trasimin e rrugës për themelimin e shtetit shqiptar. Organizatorët e përvjetorëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk duhet ta harrojnë Dibrën, Iljaz Pashë Qokun kryetarin e saj nga Dibra dhe bashkëpunëtorët e tij. Organizatorët e përvjetorëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhet t'i ftojnë edhe historianët nga zona e Dibrës për të dëgjuar edhe studimet dhe mendimet e tyre në të mirë të fakteve historike.

/ R.Torte

Migjeni i letrave shqipe me origjinë dibrane



Gjyshja



Gjyshi



Nëna



Babai

NJË VËZHGIM

Është shkruar për Migjenin, emri i tij është në shumë institucione kulturore, artistike, emrin e tij e mbajnë disa shkolla e rrugë në gjithë Shqipërinë, në Kosovë e Maqedoni dhe vetëm në Peshkopi, ende asnjë shkollë as rrugë nuk ka emrin e Millosh Gjergj Nikollës, por as dhe të Nikolla Dibranit.

Për Migjenin është shkruar shumë, por edhe pse krijimtaria e tij nuk është njohur përsëri të duket se është shkruar pak për këtë ... të letrave shqipe, me origjinë nga Dibra, por për herë nëpër vite është diskutuar dhe vënë në dyshim origjina e tij dibrane, e ka patur dhe dashakeqës që ta quajnë me origjinë sllave.

Në enciklopeditë, në internet dhe në mjaft vepra të shkruara për Migjenin është e padiskutueshme origjina shqiptare por edhe ajo dibrane nga gjyshi i tij Nikolla Dibrani.

Nikolla Dibrani – me origjinë nga fshatrat ordoksë të Rekës në Dibër, u shpërngul për në Shkodër, nga mesi i shekullit 19 si mjaft familje të tjera si Siliqi, Banushi, Kadiqi, Dibra etj. duke qenë murator punonte me çfarë vende dhe rasti e dha të njihej në Stankë Milanin, një shqipfolëse nga Kuçi në Mal të Zi. Po në Mal të Zi humbi jetën në vitet 1876 duke lënë dy fëmijë Gjergjin, ose siç e thërrisnin Gjoka, babai i Migjenit dhe Kriston të vogël. Për Gjergjin një burrë i ndershëm dhe në karakter ... i tij e çmonin dhe nderonin. Më 1922 ishte përfaqësues në kongresin krishter të Beratit.

Sipas shënimeve në librin e familjes, Gjergji u martua më 17 shtator 1900 me Sofi Anastas Kokoshi (15 tetor 1881 – 16 gusht 1916) një grua shumë e bukur dhe me kulturë. Gjergji ndërroi jetë më 21 mars 1924.


Gjergj Nikolla me bashkëshorten e tij Sofie, lindër gjashtë fëmijë. Dy djem Nikollën dhe Milloshin dhe katër vajza. Duke qenë prindër të shkolluar u munduan t'i shkollojnë dhe fëmijët e tyre. nga gjithë fëmijët vetëm Milloshi dhe motra e vogël Ollga shkuan në fëmijëri në shkollë serbisht.

Po të shikosh dëftesën e shkollës së Milloshit (Migjeni) në filloren në Shkodër pastaj në Tivar, por dhe në gjimnazin e Manastirit të vetmin vlerësim "mirë" ka gjuhën serbisht ndërsa në gjuhën greke, latinisht, frëngjisht e deri në rusisht ka vlerësime "shumë mirë".

Kur Milloshi vazhdonte shkollën në Manastir kishte shumë shokë të ngushtë si Jordan Misja, Mirko Nikolla, Zakarie Kodiqi, Papanastasin nga Pogradeci, Theofon Papa etj.

Në këtë shkollë është shkruar "shqiptar" dhe dinte shumë mirë shqip siç: thonin shokët "Siç di një shkodran i shkolluar".

Ndërsa po priste të vazhdonte studimet, inspektori i Arsimit Shkodër në shkresën nr. 59/15 datë 26 prill 1933 e emrave zv/kryemësues në shkollën "Skënderbeg" në Varkë ku jepte mësim në gjuhën serbe. Po këtë vit u shtetëzuan shkollat dh Migjeni u emërua të jepte mësim në gjuhën shqipe. Konsullata e Mbretërisë Jugosllave në Shkodër u përpoq që Migjenit t'i mbushte mendjen të shkonte në Jugosllavi për studime në Beograd ose të shërbente si prift në Bonat. Migjeni nuk pranoi dhe u shkruajt



Migjeni maturant. 1932.

emri i në "Librin e Zi" e po këtë vit dy muaj para maturës i prenë bursën të motrës Ollgës që studionte në Sarajevo.

PËR MIGJENIN DHE...

"Në Shkodër, ndër të rinjtë që shoqërohjeshin të entuziazmuar me Milloshin, përveç Jordan Misjes, të cilin e kishte pasur shok shkolle në Manastir, ishin edhe dy të tjerë: biri i konsullit Bazheviqit dhe Vojo Kushi... Një ditë i biri i konsullit erdhi fshehurazi në shtëpinë e Milloshit dhe i tha: "Babai më ka dhënë urdhër të mos shëtis e flas me ty, por unë të dua si vëlla. Më fal!". E kur piqeshin udhës ne në drejtim të kundërt, djaloshi serb e shikonte me bisht të syrit dhe ulte kryet i turpëruar. Mulloshi e shikonte dhe ky vinte buzën në gaz i mallëngjyer". ***Skënder Luarasi "Migjeni", vepra 1961.***

Shkrimtari Filp Nodcaj, në shënimet e tij për Migjenin që datojnë 5 korrik 1956, por flet për transferimin e tij në Dardhë të Pukës, e në takimet me Milloshin kujton: "... shëtisnim para shkollës, ishte mëngjes herët, dhe ai mes të tjera na tha: "Pse nuk shkruan". Në gazetën "Zëri i Popullit" 5 shkurt 1956 ditën e sjelljes së eshtrave të poetit nga Italia, në kujtimet e veta motra e Milloshit, Ollga Nikolla (Luarasi) shkruan: "Efekti i këtij operacioni ishte fatal, ju pre oreksi, humbi fuqinë dhe humorin e tij tërheqës. Besonte se po të transferohej në ndonjë sanatorium ... do të bëhej mirë. Mezi i siguruan një vend në "Ospedale Voldese" në Tore Peliçe, afër Torinos për ku e shoqëruam më 12 gusht. Mulloshit i pëlqeu por... u mbyll në vetvete dhe në një rezinjacion të çuditshëm priti çastin e ... natën e 25 gushtit 1938, ku u shuajt si në gjumë.

Në dy vjetorin e vdekjes së Migjenit do shkruante Kristaq Tutulani. "... nuk do bëj fjalë këtu për veprat e tij. Por dua të kujtoj ata, të cilëve u vjen dorësh më mirë se mua për këto punë, që Migjeni të mos harrohet...".

"Migjeni, poet i poemave që janë si kandidat ndritës të rrugës ku kalojmë nuk është më. ***Gjikë Kuqali 1940.***

Andre Stefi, në revistën "Nëntori" nr. 11, 1955 shkruan për Migjenin ... kur i përsërita urrejtjen mbi karakterin e errët të disa poezive të tija ai më tha: "Vjershat e qarta do t'i ndriçojnë të errëtat".

... Sot Migjeni ka me dhjetëra mijëra e miliona miq që ... veprën e tij, që e duan dhe e nderojnë edhe në Bashkimin Sovjetik, Kinë, Poloni, Çekosllovaki, Rumani, Bullgari etj.. ***Skënder Luarasi 26 gusht 1956.***

... Duke lexuar këtë vëllim, njëri zbulon një poet të tillë të mrekullueshëm si Millosh Gjergj Nikolla, gazeta "Z..." shkruan nga kritiku rus Sergej Luov për veprën e Migjenit përkthyer në rusisht nga D. Samolloi dhe R. Koçi.

"... unë kam qarë kur lexova Migjenin. Mua nuk më vjen turp të them se vetëm tani në moshën 43 vjeçare mund të njoh këtë poet të mrekullueshëm".

Nikollai Moraru, shkrimtar rumun, 1954.

Përgatiti: **ILMI DERVISHI**



Migjeni me motrat në Pukë.

homazh



Humbëm një gazetar dhe artist

Vitet e fundit, kur u shkëput nga puna në TVSH, Samiu filloi të merrej me një pasion të vjetër, fotografinë artistike. Jo vetëm përzgjidhte fotografi të bëra gjatë mbi tridhjetë vjetëve punë, por fotografonte me një teknikë të kohës motive të reja.

Samiu kishte me merak të madh arkivën e tij filmike. Ai thoshte se në arkivën e tij shumica e materialeve janë të panjohura për publikun, atje janë fiksuar ngjarje e jetë njerëzish, vetë një kohë ka gjurmët e saj me mjaft vlera për brezat e ardhshëm.Kishte në mendjen e tij, por dhe një dëshirë të madhe se do t'i sistemonte ato vlera filmike sipas tematikave të ndryshme.

Pak ditë më parë, nga një sëmundje e rëndë, u nda nga jeta një njeri ende në moshë të re, me mundësi të mëdha e të pashprehura në lëmin e gazetarisë, kulturës dhe artit.Vdiq Sami Selishta, një ikonë e gazetarisë televizine për Dibrën në veçanti, por edhe për mbarë vendin.

Pak kush e din se Samiu lindi në një lagje të vjetër të Tiranës, ku ishte vendosur familja Selishta e ardhur nga fshati Brezhdan i Dibrës. Babai i tij, Agush Selishta, në ato vite të pasçlirimit punonte si lulishtar në kryeqytet.Aq shumë binte në sy puna e mirë e Agushit si qëndistar i Tiranës me lule, sa , bëri ç'bëri, kryetari i komitetit ekzekutiv në atë kohë në Dibër, i nderuari Rexhep Doda, ia mbushi mendjen Agush Selishtës, por dhe ndërhyri atje "lart", që të vinte e të punonte për sistemimin me lulishte të qytetit të Peshkopisë. Dhe shumë shpejt në atë kohë qyteti i Peshkopisë, në saj të punës së Agush Selishtës, u kthye në një qylym i qëndisur me lulet më të bukura të bjeshkëve të Dibrës.

Në një mjedis të tillë ballafaqimi të përditshëm me punën për të bukurën u rrit dhe edukua djaloshi i ri çapkën e simpatik Sami Selishta. Që në atë kohë në zemrën e tij gufonte dëshira për estetikën, për artin dhe kulturën.Samiu dallohej në veprimtaritë e shumta kulturore në shkollë e shtëpinë e kulturës dhe nuk ishte rastësi që, ky gjimnazist i ri, përzgjidhet në një turne që Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore bëri në Republikën Popullore të Kinës.Mes valltarëve të tjerë, nga ata që fluturonte si zog mali, ishte dhe Sami Selishta.

Pasi mbaroi shkollën e lartë në Universitetin e Tiranës, ku e kishin caktuar, shkencat politike, Sami Selishta filloi punën si mësues në gjimnazin e Peshkopisë.Por, shumë shpejt, sapo iu dha mundësia, u shkëput nga mësimdhënia e dogmave filozofike dhe vuri në sup kameran televizive.Posht kameras, këtij syri magjik, rrihte zemra e një të riu plot energji, e një artisti të palodhur për të pasqyruar jetën në të gjitha përmasat e saj.

Puntor i palodhur, herë më këmbë, herë mbi makina të rënda pune "skoda", herë me kalë, Sami Selishta gjendej papritur atje ku kishte jetë.Një kronikë për mbjelljen e misrit me kubikë apo prashitjen e tij, për korrjen e thekrit në Fushë të Klenjës apo në Lanë Lurë.Ai ishte i kudondodhur, që nga nivelet e kromit mijëra metra në nëntokën e Bulqizës e deri mes barinjve në Fushën e Korabit e në malet e Selishtës.Nuk i shpëtonin Samiut detaje artistike nga mrekullitë e natyrës te liqenjtë e Lurës apo Liqenin e Zi në Balgjaj në kohë vere, ashtu siç pasqyronte ashpërsinë e dimrit me dëborën e acartë apo akujt mbi dy metra që vareshin si stalaktite strehëve të ndërmarrjes ushqimore.

Me pasion të madh filmonte takimet folklorike, shfaqjet e estradës apo teatrit, punën muzeale dhe arkeologjike.Që atëherë, kur nuk dihej për opinionin e gjerë se ka një rrugë të lashtë ku arbëreshët lëviznin nga Tirana në Dibër e Shkup, Sami Selishta bëri kronikat e para mbi punën e studiusit të talentuar Iljaz Kaca për Rrugën e Arbërit, ndriçoi para shqiptarëve vlerat e kësaj rruge që në lashtësi.Ishte një sensibilizim për Rrugën që në atë kohë.Sami Selishta ka qënë një mik i madh i Rrugës së Arbërit.

TVSH rrallë qëllonte pa kronika të Sami Selishtës nga Dibra apo Mati.Pas çdo kronike kishte mund, djersë, lodhje të madhe, sepse ashtu ishin kushtet e kohës, pa transport, rrugë dhe teknikë të zhvilluar informative siç ka sot.

Me buzëqeshjen në gojë, me papërtueshmërinë e tij të veçantë, me të mosprishurit qejf me njeri, Samiun e donin dhe e respektonin të gjithë.Këtë bredhës dhe rrugtar të përditshëm me kamera në krah e kishin shok dhe mik sidomos shoferët.Me ta ai lëvizte, me ta hante bukë e pinte ujë ku e zinte rruga, me ta shkonte cep më cep të vendit.Shoferët e autobuzëve Peshkopi-Tiranë, miqtë e veçantë të Samiut, Krafil Sturçe apo Hasan e Afrim Zollumi, Mexhit Mëziu apo Vale Rama e Rrahim Biçi e shumë të tjerë i merrnin kasetat filmike me kronikat televizive të Samiut dhe i çonin dorazi te dera e TVSH-së.Ata jo vetëm nuk përtonin, por e kishin për nder të ndihmonin mikun e tyre gazetar, që i filmonte në mes të suferinës me borë duke lidhur zinxhirët te gomat, atë zinxhirë hekuri që të ngjiteshin në dorë nga ngricat e ashpra të Qafë-Buallit.



Me hapjen e Shqipërisë në vitet 90-të u zgjerua edhe zemra e madhe e Sami Selishtës, u shtuan energjitë e tij për t'i dhënë përmasa të reja punës për kulturën kombëtare.Filloi një stad i ri pune për pasqyrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare në Dibrën e Madhe. Bashkë me gazetarin e TV të Shkupit në Maqedoni, atdhetarin Lutfi Turkeshi, u hulumtua rreth vlerave historike kombëtare të fshira dhe të harruara nga regjimet serbosllave dhe, i palodhuri Sami Selishta, gjeti rastin herë pas herë t'i shfaqë kronikat për Dibrën e Madhe si në TV të Shkupit (emisionet shqip), ashtu dhe në TVSH.

Vitet e fundit, kur u shkëput nga puna në TVSH, Samiu filloi të merrej me një pasion të vjetër, fotografinë artistike.Jo vetëm përzgjidhte fotografi të bëra gjatë mbi tridhjetë vjetëve punë, por fotografonte me një teknikë të kohës motive të reja. Një rast lumturiplotë erdhi për të kur ishte në Danimarkë me një grup kulturor nga Shqipëria.Grupi shqiptar, krahas shumë grupeve nga vende të tjera, ishte i ftuar nga pallati mbretëror danez.Samiu bëri shumë fotografi në ato ditë verë mjaft të gjata, ditë polare në këtë vend nordik.Sidomos perëndimi i diellit ishte mbresëlënës.Kur disku i portokalltë rrëzohej ngadalë pas kështjellave mbretërore nuk kishte se si të mos i kujtohej fotografit nga Shqipëria arti i Shekspirit.Mos vallë ajo kështjellë ishte e tragjedisë "Hamlet"?Dhe në konkursin që u zhvillua, një fotografi me Diell në Perëndim e Sami Selishtës, një perëndim i purpurtë, që fekste me rreze mbi kryqe dhe këmbanare, fitoi çmim të parë dhe u arshivua për tu përdorur si vlerë artistike nga pallati mbretëror i Danimarkës.

Puntor i palodhur, herë më këmbë, herë mbi makina të rënda pune "skoda", herë me kalë, Sami Selishta gjendej papritur atje ku kishte jetë. Një kronikë për mbjelljen e misrit me kubikë apo prashitjen e tij, për korrjen e thekrit në Fushë të Klenjës apo në Lanë Lurë.Ai ishte i kudondodhur, që nga nivelet e kromit mijëra metra në nëntokën e Bulqizës e deri mes barinjve në Fushën e Korabit e në malet e Selishtës.Nuk i shpëtonin Samiut detaje artistike nga mrekullitë e natyrës te liqenjtë e Lurës apo Liqenin e Zi në Balgjaj në kohë vere, ashtu siç pasqyronte ashpërsinë e dimrit me dëborën e acartë apo akujt mbi dy metra që vareshin si stalaktite strehëve të ndërmarrjes ushqimore.

Samiu kishte me merak të madh arkivën e tij filmike.Ai thoshte se në arkivën e tij shumica e materialeve janë të panjohura për publikun, atje janë fiksuar ngjarje e jetë njerëzish, vetë një kohë ka gjurmët e saj me mjaft vlera për brezat e ardhshëm. Kishte në mendjen e tij, por dhe një dëshirë të madhe se do t'i sistemonte ato vlera filmike sipas tematikave të ndryshme.

Familja e tij, mësuesja dhe drejtuesja e nderuar e arsimit Vera, djali Geni dhe vajza Bruna, do të dinë t'i nxjerrin në dritë vlerat e mëdha dokumentare dhe artistike të njeriut të tyre më të dashur Sami Selishta, ketij gazetari dhe artisti të shquar dibran.

Kamber FARUKU

Poemë e shkruar duke lotuar



Nga: **SELMAN MZIU**

Nuk dua të rrëshqas në prehërin e melankolikëve. Nuk dua të tretem si qiriu nga flaka e fitilit te pambuktë. Nuk dua të bie padashur në pelhurën e merimangës, kryemjeshtres së kurtheve. Nuk dua të çorientohem e të bie padashur në rrjeten e peshkatarit si troftat e lumit tim, Drinit. Nuk dua të shkruaj një poemë në vargje për lisin, per atdheun për nanën apo babain tim, për ndonjë hero a heroinë, që të rimojë, apo të ketë një metrikë të caktuar JO, JO ASPAK.

Dua që me pikat e lotëve që më rrokullisen nëpër faqe si ato të shiut në një rrebesh marramendës, të shkruaj pomën e dhimbjes së thellë, e cila më ka plagosur rëndë dhe pushtuar mijëra qeliza të trupit tim, dhe sëbashku me mua miliona njerëzve në çdo kilometër katëror të lëmshit të dheut. Por si është e mundur vallë? Çfarë është kjo dhimbje, kjo plagë e gjithë pushtetshme, e gjithë kohëshme e përbotshme?

QËRSHORI FATË KEQ

Lindi e shëndetshme, me faqet lule kuqe. Qau paksa, siç qanë çdo fëmijë kur del në dritëzën llamburitëse, JETË. Thuhet nga gëzimi i pamatshëm, gurgullues, ose nga dhimbja e gjithë kahshme. Nuk dihet! I buzëqeshi ëmbël, lumnueshëm, nanës së vetë, aty në dhomën e lindjes. Priti sa i erdhi qumështi asaj dhe e piu atë me plotë dëshire e shije. Ishte i pari takim me vazhdimësin e jetës. Kështu ka ndodhur, jo vetëm me Donikën por edhe me Jul Qezarin, me Kostandinin e Madh, me Pirron e Epirit, me Galileun, me Gjon Kastriotin me Donika Aranitin me Çuen Lain, Dai Lamen, Nënë Terezën e mijëra miliona e miliarda të tjerë.

***

Ishte një rilindje e dhimbshme e shoqërise shqiptare. Pas një lëngimi që zgjati pothuajse pesëdhjetë vjet. Shkatrruam, dogjëm, premë, vramë, njeriu humbi arsyen, hakmarrja doli nga arkivoli i shekujve. Në këtë betejë me vetëveten gjithëçka doli përsipër. E si pasojë….. Nëna qau për djalin, vajzën, mbesën apo nipin, ajo i bie kraharorit dhe nga thellësia e shpirtit të gjymtuar nga dhimbja vajton''Pse më shkove kaq i ri(e re) lofka e nanës, me thave shpertin lofka e nanës, me boshatise shpinë lofka e nanës……,, Kasaphana përgjatë e pas tragjedisë së vitit njëmijë e nandëqind e nantëdhjetë e shtate filloi të bëjë inventarin e ''therrorive,, të saja të kobshme.

***

Aty ku bahkohen dy përrenj, quhet Prrusë, ose Prusë. Nuk është sipërfaqe toksore e shtetit Prusian (Gjermania e sotme), nuk është qyeti i Prusës (Izmiri - Turqi) në Azinë e vogël. Është një kapërthymje legjendash e gjakderdhjesh, harqe urash, e ndodhish të lashta të fshehura në legjendat fatkeqësisht ende të pashkruara. Këtu Vokër Noka (varrosur në teqen e Dabiçe), mentar i madh, dhe burrë burri, degëzim i shtëpisë së lashtë të Algjoneve, çau kodrën me magjinë e tijë që të kalojë ujët në Vijën e Zallit në një natë me hanën plotë. Pranë qemerit të sajë sipër të cilit kalon uji, plumbi i hasmit në një natë të pabesë, shtriu përdhe bashkëmoshatarin tim Qamilin. Prusa e madhe dhe e Vogla ushtuan nga krismat frikëndjellëse të autoamtikut. Zërat vajtimtare të nënave u përplasën brigjeve të këtyre hapsirave të paana me stërkala lotësh e ankthe shkatërruese.

Këto bomba në mes të zhureve të Murrës, të përroit të Gjelagjoshit, të atijë të Banjos, e Deshatit, të Setës apo Veleshicës të Okshtunit apo të Bulqizës, dikush i kishte prumun këtej, ndokush i kishte mbjellur apo hedhur pa kujdes. Me dashje apo pa dashje, pak randësi ka. Të gjitha për të këputur në mes jetë fëmijësh apo të rriturish. Ato që muarën detet e malet, shpëtuan nga vetëvrasjet apo….. Populli që mbeti duke u qeverisur nga politikanët e rinj, harbutër, kokëshkretë, të pa ditur e pa përvojë, (kuptoi vetë se çfarë ishin) vetëvrau veten me armë të grabitur nga depot nën tokë e mbi tokë. Pa kurrëfarë shkaqesh, zëniesh, konfliktesh, megjithatë plumbat, bombat, dinamitërat, kapsollat, predhat e topave apo të mortajave shuan jetë fëmijësh dhe të rinjësh. Lotët e kujet e vajtimit ishin simfonitë e dhimbjeve të një populli të tanë që nga grykat e Cemit, në ato të Drinos, nga ato të Devollit e deri ne ato të Vjosës e më andej në Pavlla në skajin më jugor të Shqipërisë.

Ishte gjashtë Qërshori i vitit dymijë. Kështu Donika tetë vjeçe filloi të godas me gjur këte gja të panjoftshme prej sajë. Por sigurisht një diçka e çuditshme. Dhe s'vonoi shumë e ajo u zemrua. Ndjeu dhimbje. E prandaj, shprehu me egërsi urrejtjen. Shpërtheu, me coprat që i shperndau në të gjitha drejtimet. Të dya kamët filluan ti kullonin gjak. Humbi ndjenjat. E vetmuar. Naimi i Dalipit, dëgjoi ulurimat e dhimbshme: oh…oh dhe nihmë …nihmë, e pa, dhe bërtiti me një zë të dhimbshur e kumbues i cili ushtoi trishtueshëm në gjithë luginën e Murrës e të Drinit të zi. Babai i erdhi si veriu. I lidhi kamët për ti ndaluar rrjedhjen e vrullshme të gjakut. Dhe me të në shpinë vrapoi drejt….. Më së fundi arriti në spital. Dy javë, vuajtje me lotë e me këputje shpirti. Kthehet në gjirin e ngrohte familiar. Miqtë, komshijtë, farefisi e të afërmit e uruan në vizitat e tyre : Shyqyr që të shpëtoi cuca.

Ngjarje të tilla, nuk mund të numërohen. Vdekje të kësaj moshe në këto vite janë pa mbarim, po aq edhe gjymtimet, drama të vuajtjeve të pambarueme. Leonardi i Halitit, fëmijë dymbëdhjetë vjeçar i shkathët i pashëm e plotë energji humbi jetën. Festimi i Mudës humbi katër gishtërinj e dorës, prindërve dhe atijë vetë i është ngulitur në tru zhvillimi i kesaj ngjarejs trishtim ndjellëse. Basriu i Hidrit njomëzak, duke lozur me një bombë dore, u plagos rëndë dhe humbi shikimin në njërin sy. Një dhimbje që s'ka fund. Që të shkatërron shpirtin, të zgjat vuajtje të gjithëpërmasëshme. Çfarë fatkeqësie që sa herë e shikon të vret sytë, të ther mu në shpirt, të hidhëron pa pushue në gurgullimën e viteve. Një plagë që rrjedh pa pushim lotë e dhimbje makabre.

Misri i kishte kaluar të katër gishtrinjt. Ara ishte jeshiluar nga këto bimëza të shumta. Flladi i lehtë i Qërshorit, i përkdhelte dashamirësisht. Por ligjet biologjike dhe të prodhimit ishin të pamëshirshme. Kallzat e reja duhet ti nënshtroheshin përzgjedhjes. Sipas shëndetit, madhësisë, e pozicionit në mes njërit e tjetrit. Pra dikush duhesh të zhdukesh. Të shkëputesh nga toka që e kishte lindur. Kështuqë, Zamira, Fatimja, Donika, Teuta, Faimia, Minia, Ramia filluan me shatë duke prashit tokën e shkul të padobishmet. Nuk vonoi shumë dhe e treta, u këput dhe bie mbi qylymin e gjelbërt të arës së misrit njomështak.

Mezi i dilnin nga goja e bërë shkrumb, fjalët: Jam si e këputun s'kam fuqi. Dhe sakaq qepallat iu mbyllën. I leshuan ujë në ballin e djersitur e fytyrë. Sakaq u rizgjua. Vallë çfarë po ndodhte kështu? Pyetje që i mundoi këto me një heshtje gërryerse. Për momentin të gjithë u pushtuan nga ankthi, ndërsa frika iu meku zërin e iu pushtoi zemrat. Të nesërmen analizat e gjakut e të tjera vizita i detyruan mjekët dibran ta trasportonin me ambulancë në Spitalin ''Nëne Tereza,, të Tiranës.,, Filloi kurimi intensiv, me ilaqe e futje gjaku. Shtylla kurrizore nuk i prodhonte rruaza të kuqe. Sëmundja kishte një emër, që kush e degjonte i fuste tmerrin në gjithë orakullin e shpirtit.

PRANVERA E PERLOTUN

Filloi për Donikën një jetë për tu çuar përpara me gjakun e huazuar. Damarët i vrimëzoheshin sa herë që ajo duhesh të shtrihej në krevatin e spitalit. Nën këmbët e saja, duhej të vuanin njëkohesisht, babai, nëna ose i vëllai. Ajo duhesh të kryente dyluftimin me këtë sëmundje që të fashiste me ngadalë. Gjithëkush nga doktorët e quanin të pashërueshme. Ndërsa shpresa, ushqente shpritërat e tyre dhe mbante gjallë moralin. Njëlloi si bimëzat e misrirt të sapo prashitur, plehëruar e ujitur. Të cilët rrisnin shtatin, shtonin gjethëzat e zbukuroheshin çdo ditë. Sa mirë kështu!

Edhe ajo shërohesh disi, e udhëtonte drejt çerdhes së ngrohtë familiare. Gëzimi mbushte shtëpine. Ilaçet, shpnektat e berrave të ndryshme, frutat e perimet do të ishin lista e vazhdueshme e të ushqyerit. Varfëria kjo përbindësh shkatrrimtare e jetës së miliona njërëzve, papunësia në vendëlindje e kishte detyruar babain Shefkiun të ndiqte kurbetin e zi në Grqinë veriore. Quhesh Aziothanas, ndersa ndryshe QEGA etimologjikisht i shpejgueshëmne shqip. Plagë pas plage që therte e dhimbte pa pushue, duhesh të përballonte me burrni ky muhurrak.

Ecejaket ne spitalin "Nënë Tereza" të Tirranës ishin të shumta e kështu edhe analizat, konsultat mjeksore, e shpenzimet monetare. Nganjëher sjelljet e infermjereve, mungesa e gjakut, të bënin ta humbje durimin. Të ulurije, bërtisje për këtë sistem organizimi, plangëprishës. Moralisht shkaterroheshe e shpirtërish dërmoheshe duke humbur durimin e pësuar rënie shëndeti. Dhe ja pas një vitë e gjysëm që bukuroshja siç e thirrte doktoresha kosovare Adela, ndiqte kurën, mungonte gjaku. Dhanë motra, gratë e djemve të dajave Viadeta, Mirushe, Gjonsila e shumë te tjerë falas por.....

Në derën dhomës numur gjashtë, hynë një djalosh trupmadh. Ishte i pashëm e me fytyrë plotë gjallëri, dëgjoi me durim ngjarjen e treguar dhe..... Infermjeret e panë Rrahmanin e Xhelilit, kur ai si një lis viganë u shtri mbi tavolinën tek dhoma e tyre. Përveshi mangët e te dy kraheve dhe tha: Ja ku me keni, merrni gjak sa të doni. Nuk mund ta lemë vajzen tetëmbëdhjetë vjeçare të ... nuk mund ta shqiptoi këtë fjalë, se me këputet shpirti e më drithërohet i gjithë trupi- përfundoi ai i nervozuar.

Infermjeret u shtangën nga kjo skenë, e pa shoqe dhe e paparë në këto spitale. Vepruan me shpejtësi, dhe gjendja u vu në rrugë të mbarë. Donika dyluftonte me sëmundjen. Ajo kërkonte ta largonte atë me buzëqeshjen e amël duke vështruar përtej dritareve të spitalit tanimë të padëshirueshme. Shpresat i kishte të mëdha edhe pse ndonjëherë i treteshin në dhimbjet që sa vinin dhe i shtoheshin. Forcë nuk kishte shumë, por gatuante, arnonte rrobat e vëllezerve, bënte ndonjë tantelle për tavolina kur rrinte në shtëpi.

Vitet, kalonin me lotë dhimbje e paksa buzëqeshje. Dalë ngadalë e tmerrshmja sëmundje po i shtonte të tjera dhe po e dobsonte, nga ana shëndetësore, morale e psikollogjike. Pranvera e dymijë e dymbëdhjetës, erdhi e ngarkuar me shqetësime të medha. Kthimi në spital dhe analizat treguan për një të ardhme pa shpresë. Prindërit ishin pushtuar nga ankthi e frika e humbjes së cucës së tyre. Filluan mjekimet intensive për të kryer ndoshta dyluftimin e fundit.

Shkenca mjeksore dhe doktorët me shumë përvojë, filluan të ulin kokën, të turpëruar, të lëshojnë për tokë, me nervozizëm armët e luftimit. Jeta e sajë ishte në pikat më kritike. Kush e shikonte, dilte kokulur nga dhoma ku ishte shtrirë Donika Meziu, e cila në vetëvete ende shpresonte, ajo nuk i kishte lëshuar armët. Kjo është e natyrshme. Kërkonte sfidimin e sajë. Edhe pse kjo përbindësh me shtatë krenja kërkonte t'ia merrta kalanë nga brenda. Hemoragjia e brendshme, sëmundja e sheqerit, shkatërrimi i mëlqisë, ishin si predhat e mortajave në kalatë ilire. Kështu që kur i duheshin ende dymbëdhjetë dite e dy muaj për të mbushur njëzetë vjeç, ajo mbylli sytë, zemra e sajë rinore i pushoi së rrahuri dhe çdo qelizë e organizmit ngriu, humbën funksionin jetësor. Dhimbja me ankthin shungullues i pushtoi pa mëshire të gjithë njerëzit në këtë pavion të spitalit. Sigurisht, tronditi zemrat e nanës, babait e mixhë Danit. Lotët e kuja, banë që të ushtojnë koridoret e spitalit, dhe gjithë hapsira natyrore përgjatë udhëtimit deri në shtëpine e tyre në Rrafshe të Thanxës në Fushë Muhurr të Dibrës.

Ndërsa mixha i madh, kur merr lajmin po udhëtonte nga Gjenova në drejtim të Francës. Filloi qielli i këtyre anëve të bubullijë, shkreptijë e të hedh nga qielli nje stuhi shiut të paparë. E ai e shoqëroj këtë dukuri natyrore me lotët e dhimbjes së thellë për vajzën e vëllait. Jeta e hidhur e mergimtarit, nuk do ta lejonte të shikonte edhe kufomën e bufullaqes, bukuroshes së familjes Meziu.

Ndërsa babai i tijë, do të thithte e përshtynte pluhurin e martelit të Mermerit të Muhurrit, ai do të detyrohesh të thithte ajrin e huaj të përzier me kripën djegëse të mergimit. Kjo është ajo që të trishton të helmonn kur e thithën. Përpiqet t'i pështyjë për të larguar dramat e pafundme të vuajtjeve në jetën e gjithë sejcilit pjestar të familjes së tijë por.....

QOSHJA E LOTËVE

Brigjet e kaltërta, me peisazh të ngarkuar me bukuri mahnitëse, ku lodrojnë gratçelat e vilat njëkatëshe e shumëkatëshe shekullore mbretërish, bashkangjitur me kaltërsinë e thëllë blu të detit Tirren, të emocionojnë të gëzojnë e entuziazmojnë pa kufi. Ndërsa ai kësaj rradhe, ka sytë të skuqur nga gurra e lotëve, e zëri i është ngjirur nga të qamit e vazhdueshëm.

Kërkon të dijë për organizimin e cermonisë së varrimit, për udhëtimin e..... Cila është lista e pjesmarrësve, shpenzimet e gjithëfarshme e organizimi i pritjeve e percjelljeve. Arrin tek kjo vilë që vetëm banjo ka njëzetë e pesë. Zonja e kësaj, është grua me kulturë të madhe, emri i sajë Elizabela Serranjoli, mbart brënda vetes, mirësinë, shpirtë dlirësine dhe edukatën e lartë ngjizur me thjeshtësinë. Edhe se pasuria e sajë ka përmasat e një perandorie të vërtet ajo i është përkushtuar, natyrës së gjallë, njeriut si kapitali më i çmuar


Kodra e Shën Diellit

spitaleve për shërime e kërkimeve shkencore për Kancerin, sëmundjes vdekjeprurëse të shekullit të kaluar dhe këtijë në vazhdim.

Ndërsa ai në një qoshe të kësajë kulle, flet me të afërmit të cilët sapo kanë mbushur dhomat, larg shumë larg syve të tijë tanimë të errësuar nga lotët, e fillon bisedën me Faik, Medi e Shukri Merën, Xhetan Preçin, Murat, Zyber e Mane Krashin, Selman Bodin, Ismail Manin, Hasan Lacin, Ali Çikun e Liman Deden, Hasan Krrashin e dhjetra të tjerë, ndërsa lotët e hidhura e tradhëtojnë pabesisht, në çdo tingull zëri që i vinte nga larg, nga vendëlindja e tijë e dashur.

Nuk e dimë shkakun por padashje iu kujtuan vargjet e një kënge mallëngjyese shpirtë coptuese të kurbetit: "Si s'u mbyll ai shteg mallëngjimi, Si s'u zu me lumin e Lotëve?!" Stergjyshi i tijë Isufi, pjesmarrës në mbledhjen e Arrasit të tetë Gushtit, njëmijë e nëndëqind e njëzetë, bashkë me Dan Lekën, s'vonoi dhe mori udhën e shtegëtimit në shtetin ku ishin edhe njerëzit e gruas nga fisi Visha. Punoi si lulishtar në qytetin e Izmirit. Ku po i tretën eshtrat në dhe të huaj, në një varr që s'dihet se ku, në rrethinat e tijë. Pas nentëmbëdhjetë vjetësh, fluturoi lajmi i zi, se ai kishte nrrue jetë. U vajtua e u qa por pa..... Ndërkaq iu drithë i gjithë trupi e i filluan një rrebesh lotësh, ndërsa zemra sikur po i dilte nga vendi. Sytë iu errësuan dhe..... Pas pothuajse një ore ai nuk pa qoshen e lotëve e prandaj pyeti: Çfarë më ka ndodhur? Një zë i qetë i përgjigjet: Asgjë! Ngushëllim i natyrshëm në këto raste.

Lëndinat e lotëve, kanë marrë përmasa të reja. Ato ndodhen në Përmet, Vlorë, në hapsirat natyrore, të Kukësit, Korçës, Skraparit, Matit, Tiranës e tjerë. Por më e ashpër çfaqet te shpirtrat e njerëzve që e vuajnë pamëshirë në ujvarën e gjthë jetës. Atje s'mbinë bari, se lotët janë te kripura, se nënat presin të bijtë e tyre, vajzat treten duke pritur të dashurit, nuset e reja me ankth e shkulma mërzie e malli presin burrat. Bukuria degjeneron në shemtirë ogurë zezë, bari thahet, ai zëvendësohet nga grimcat e pluhurit që dëshmojnë për gjurmët e shumta të kalimtarëve, të pritësve e percjellësve. Dhe ai qan për katër dite në këtë qoshe. Me zërin e dhimbshur plotë ankth dhe tashmë të ngjirur, telefonn të vëllain Petritin: Hidhni edhe një grusht dhe, edhe për mua, kështu do të pushojë e qetë dhe e lumtur në parajsë. Zoti e bekoftë. Fjalët mezi i dilnin nga goja, ku edhe buzët i dridheshin sigurisht me një tingull vibrues, pothuajse të pakuptueshme.

Mendja ato ditë e netë i zbulonte ngjarje tronditëse. Në mes detit dallgë egër e trishtues hidhet nga pothuajse pesëmbëdhjete metër, djaloshi i hishëm e trup sportiv Leonard Kamber Lleshi. Lajmi i hidhur i kësaj tragjedie familiare, mbërriti tek familjen e tijë në Fushë - Muhurr. U kërkua me palombarë trupi i djaloshit, për ditë e javë. Familia priste së paku trupin e tijë. Ato u mbyllën në kullën e deshpërimit ku dhimbja e thelle iu kafshonte shpirtin e zemrat. Por edhe sot e kësaj dite asgjë nuk dihet e zbuluae as edhe shkaku i hedhjes apo kush ishte ajo dorë kriminale që e shtyu. Një plagë e hapur e cila shkakton dhimbje therëse, që pjell zymtësi e hidherim të shpirtërave.

Largohet nga vendëlindja e Garibaldit të Madh (Nica) duke lënë pas bukuritë e natyrës dhe mrekullitë e artit të arkitekturës ndërtuese të banorëve të këtyre anëve, kështu si i huaj, shpirtë coptuar, gojë hidhur, e me kokën që i rëndon nga lëmshi i hidherimit të humbjes që i ndodhi. Kërkon të shohë përpara, të venë në lëvizje kujtesën, perfytyrimin për të gjetur "galektika,, të reja shërimi, optimizmi, jetën e gjallë, vepruese që objektivisht duhet të rrjedh si ujët e kalter të Murrës e Drinit.

VËSHTRIM I PËRLOTUR

Ulet në gjunjë pranë varrit të saj. Edhe pse ende nuk i besohet se kush është brënda. I përlotur nga shigjetat e dhimbjeve të helmëta, kujtesa më çon..... Vendi këtu quhej tek Lapidari në Thanxë. Kushtuar mbarimit të punimeve të kanalit ujitës, Gjurra e Kumbullës - Zoket e Senjës. Përuaruar nga Beqir Balluku në Majin e vitit njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjete e tetë. As lapidari dhe as ish Ministri i mbrojtjes nuk janë më.

Ndërsa uji i pastër e jetëdhënës për gjithëçka deri në Gjarec e Pasmar matanë lumit Drin, ushqen jetën e mijëra e mijëra gjallesave. Emri, toponimi i kësaj kodre tashmë ndryshon: Do të quhet te Varri i Donikës, sepse Donika Kastrioti nuk u varros në atdheun e vetë. Së paku këtë nder t'ia bëjmë. Brezat lidhin brezat, kohët kërkojnë që në një farë mënyre të përsërisin vetëveten.

Edhe pse lotët nuk e lënë të shikoi qartë, në shpatin veriprendimor ku është Guri i Shqipes. I këtijë shpendi legjendaretë, shkërlitur në shumë flamuj. Para së gjithash, emër i simbolit të flamurit shqiptar, sëpaku që në kohën e Kostandin Mazrekut. Një emër tjetër që fsheh nën vetevete një emër të një ngulmimi romak për më shumë se një mijë vjeçar, Krizat ky kurriz gjigand me një strukturë relievesh të çuditshme. Shpati lindor i sajë quhet: Zabelet e Berishe. Një fis që ende historia e tijë, është e pashkruar, lëviz e kamuflohet ne mëndjet e njerëzve të trevës Dibrane. Mjerisht!

Ishte pranverë e vitit njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy kur papritur, të dehur nga fitoria bien në duar të ushtrisë turke tetë gjeneralet madhor të Skënderbeut në betejën e Vajkalit (Bulqizë) Moisi Dibra, Nikollë Berisha, Muzaki i Angjelinë, Gjin Muzaka, Gjon Perlati, Gjorgj Kuka, Gjin Manezi Vladin Gjurica. Ato iu nënshtrohen torturave të çmendura të ushtarëve turq, deri në urdherin e fundit të Sulltanit: të ripen të gjalle e trupat e tyre t'iu lëshohen qenve të uritur të oborrit tim. Dhe ashtu u ba. Në këtë zi të madhe u veprua kështu: burrat shkulën flokët dhe lanë mjekrat e gjata ndërsa gratë u veshën me rroba therr të zeza. Kështu shkruajnë kronistët e asaj kohe. Dhe në këtë zi u perfshin gjithë principatat shqiptare të asaj kohe, padyshim, ndër to edhe Dibra e Muhurri. Vargjet e këngëve vajtimore kanë arritur deri në kohërat moderne. Lotët e shumta u bashkuan me Drinin, Setën, Murrën, përroin e Gjelagjoshit, Kastriotit, Deshatit etj.

Ndërkaq, vështrimi më kapi Arën e Robit, vendin ku mbaheshin nga dinastia e Mazrekaseve, robtë e luftës dhe keqëbërësit e natyrave të ndryshme. Më tej toponimi Mazreka, muret rrethuese, ndërtesa e madhe, lagjet në arë të Kurte, tregojnë per një qytet me rendesi historike të cilat gjithashtu, dëshmojnë për vend origjinën e Kastriotëve. E dëshprimi të shqetëson e të shkërmoq moralisht, të vyshk mendimin të ndrydh inisiativën e shkuarjes deri në fund të ketyre fakteve historike. E pafalshme është, të mos shkruarit e të mos dëshmuarit të tyre. Deri kurë vallë kjo gjëndje?

Merrë pak dhé e shkërmoq me gishtërinj e cila perzihet me lotët e tija. Shikon hierëndë si një ciklope gjigandë malin e Shën Marisë (Mali i Shmrais dial. vendas), me shpatulla të gjëra, me këmbët ngulur thellë në brigjet e Murrës dhe të përroit të Shqathit, me kokën prej lisash gjigande që sikur prekin qiellin, në majën e tijë. Iu ngjajne si dy pika uji burrave shtatëlarte të këtyre trevave si: Llan Devës, Tahir Manit, Dalip e Beqir Çikut, Hamit Ballës, Hysen Manit etjerë e tjerë.

Ai deshiron të ''bisedoi,, me Donikën, për shpellën e Zonjës, pak nën majën e tijë dhe me Kishën Shën Mari, që shërbente si kala e si kult i fesë kristiane. Nga aty me lugje druri të lyera me dyll blete tregon legjenda, qumështi i dhive e deleve shkonte në Kishën e Limthit përpunohesh dhe prodhimet shkonin në qyetein dhjetë mijë banorësh te Uskanës (Kalaja e Grezhdanit). Ajo sikur më pyet: Ku janë shkruar gjithe këto or mixhë? Nanë Maria u bë shejtore, heroinë e kristianizmit, siç janë heroina të atdheut tonë, Trinka e Këlmendit, Shote Galica, Helena, gruaja e Kostandin Boçarit, Bobolina Idra, suliote, Nimete Progonati qe bie heroikisht në betejën e Sinjës, Hibe Palikuçi trimnesha e Dibrës së Madhe, Dije Imer Meziu, nga Reçi i Dibrës, trimnesha Bedrie Kahrasani etjerë.

Vetullat e syve i rëndohen, rrezet e shikimit i ulen si të turbullta, në Kodër Shtezë (Kodra e të shtremëve). Në këtë copë truall është ulur kamëkryq, mjerimi i turrshëm i një fisi, pothuajse shtatëdjetë varre, femijë dhe gra, djelmosha e vajza të reja, burra e te moshuar. Semundja e hasallekut shkaktoi vetëzhdukjen e një fisi, me ulurimat e fatkeqesisë katastrofike më të tmerrshme. Por për mrekulli dy kurbetlijtë e tyre të sapo kthyer nga Stambolli pas shekullit te gjashtëmbedhjete filluan ta ripertrijne fisin Mëziu, ku në kohën e sotme mund të numërohen njëqind vatra zjarri. Kështu këto dy kundershti, ligje të hekurta të natyrës, si e qeshura dhe e qara, e bukura dhe e shëmtuara, hidhërime e gëzimi bashkëshoqërojnë jetën, përgjatë udhëtimit të sajë në kohë e hapsirë.

Dhe përsëri ai mediton për djegjet e ebrejve e të bardhëve ne furrat e nazistëve gjermanë dhe për humbjen e përbotshme prej pesëdhjete milione njerëz të të gjitha moshave e kombesive ne mbarë botën. Kjo ishte tragjedia më e madhe e e të gjitha kohërave, pra lufta e dytë Botërore. Me anë të katjushkave apo mortajave, kallashnikovëve apo bombave me napal, me mina hedhëse, apo airoplanet bombardues pa pilote, e së fundi me dy pilotët Amerikane qe hodhën bombat atomike ne Hiroshima e Nagasaki të Japonisë u veprua per të kryer vetëzhdukjen. Katastrofa njerëzore, në të cilën edhe liqenet, detet e oqeanet e shtuan nivelin e tyre nga dhimbjet e medha, nga hiri i kufomave e lumenjte e gjakut. Çfarë tragjedie makabre, ç'njerëzore e pa konceptueshme! Një dhimbje me përmasa astronomike. Megjithatë jeta vazhdon, ajo është një rrotë e fuqishme vetëlëvizëse, me ligjet e forcat e saja frenuese e shtytëse, te cilat veprojnë me tërë forcën por me kahje të kundërta, por kurrë me fuqi e energji të barabrtë.

Tsunami i ishujve Maldive, e Malejzisë, në oqeanin Indian të fund dhjetorit dymijë katrës, shfaqi forcën e tijë madhore me pamje rrënqethëse, tunduese, shokuese për popullsinë e atyre vendeve dhe të mbarë dheut. Dyqindë e tridhjetë mijë të vdekur e të humbur në oqeanin e zemruar nga tërmeti nën shtratin e tijë. Shekulli i ri kërkonte therrori të reja, e kërcellonte dhëmbët e tijë të tmerrshëm e të fuqishëm, duke vënë në lëvizje, forcat verbuese te natyres. Njerëz të të gjitha moshave u bëne viktima e pafajshme e kesaj tragjedie natyrore e cila ne dymijë e dhjetën u perserit në Japoni me të njëjtën forcë shkatrrimtare e vdekje shkaktuese të njerëzve.

Nga kodra e Donikës, hedh vështrimin në Rrafshen e Thanxës ku në vitet tridhjetë të shekullit të njëzetë kanë qenë zyrat e Komunës së Muhurrit, shkolla e ndërtuar nga muratorët Hidër e Ramadan Mëziu me investimet e Dine Hoxhës, ku në nje pllake çimentoje i shkruajtën emri i tijë. Banorët e këtyre aneve filluan të shkolloheshin rregullisht. Një agim mëngjezor dijenish po dukesh në horizontin e kohës.

Aty pranë në një shpatin Jug-Prendimor të Thanxës prehen në shtratin e perjetshëm prej dheu: gurëskalitesi i shqiponjave, hekur e dru punuesi Ganiu, mësuesi, bujku e minatori Tahiri, gjyshja gojë mjalte e tepër e zgjuar Sibja, Rufati i Idrizit, ushtaraku tetëmbëdhjetë vjeçar qe i ''ruan,, me syrin pishë e gishtin në kamëz të pushkës dhjetra e dhjetra të tjerë.

Një teatër masakrash luajti armiku më gjakatar i Dibranëve dhe i shqipërisë, Serbët, ku në verën e vitit njëmijë e nëntëqindë e trembëdhjetë, dogji ne Muhurrin e asaj kohe, katërmbëdhjetë shtëpi, me gjthëçka çfare kishin mrenda, rrëmbyen në mësymjen e parë: dyqind dhen, njëqind dhi, tridhjetë lopë plle e barsa, pesëmbëdhjetë kuaj ngarkese e vrapimi, iu grabitën popullsisë, treqind lira turke dhe ropën njerëz të gjalle për te cilat deri më tani s'kemi emra. Në mësymjen e dytë ushtria gjakatare, katile, e pa dinë e imanë serbe, grabiti dhjetë dele, dhjetë dhi, dhe një kalë. Të masakruar me bajonetat e pushkëve të tyre duke derdhur gjakun sa vija e ujit për të punuar një mulli bloje: Sulejman Halili, Beqir Xhaferi, Hajredin Demiri, Ymer Sulejmani, Mahmut Abazi, Hysen e Bajram Dervishi, Islam Demiri, Xhafer e Halil Ismaili etjerë. Është e natyrshme të mendosh se dhimbja ishte e pamatshme, mjerimi pllakosi gjithëçka, grate u veshën me të zeza, e burrrnia u pregatit për hakmarrje të përgjakshme. E kuja e të bërtiturat rrënqethëse pushtuan luginat, brinjat, shpatet, kurse majë malet u pushtuan nga retë e zeza me shi të bollshëm e friksues njëkohesisht.

I kërrusur nga kjo luftë e brendshme, ku pikëllimi ushqehet me shkulmat e vnerit të helmtë të humbjes së bukuroshes që ai i përkdhel me butësi dheun e dy copat e drujta në dy skajet e varrit. Ndërkohë mixha i madh, kërkon të gjejë, vegime drite, shprese, guximin për të mposhtur të keqen por.... Forca, energji të fshehur brënda vetes kërkon t'i ''urdhërojë,, për të shikuar e ecur përpara ballë lartë e me siguri. Ndaj përplasë vështrimin drejt lindjes. Aty ku dielli nxjerr syrin e tijë të ndritshëm në vargmalin Korab – Velivar, Kërçina. Sa i bukur e jetëdhënes por edhe hynjor e i shejtë!

Si vendali rrokullima e shikimit i ndalet tek Kodrën e Shëne Diellit. E cila i përngjan, një kësule malësori Dibranë, me ngjyrë të hirtë, e njolla të gjelbërta pothuajse krejt shkambore, mu aty ku bashkohet Lumi Murra me Drinin e Zi. Nga këtu shikohet lugina e këtijë të fundit nga kodrat e Hoteshit e deri në mbylljen e relievit të thyer të Reçit me Kolosianin. Dhe relievi i bute kodrinor e fushor i Dibrës së Poshtme.

Mos vallë me kultin e diellit, bestyni pellazge, popullsia e këtyre anëve ka kërkuar shpresën, forcën shtytëse përpara, besimin për të jetuar bres pas brezi ? Historianët i janë qepur këtijë fakti, me përmasa hynjore. Pra e quanin perëndi, këtë e dëshmonë historiani i lashtë grek, Herodoti. Tek shqiptarët Kaukaziane (kau- kazi- ka i zi- kaziu/ S.M) ai quhesh Mhitra, , Mhir, për shkëlqimin e tijë në kupën qiellore e cila në gjuhën Persiane, dhe Pellazgo- Iliro- Shqiptare do të thotë: i mirë dhe i bukur ose mbarësi, mirësi etj. Ne kohët e lashta djemtë e vajzat nuk martoheshin se dielli nuk ndriçonte hapsirat perrreth vendbanimit ku banonin e kryhesh cermonia e martesës. Janë dhjetra legjenda e zakone të lidhura pazgjithmërisht me këtë trup qiellor jetëdhurues. Gratë e ketyre anëve shpesh përdorin betimin: *Për atë Diell une nuk e..... ,,*

***

Uli ballin paksa të djersitur, çuditërisht të ftohta, i lodhur shpirterisht e tretur fizikisht. Por ja që i shkreptiu ideja e një betimi, e një hymni, e një këshille te mirë, që bie erë njerëzillek, kulturë, edukatë, e cila e përzier me dhimbjen dhe forcën për mbijetesë, mu këtu pranë Zonjës Donika. Nxjerr një copë letër të zhubravitur, e drejtoi me gishtërijtë dhe pllamën e dorës. Merr lapsin nga xhepi, ku shkruan:

Njerëz të mirë, folni gjithmonë fjalën e amël. Kur shkelni për tokë në udha, shtigje, livadhe e lëndina, shikoni më parë se ku vini kamën. Kur debatoni apo gjykoni për një problem të shtruar për zgjidhje, rradhë uji, ndrrim toke,zabel dushkajash, ndarje pasurie të shtëpis apo dhuratat për festa apo martesa, tregojuni zemër hambar e shpirtë ëmbël, ndajeni gjërat me drejtësinë e zotit e nën dritën e diellit. Gjakmarrja ritë paganë, primitiv i cili shfaqet jo rrallë në mes shqiptareve, dibranëve, luznakeve, maqellarasve okshtunasve etj, është tregues force e paadobishme, është mungese llogjike kulture e edukate nuk është gjë tjetër veçse padrejtësi e verbërt, është rrënim shpirtëror e zhdukje jetësh e së fundi është gjynah të zoti. Mos e mendoni e kryeni. Largojeni pa kufi këtë veprim ogurzi nga shpirti e mendja!

Një ditë pas varrimit, pra pesë Qërshori, një shi i butë por i bollshëm përfshiu trevën Dibrane. Qielli filloi të qajë me lotët rrëkajë, si njerëzia, si dhemshunia që të shpon anemanë zemrën për këtë vajzë të re që se shijoj jetën të gjithën. Ajo nuk u dashurua e martue, nuk iu gëzua fëmijeve të vetë. Familia i mbeti një ëndërr e pa shijueme e pa realizueme e thare si gjethja e dushkut në vjeshtën e mbrame. Ajo nuk prodhoi as frutin as farën, se fati i sajë u pushkatua nga një sëmundje: ***LUÇEMIA i thone e cila në Botën mbarë rrëmben, grabit me dhunë e pamëshirë mijëra jetë njerëzish.*** Shpresa dhe harresa qofshin të levdueme në këto raste. Dhe shkenca mjeksore punë të mbarë.

Ai përpiu me vështrim të përgjumur, diellin në kupën e paanë ngjyrë blu të qiellit, dhe përfytyroi pranvera të tjera, pa lotë, kuje vajtimore, pa dhimbje therëse në shpirt, pa humbje të tilla të familiarëve te vetë e me gjërë.

Muhurraku Selman Meziu

Nica, 20.06.2012

BANJAT TERMOMINERALE

– Capa në Dibër të Madhe



BANJA E BANISHTIT DHE KOSOVRASTIT

Ju mirëpresin me kushte të shkëlqyera mjekësore dhe hotelierike

Ofrojnë shërim, rehabilitim dhe relaksim. Sipas një studimi të kryer nga AKAO (Organizatë botërore për ujërat termominerale), rezulton se ujërat e banjave të Dibrës së Madhe zënë vendin e parë në Evropë dhe të tretin në Botë për për përmbajtjen e ujit dhe efektet shëruese të tij, sidomos përmbajtja e squfurit që ndikon në shërimin e shumë sëmundjeve, si edhe përmbajtjen e ujit me kalcium, magnezium, hekur, kloride, nitrate, nitrite etj.Në këto banja ofrohet trajtimi edhe me fangoterapi, magnetoterapi, masazhe manuale, kineziterapi, fitnes, terapi me laser etj. Ka edhe aparate bashkëkohore si TENS, Ultratoni, Vakum, Rrymë inferente, Rreze infra të kuqe, Elektro stimulus etj.

Me sukses trajtohen dhe shërohen sëmundjet e aparatit lokomotor, të sistemit nervor, Gastri- intensinal, të sistemit respirator, uro - gjenital, sëmundjet endokrine, ortopedike, gjendjet post - traumatike, sëmundjet e lëkurës etj.

Cilësisë së ujit termomineral, personelit të kualifikuar mjekësor dhe hotelierik i bashkohet edhe natyra me bukuri magjepëse dhe ajri i pastër.

Numrat e telefonit për kontakt janë:

Hotel Banisht: **++389 46 831 092; ++389 46 832 680**
Hotel Kosovrast: **++389 46 842 095; ++389 46 842 222**
Drejtoria: **++389 46 831 401**
Kontabiliteti: **++389 46 835 424**
Nga Shqipëria mund të na kontaktoni edhe në numrin **068 468 27 11**
E-mail: **info@bdcapa.com**
website: **www.bdcapa.com**



cyan magenta yellow black